



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 646/5, Prot.

Tiranë, më 30.4. 2021

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin “Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e sive arkeologjike, për periudhën 2016-2019”

Drejtuar: Znj. Elva MARGERITI
MINISTËR I KULTURËS

TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Subjektin Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Vlorë, Njësia e Administrimit dhe Kordinimit të Parkut Arkeologjik Kombëtar Butrint, Njësia e Administrimit dhe Kordinimit të Parqeve Arkeologjike Apolloni dhe Bylis, në bazë të programit të auditimit nr. 646/1, datë 30.09.2020 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2019.

Politikat shtetërore të ndjekura nga Ministria e Kulturës, si ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e sive arkeologjike, për shkak të mungesës së një kuadri rregullator të plotë në menaxhimin e tyre, nuk kanë rezultuar efektive. Mbivendosja e legjisacionit, si pasojë e funksionimit të njëkohshëm të dy ligjeve për trashëgiminë kulturore, mungesa e akteve nënligjore zbatuese, miratimi i dokumentit strategjik pa plane konkrete veprimi, komunikimi ndërisntitucional i dobët, kanë bërë që menaxhimi i sive të mos jenë efektiv. Përzgjedhja e kritereve të menaxhimit nuk është bërë mbi bazën e studimeve të kryera nga Ministria e Kulturës, si dhe modelit më të mire, të integruar në kushtet shqiptare. Ndryshimi i strukturave të organizimit, funksionimit dhe administrimit të NJAKPA-ve është kryer pa analiza financiare, pa analiza burimesh njerëzore dhe nevojash për aftësi profesionale specifike, pa një planifikim mbi nevojat e konstatuara dhe rezultatet e dëshiruara.

Ministria e Kulturës, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore dhe NJAKPA-të kanë shfaqur dobësi në marrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të parqeve arkeologjike. Në mungesë të planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore, menaxhimi i sive të këtë aspekt, nuk ka pasur efektivitet të plotë. Mangësitë infrastrukturore, logistike dhe njerzore, në administrimin e parqeve, janë bërë pengesë për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për shfrytëzimin publik të tyre, nga ana e vizitorëve. Mangësi konstatohen edhe në promovimin e tyre nëpërmjet kanaleve të komunikimit masiv.

Ministria e Kulturës nuk ka asnjë plan veprimi, sa i takon marrëdhënieve me mediativise, lidhur me prodhimin, promovimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe Vendimin nr. 52 prot., datë 26.04.2021, të Kryetarit të KLSH-së, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

MASA ORGANIZATIVE

I. Për pyetjen audituese: Sa efektiv është kuadri rregulator për parqet/sitet arkeologjike?

Gjetje nga auditimi:

- Ligji Nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, *nuk ka qenë shumë funksional*. Në zbatim të tij *nuk janë arritur objektivat e parashikuara* në, *realizimin e bashkëpunimit privat-shtet, mirëmbajtjen e objekteve të pasurive të paluajtshme, harmonizimin e legjislacionit* mbi trashëgiminë kulturore me direktivat dhe rregulloret të BE-së, etj.
- *Ministria e Kulturës* për periudhën 2016-2019 *nuk ka përfunduar dokumentin strategjik* nisur që në vitin 2016, përfundimi i të cilit ka qenë detyrim dhe në SKZHI 2015-2020, si dhe Programin e Trashëgimisë Kulturore 2013-2017. Zbatimi i politikave shtetërore në kuadër të *Planifikimit Buxhetor Afatmesëm, realizon objektiva në nivel programi, por nuk garanton realizimin e objektivave strategjikë të Ministrisë së Kulturës*.
- Bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar si dhe VKM-në nr. 142 datë 12.03.2014 e cila vlen për të gjithë administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura, *Ministria e Kulturës*, ka funksionuar me *rregulloren e brendshme miratuar* në vitin 2015, e cila ka qenë në fuqi deri më datë 19.02.2020. Gjithashtu dhe IKTK-ja ka funksionuar *me statutin dhe rregulloren bazuar po në këtë ligj*, por miratuar më vitin 2017, respektivisht, statuti miratuar me Urdhrin Nr. 9, datë 23.01.2017 “*Për miratimin e statutit të Institucionit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”*”, dhe rregulloren miratuar me Urdhrin Nr. 128, datë 24.01.2017 “*Për miratimin e rregullores së brendshme të IMK*”. *Rregullorja e ITKT-së është miratuar me dy vite vonesë nga miratimi i rregullores së institucionit qendror*.
- Emërimi i titullarit të ministrisë në katër nivele të menaxhimit të sitemit të trashëgimisë kulturore, BKPA/ BPKPK Butrint, KKTJM, KKMPK, kompromenton ose eliminon hierarkinë për vendimmarrje të natyrave të ndryshme dhe sjell një centralizim të panevojshëm i cili mund të ndikojë negativisht në realizimin e objektivave të institucionit.
- *Ministria e Kulturës*, me miratimin e Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka miratuar organigramën, ka ndryshuar strukturat, janë krijuar organe të reja kolegiale, por *nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara rregulloren e brendshme administrative*. *Kjo rregullore është miratuar me Urdhrin Nr. 92, datë 19.02.2020* “*Për miratimin e rregullores për organizimin dhe*

funkcionimin e brendshëm për Ministrisë së Kulturës”, jashtë afateve ligjore të parashikuara.

- Ministria e Kulturës, me VKM-në Nr. 903, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, ka miratuar strategjinë e re, me objektiva të njëjtë me ato SKZHI 2015-2020 dhe pa plane veprimi konkrete. Bazuar në Urdhrin Nr. 220, datë 12.04.2018 “Për ngritjen e grupit të punës pë bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025”, një nga detyrat e grupit ishte *hartimi i planit të veprimit të realizimit të tij* dhe *raportimi i realizimit të tij*.
- *Ministria e Kulturës, në kundërshtim me VKM Nr. 396, date 31.03.2005, të ndryshuar, nuk ka realizuar funksionimin e BKPA-së, (përjashtuar BPKP Butrint), si organ vendimmarrës, i cili mbikëqyr veprimtarinë e NJAKPA-ve dhe strukturave përkatëse pranë DRTK-ve. Ky bord ekziston vetëm në shkresa. Lidhur me veprimtarinë, takimet dhe vendimet e tij nuk na u paraqit asnjë dokumentacion.*
- *DPPSTK/DPPZHK, si njësia kryesore përgjegjëse dhe pjesë e grupeve të punës në hartimin e politikave shtetërore për TK, veçanërisht për sitet arkeologjike nuk kanë qenë shumë eficiente pasi veprimtaria e tyre, nuk është bazuar në rregulloren administrative institucionale, e cila nuk ka qenë e miratuar në këtë periudhë, si dhe disa nga detyrat funksionale të tyre nuk janë realizuar brenda afateve ligjore të parashikuara.*
- *Grupi i punës dhe strukturat përgjegjëse, bazuar në Urdhrin Nr. 624 datë 12.09.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore të Ligjit Nr. 27.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, nuk kanë miratuar kalendarin e punës duke përcaktuar prioritetin e secilit akt sipas fushës së kompetencës dhe afatin ligjor për nxjerrjen e tij. Për periudhën 2016-2019 nuk na u vu në dispozicion ky kalendar pune i miratuar.*
- *Ministria e Kulturës ka zhvilluar politikat shtetërore për parqet arkeologjike, bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003 “Për Trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, jo funksional në disa aspekte dhe Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, konceptuar dhe parashikuar si Kod që të përfshijë të gjithë kuadrin ligjor të detajuar për trashëgiminë kulturore, ligj voluminoz, pa një dokument strategjik të miratuar, me mungesë aktesh nënligjore. Funksioni i njëkohshëm i tyre ka sjellë menaxhim joefektiv të siteve arkeologjike, evidentuar në përgjigjet e pyetësorëve, raportet e MK-së ashtu dhe në takimet me drejtuesit e siteve arkeologjike.*
- *Ministria e Kulturës ka miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara strukturën, statutin dhe rregulloren e IKTK-së. Ndryshimi i roleve dhe përgjegjësive të strukturave i pa përfaqësuar në aktet nënligjore dhe administrative përkatëse, gjatë periudhës objekt auditimi ka bërë që të ketë papërgjegjshmëri dhe komunikim institucional të dobët, gjë e cila shfaqet në vonesat e hartimit të akteve.*
- Në VKM-në Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara, *nuk shprehet funksioni këshillues i KTKM-së, lidhur me termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme*, si kompetencë e tij, detyrim ligjor. (Neni 47 i Ligjit Nr. 27/2018).

- *Ministria e Kulturës nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara Urdhrin Nr. 223, datë 3.7.2020 për “Miratimin e rregullores për veprimtarinë e KKTKM-së, këshillit teknik, të sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj”.*
- *Ministria e Kulturës nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara urdhrin për rregulloren për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike të saj.*
- *Në Ligjin Nr. 27/2018 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ka mbivendosje kompetencash midis institucioneve të specializuara IKTK-së, IKRTK-së dhe organeve kolegjiale KKTKM, KKMPK, pa përjashtuar dhe BKPA, respektivisht si më poshtë vijon:*
 1. pika 13 neni 30; pika 4 neni 32; pika 2 e nenit 56, të ligjit të sipërpermendur, lidhur me regjistrat kombëtare të vlerave kulturore materiale.
 2. germat f) h) n) të paragrafit IV të VKM-së Nr. 208/2019;
 3. pika i. ii. iii. iv germa c) të VKM-së Nr. 279, dt. 2.5.2019.
 4. VKM-ja Nr. 279, dt. 02.05.2019 dhe VKM-ja Nr. 396 datë 31.03.2005, mbi kompetencat e BKPA/ BKPAK Butrint dhe KKMPK në menaxhimin e siteve.
- *Ministria e Kulturës, bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 i cili nuk parashikon rregullore për administrimin dhe funksionimin e siteve arkeologjike, por plane menaxhimi dhe plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore, nuk ka hartuar planet e menaxhimit, planet e ruajtjes dhe administrimit të parqeve arkeologjike, përvëç Butrintit.*
- *Ministria e Kulturës nuk ka nxjerrë komentarin dhe manualin e përkufizimeve. Ligji Nr. 27/2018 si ligj inovator është konceptuar dhe parashikuar të jetë një Kod i cili të përfshijë të gjithë kuadrin ligjor të detajuar për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë. Ligji i sipërpermendur paraqet vështirësi në trajtimin e vet dhe është më se e nevojshme nxjerra menjëherë e manualit të përkufizimeve.*
- *Këshilli i Ministrave, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 263, nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara aktet nënligjore të sipërpermendura.*
- *Këshilli i Ministrave, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 263, nuk ka miratuar aktet nënligjore të sipërpermendura.*
- *Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 264, Ministria e Kulturës, nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara aktet nënligjore të sipërpermendura.*
- *Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenet 264 dhe 268, Ministria e Kulturës, nuk ka miratuar aktet nënligjore të sipërpermendura.*
- *Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 265, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave, nuk kanë miratuar aktet nënligjore të sipërpermendura.*

Rekomandimi:

- 1.1 Ministria e Kulturës dhe strukturat përgjegjëse, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojnë planin e veprimit të realizimit dhe raportimit të realizimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.2 Grupi i punës dhe DPPZHK të caktojnë dhe të miratojnë kalendarin e punës, duke përcaktuar prioritetin e secilit akt, sipas fushës së kompetencës dhe afatin ligjor për nxjerrjen e tij.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.3 Ministria e Kulturës të rishikojë aktet nënligjore për funksionimin e BKPA-së dhe të dokumentojë veprimtarinë e tij për marrjen e vendimeve lidhur me sitet arkeologjike.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.4 *Ministria e Kulturës bazuar në nenin 142 të Ligjit Nr. 27/2018 të hartojë planet e menaxhimit të siteve arkeologjike.*

Të fillojë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.5 Ministria e Kulturës të rishikojë dhe të rivlerësojë mënyrën e administrimit të NJAKPA-ve në bazë të rregulloreve të funksionimit dhe administrimit apo bordeve (si Butrinti), në mënyrë që të mos krijohet vakum ligjor dhe kaos në menaxhimin dhe funksionimin e tyre, deri në hartimin e planeve të menaxhimit për to.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.6 Të rishikohen aktet nënligjore për organet kolegiale vendimmarrëse, lidhur me emërimin e titullarit të ministrisë, për të shmangur centralizimin e kompetencave dhe elemiminin e hierarkisë për vendimmarrje të natyrave të ndryshme, të cilat mund të pengjnë në realizimin e objektivave të institucionit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.7 Ministria e Kulturës, në zbatim të nenit 47 të Ligjit Nr. 27/2018, të rishikojë VKM-në Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, lidhur me funksionin këshillues të KKTJM-së për termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.8 Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës 4 të nenit 40 të Ligjit Nr. 27/2018, të miratojë Urdhrin për miratimin e rregulloreve për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike të tij.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.9 Ministria e Kulturës të rishikojë legjislacionin përkatës si dhe aktet nënligjore për të shmangur mbivendosjen e kompetencave për institucionet e specializuara dhe organet kolegiale vendimmarrëse.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.10 Ministria e Kulturës të vendosë bashkërendimin midis institucioneve qendrore, vendore dhe akordimin për sa i takon aspekteve të fushës së kompetencës, për të ndryshuar qëndrimin e tyre lidhur me menaxhimin e siteve arkeologjike.

Deri në fund të vitit 2021

1.11 Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës a) të nenit 264 të Ligjit Nr. 27/2018 të nxjerrë komentarin dhe manualin e përkufizimeve.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.12 Ministria e Kulturës, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, të hartoje dhe të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave aktet nënligjore të sipërpërmendura.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

1.13 Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, të miratojnë aktet nënligjore të sipërpërmendura.

Brenda vitit 2021

1.14 Ministria e Kulturës, bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, *në kuadrin e planeve të veta sektoriale*, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjeshterin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, *të propozojë, të hartoje dhe të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave Planin Kombëtar të Peizazhit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 27/2018, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara*, për kontrollin e zonave të mbrojtura të sítave arkeologjike si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të tij.

Deri në fund të vitit 2021

II. Për pyetjen audituese: Sa efektive janë njësítë e administrimit dhe koordinimit të parqeve/sítave arkeologjike?

Gjetje nga auditimi:

- Gjatë periudhës objekt auditimi, në kundërshtim me VKM-në Nr. 396/2005, të ndryshuar, NJAKPA-të kanë funksionuar pa bord, me vendime të pamiratuara prej tij si organ vendimmarrës.
- *Hierarkia e institucioneve qendrore dhe këshillave kombëtare që ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe procedurat e vendimmarrjes së tyre për sitet arkeologjike, nuk funksionojnë siç duhet, pasi Bordi nuk ka ekzistuar dhe miratimet në NJAKPA-të për projekte teknike janë kryer vetëm nga KKR-ja dhe KKA-ja, pa miratim buxheti nga bordi. Ka një mbivendosje kompetencash në procedurat e vendimmarrjes dhe mosrespektim të hierarkisë së institucioneve qendrore brenda sistemit të trashëgimisë kulturore.*
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të Ligjit Nr. 27/2018, VKM-ja Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe

procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”, nuk është miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara.

- Në zbatim të shkronjës “c”, pika 3, të nenit 171, të Ligjit Nr. 27/2018, Ministria e Kulturës nuk ka miratuar VKM-në për “Përcaktimin e procedurave publike për dhënen në administrim të pasurisë kulturore”.
- Grupi konstatoi se, bazuar në pikën 2 të nenit 38 të Ligjit Nr. 27/2018 dhe VKM-së Nr. 208 datë 10.04.2019 Ministria e Kulturës, me propozimin e vet, ka miratuar Vendimin Nr. 95, datë 7.04.2020 të KTKM-së “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit 2020-2030”, ndërkohë që Urdhri Nr. 223, datë 3.7.2020, si edhe disa nga aktet nënligjore që lidhen me administrimin e siteve nuk ishin miratuar. Bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr. 27/2018, KTKM-ja ka *funkcion këshillues lidhur me termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme. Nga MK raportohet gjithë procedura e bërë pa miratimin e VKM-së* në zbatim të shkronjës “c”, pika 3, e nenit 171, të Ligjit Nr. 27/2018.
- Gjatë periudhës objekt auditimi, Ministria e Kulturës, në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi ka ndjekur dy standarde për menaxhimin e siteve arkeologjike, gjë kjo e pasqyeguar dhe e justifikuar në përgjigjet e pyetësorëve, ndërkohë që dhe bordi i Butrintit nuk ka qenë efektiv.
- *Mungesa e dokumentit strategjik të Ministrisë, kapaciteteve profesionale dhe menaxheriale të kufizuara të stafeve të NJAKPA, përfshirë këtu aftësitë për tërheqjen e financimeve të qëndrueshme nga donatorë të mundshëm, ka sjellë mungesën e strategjive të koordinimit dhe monitorimit të projekteve me donatorët në sitet arkeologjike si edhe mungesën e investimeve nga donatorët.*
- Miratimi i dokumentit strategjik me VKM-në Nr. 903, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, pa plane veprimi konkrete si dhe kuadri rregullator jo i plotë për NJAKPA-të dhe DRTK-të, *ka sjellë mungesën e planeve strategjike afatmesëm dhe vjetore në to*, bazuar në plane strategjikë, përmirësimin e risqeve prioritare që pengojnë realizimin e objektivave të institucionit.
- NJAKPA-të funksionojnë në bazë të rregulloreve të funksionimit dhe administrimit, miratuar me VKM-në Nr. 396, datë 31.3.2005, të ndryshuar dhe jo të rishikuar sipas legjislacionit përkatës në vite.
- Strukturat e NJAKPA-ve kanë numër të vogël punonjësish dhe jo në përputhje me nevojat për aftësi profesionale specifike, gjykuar mbi natyrën specifike dhe kushtet në të cilat ndodhen sitet. Kjo ka sjellë mbivendosje të detyrave funksionale, pozicione të dubluara në staf, si edhe mos realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkeseve ligjore të funksionimit.
- NJAKPA-të kanë hartuar rregulloret e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, por janë të pamiratuara, pasi janë në proces rishikimi në Ministrinë e Kulturës. Ky miratim kryhet në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi, pasi miratimi i rregulloreve është kompetencë e bordit dhe jo e ministrisë.
- Reformat strukturore kanë sjellë ndryshimin e titullarëve të NJAKPA-ve dhe DRTK-ve dhe në disa raste funksionon komandimi ose emërimi i përkohshëm i tyre. Komandimi ose emërimi i përkohshëm i titullarëve, jo sipas procedurave të përcaktuara në VKM Nr. 173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institacioneve, në varësi të KM, Kryeministrit ose të Ministrit”, të ndryshuar, ndikon në efektivitetin e institucionit.

- DRTK Vlorë gjatë periudhës objekt auditimi ka funksionuar me statutin dhe rregulloren bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar. Bazuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 27/2018 Ministria e Kulturës nuk ka miratuar statutin e hartuar nga titullari i DRTK-së Vlorë. Ky statut është në proces rishikimi pranë ministrisë.
- Grupi konstatoi se, bashkëpunimi ndërinstitucional midis institacioneve qendrore, NJVQV-ve dhe institucioneve të tjera shtetërore, ka qenë i dobët, për shkak të paqartësive të Ligjit Nr. 9048/2003, të ndryshuar, mosrishi kimit të akteve nënligjore në zbatim të tij, moskoherencës së tij me ligjet e tjera, si edhe mungesës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri. Kjo ka sjellë mosrespektim të hierarkisë së institacioneve qendrore që merren me sitet arkeologjike.
- Në kundërshtim të pikës dh) të nenit 267, të Ligjit Nr. 27/2018, nuk është miratuar VKM-ja në lidhje me përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin. (përjashtuar Butrintin si pasuri botërore dhe zonën mbrojtëse të tij).
- Në kundërshtim të pikës ll) të nenit 268, të Ligjit Nr. 27/2018, nuk është miratuar udhëzimi për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përgjedhjes së subjekteve.
- Në kundërshtim të pikës ç) të nenit 264 MK nuk ka nxjerrë “Udhëzim për rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore”.
- Ekziston konflikti aktual mes rregulloreve të zonave të mbrojtura arkeologjike dhe disiplinës urbane, ku kjo e fundit është kompetencë e NJVQV. Kjo vjen nga paqartësitë e ligjit të vjetër dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pushtetit vendor lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së territorit të tyre si edhe mos harmonia me ligjet e tjera. Ky problem nuk ka patur një trajtim në themel të problematikës ligjore, por vetëm institucional, korrespondence zyrtare ndërmjet MK-së, IKTK-së dhe institucioneve të tjera që lidhen me menaxhimin e siteve.

Rekomandimi:

2.1 Ministria e Kulturës dhe NJAKPA-të të rishikojnë ekzistencën e bordeve dhe të bëjnë analizën e eficiencës së tyre në menaxhimin e siteve arkeologjike, për minimizimin e risqeve dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.2 Ministria e Kulturës, të rishikojë legjislacionin aktual, për të saktësuar dhe rregulluar *hierarkinë e institucioneve qendrore* dhe të *këshillave kombëtare* që *ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore* dhe *procedurat e vendimmarrjes së tyre* për sitet arkeologjike, për të *shmangur mbivendosjen e kompetencave*.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.3 Ministria e Kulturës, BKPKB dhe NJAKPK Butrint të përshpejtojnë procedurat për zbatimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Butrintit (PMI).

Të fillojë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.4 NJAKPA-të, bazuar në nenin 142 të Ligjit Nr. 27/2018 dhe strukturat përkatëse në Ministrinë e Kulturës të bashkëpunojnë për hartimin dhe miratimin e planeve të menaxhimit të parqeve brenda territorit gjeografik të tyre, si një domosdoshmëri për administrimin, koordinimin dhe hartimin e planeve të zhvillimit, projekteve, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e tyre.

Të fillojë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.5 Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Kulturës dhe NJAKPA-të të bashkëpunojnë për hartimin e planit të veprimeve të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, me qëllim hartimin e planeve strategjike afatmesëm dhe vjetore të NJAKPA-ve bazuar në të, për minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë realizimin e tyre.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.6 Emërimi i titullarit të DRTK-së Vlorë të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në VKM-në nr. 173, datë 07.03.2003 të KM “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institacioneve, në varësi të KM, Kryeministrit ose të Ministrit”, të ndryshuar.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.7 Ministria e Kulturës, në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 171, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave VKM-në “Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore”.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.8 Ministria e Kulturës në bashkëpunim me NJAKPA-të, bazuar në strategjinë e miratuar dhe me hartimin e menjëhershëm të planit të veprimit për realizimin e saj, të mundësojë hartimin e strategjive të koordinimit dhe monitorimit të projekteve me donatorët në sitet arkeologjike.

Brenda vitit 2021

2.9 Ministria e Kulturës dhe NJAKPA-të deri në miratimin e strukturave të reja bazuar në Ligjin Nr. 27/2018, të bashkëpunojnë që strukturat ekzistuese të funksionojnë në përputhje me nevojat për aftësi profesionale, gjykuar mbi natyrën specifike dhe kushtet në të cilat ndodhen parqet, duke rivlerësuar numrin e nevojshëm të administratës për t'i dhënë prioritet stafit teknik e mirëmbajtës, i cili aktualisht është i pamjaftueshëm dhe nuk arrin të përmbytë, realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkësave ligjore të funksionimit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.10 Bazuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 27/2018, Ministria e Kulturës të miratojë statutin e hartuar nga titullari i DRTK-së Vlorë.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.11 NJAKPA-të me miratimin e rregulloreve të tyre nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Kulturës të rishikojnë dosjet e personelit, bazuar në aktet e reja nënligjore në fuqi.

Brenda vitit 2021

2.12 Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës 1, të nenit 142, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojë dhe të dërgojë për miratim në KM vendimin për kufijtë e territorit gjeografik brenda të cilit ushtrojnë veprimtarinë e tyre NJAKPA-të.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.13 Ministria e Kulturës në bashkëpunim me NJAKPA-të dhe në zbatim të pikës 9, të nenit 142, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojnë dhe të dërgojnë për miratim në KM vendimin për strukturën dhe organikën e NJAKPA-ve.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.14 Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës 1, të nenit 96, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojë dhe të dërgojë për miratim në KM vendimin në lidhje me përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.15 Ministria e Kulturës në zbatim të pikave 1 dhe 4, të nenit 102, të Ligjit Nr. 27/2018, të miratojë udhëzimin për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.16 Në zbatim të pikës 3 të nenit 12 të ligjit Ministria e Kulturës të nxjerrë udhëzimin për rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

2.17 Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet e tjera të pëershpejtojë nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, për të shmangur konfliktin midis rregullores së zonave të mbrojtura arkeologjike dhe disiplinës urbane. Trajtimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre të realizohet me akte nënligjore konkrete dhe jo korrespondence të thjeshtë zyrtare.¹

Brenda vitit 2021

2.18 Ministria e Kulturës, bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, të hartojë planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e ligjit për

¹ https://translate.google.com//kultura.gov.al/ëpcontent/uploads/2017/12/Raport_ne_komis_parlm.doc
Rruga “Abdi Toptani”, Nr.1, www.klsh.org.al, email: klsh@klsh.org.al

trashëgiminë kulturore dhe muzetë, ligjet të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombe të për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara, për kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut.

Brenda vitit 2021

2.19 Ministria e Kulturës, NJAKPA-të në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, lidhur me bizneset e ngritura brenda parqeve arkeologjike dhe me marrëdhëniet që ato kanë me operatorët privatë që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre, të rishikojnë aktet nën ligjore bazuar mbi parimet, ligjet dhe konventat kombëtare dhe ndërkombe të për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore që sitet mbartin dhe kthimin e tyre në identitet.

Brenda vitit 2021

III. Për pyetjen audituese: A janë ndërmarrë masa efektive për mbrojtjen e parqeve/siteve arkeologjike?

Gjetje nga auditimi:

- IKTK dhe MK aktualisht nuk kanë hartuar e miratuar kriteret e hulumtimeve arkeologjike dhe standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale as mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore referuar nenit 29 pika 4, nenit 30 pika 6 dhe nenit 82 të Ligjit Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".
- Për parqet Arkeologjike nën subjekt auditimi Apolloni, Bylis, Amantia Orikum nuk janë hartuar ende plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore referuar nenit 45 dhe 46 të legjisacionit te ri, Ligjit Nr. 27/2018. Realizimi i këtyre planeve kërkon studim gjithëpërfshirës dhe angazhim të të gjithë institucioneve përgjegjës por deri me sot nuk ka asnjë arritje në këtë drejtim për parqet e sipër përmendura.
- Në parqet arkeologjike intensiteti dhe numri i projekteve të gërmimeve shkencore apo restaurimeve dhe rehabilitimeve është i ulët. Ka pak punime e ndërhyrje edhe ato që kryhen janë të izoluara dhe të shpërndara. Referuar vlerësimëve gjatë inspektimeve dhe pohimeve gjatë intervistimeve të titullarëve pjesa me e madhe e zonave arkeologjike ka nevojë për aktivitete sistematike të gërmimeve shkencore, rehabilitimeve e aktivitetit konservues sepse ato kanë një potencial të madh objektesh të trashëgimisë kulturore ende të pagërmuar.
- Aktualisht nuk ka një procedurë të miratuar të kontrollit teknik dhe nuk ka asnjë kontroll teknik të dokumentuar me raporte përkatës për periudhën objekt auditimit në sitet e përcaktuara referuar nenit 71 të ligjit Nr. 27/2018.
- Bazuar në nenin 27 dhe 28 pikat 2, 3 e ligjit Nr. 27/2018 IKMTK nuk ka të dokumentuar asnjë veprimtari si institucion i specializuar në lidhje me ecurinë e gërmimeve arkeologjike në tokë dhe ato nënijore, masat mbrojtëse mbi pasuritë kulturore të paluajtshme në të gjithë territorin kombëtar, masat ruajtëse të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, masa të ruajtjes, mbrojtjes dhe cilësisë së punimeve të restaurimit të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme etj. Vendimi për mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore nuk është miratuar dhe struktura dhe as

organika e tij. Ai duhet të ishte i miratuar që në Maj të 2019 dhe struktura dhe organika e tij e miratuar brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi e vendimit.

- Parqet arkeologjike Bylis, Amantia dhe Orikum nuk kanë ndriçim dhe nuk janë të mbuluara me ruajtje fizike.

Rekomandimi:

3.1 Institucionet e specializuara përgjegjëse dhe Ministria e Kulturës të marrin masa të përfundojnë hartimin dhe miratimin e kritereve të hulumtimeve arkeologjike dhe standardet e kriteret për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale si dhe mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërrhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

3.2 Ministria e Kulturës, në koordinim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Njësinë e Administrimit e Koordinimit të Parqeve Kombëtare Apolloni Bylis dhe Drejtori Nëtë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë të marrin masa për hartimin e Planeve për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore për parqet arkeologjike. Nëpërmjet një plani afatgjatë të synohet ndërtimi i një sistemi menaxhimi modern i këtyre parqeve arkeologjike duke përfshirë restaurimin dhe konservimin e monumenteve, rehabilitimin tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, duke pasur si qëllim shndërrimin e tyre në qendra me aktraktive.

Deri në fund të vitit 2022

3.3 Me qëllim ruajtjen e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në parqet arkeologjike nga institucionet përgjegjëse dhe MK të merren masa ti kushtohet më shumë vëmendje këtij sektori e të planifikohet një aktivitet sistematik për ndërrhyrjet e lejuara. Gjithashtu të merren masa për hartimin edhe të projekteve apo ideve për promovimin e parqeve, krahas projekteve për ndërrhyrjet në monumente, në mënyrë që të rritet vizitueshmëria e tyre, duke gjeneruar kështu më tepër të ardhura nga to te cilat mund ti akordohen komponentëve të mirëmbajtjes dhe ndërrhyrjeve në monumente.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

3.4 MK të marrë masa për hartimin e udhëzimit për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik në mënyrë që Institucionet e specializuara, të ushtrojnë kontrollin teknik mbi kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore të paluajtshme.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

3.5 MK të marre masa e të filloje hartimin e draft vendimit për mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrotjtjen e Trashëgimisë Kulturore në vazhdim, sipas afateve të parashikuara të miratohet struktura dhe organika e tij.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

IV. Për pyetjen audituese: A janë efektive strukturat përgjegjëse për kryerjen e proceseve sistematike në ruajtjen e parqeve/siteve arkeologjike?

Gjetje nga auditimi:

- Në Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit te Parqeve Arkeologjike Apolloni e Bylis dhe Amantia e Orikum përgjegjësit e sektorëve të parqeve dhe punonjësit e mirëmbajtjes kryejnë detyrat rutinë por pa një plan me masa konkrete apo një plan zhvillimi afat shkurtër dhe afatgjatë dhe programe sistematike për ruajtjen e vlerës së paluajtshme kulturore dhe masa konkrete për zbatimin e planit në përputhje me një strategji.
- Struktura përgjegjëse për parqet Amantia dhe Orikum në DRKT Vlorë po ashtu edhe ZAKPA për parqet Apolloni dhe Bylis janë të shpërndara në distanca të largëta dhe punonjësit nuk kanë mjete për ndjekjen e aktivitetit të të gjitha parqeve, rrjedhimisht për kryerjen eficiente të funksioneve te tyre.
- Strukturat e sipërpërmendura nuk janë të mjaftueshme për të kryer funksionin e ruajtjes fizike të siteve. Përveç Parkut Arkeologjik të Butrintit e Apollonisë të cilët ruhen me roje private, Parqet Bylis, Amantia dhe Orikum nuk kane asnjë punonjës për ruajtjen e tyre.

Rekomandimi:

4.1 DRKT Vlorë dhe ZAKPA Fier të marrin masa e të hartojnë programe e plane sistematike afatshkurtra e afatgjata për ndërhyrjet të nevojshme për të zhvilluar dhe ruajtur territorin arkeologjik të parkut.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vazhdimësi

4.2 Me qëllim rritjen e eficiencës së punës DRKT Vlorë dhe ZAKPA Fier të marrë masa për të analizuar nevojat specifike për forcimin e kapaciteteve dhe për administrimin ruajtjen dhe mbrojtjen e parqeve e të propozojë për miratim, Ministrisë së Kulturës strukturë të plotë sipas nevojave.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

4.3 DRKT Vlorë dhe ZAKPA Fier në bashkëpunim me Ministrinë të analizoje nevojat logjistike për ambiente shërbimi në parqe, vegla pune dhe mjete lëvizëse për kryerjen eficiente të funksioneve për ruajtjen dhe mbrojtjen dhe të merren masat e nevojshme për plotësimin e nevojave.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

4.4 Nga DRKT dhe NJKPA të analizohet mënyra me eficente për të kryer ruajtjen fizike të çdo siti. Për shkak të shtrirjes së parqeve arkeologjike dhe morfologjisë se tyre të analizohet mundësia për sistemet elektronike të kontrollit me kamera të shpërndara në pikat me te përshtatshme e strategjike të parqeve, të cilat mund të lidhen me një salle të vetme monitorimi ku një roje i vetëm ka mundësi të kontrollojë gjithë veprimitarën e situatën si gjatë ditës dhe gjatë natës si për dëmtime, zjarre apo ndërhyrje të paligjshme të çdo lloji.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

V. *Për pyetjen audituese: A janë ndërmarrë masa efektive për të siguruar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin publik të parqeve/siteve arkeologjike?*

Gjetje nga auditimi:

- Gjendja e degraduar e rrugës i bën shumë të vështira vizitat e turistëve në parkun arkeologjik të Bylisit.
- Procedurat dhe kriteret që duhet të përbushen për të pasur akses në parkun arkeologjik të Orikumit, janë një pengesë e madhe për turistët dhe një mundësi më pak, për t'u siguruar vizitorëve një qasje atraktive me këtë aset historiko – kulturor.
- Ka pamjaftueshmëri tabelash orientuese për në parkun arkeologjik Apoloni, si dhe mungon tabela rrugore standarde, që orienton vizitorët për te lënë rrugën e Lumit të Vlorës dhe për t'u ngjitur në drejtim të kodrës, ku ndodhet siti arkeologjik i Amantias.
- Lëvizja e vizitorëve për në sitet e largëta të Bylisit dhe të Amantias nuk është e mbuluar aspak nga linjat e transportit publik. Ndërkohë Ligji 27/2018 shprehet qartë se si bashkëpunohet në nivele të ndryshme lidhur edhe me sitet arkeologjike: "Autoritetet shtetërore qendrore dhe njësítë e vetëqeverisjes vendore bashkërendojnë punën, koordinojnë, harmonizojnë dhe integrojnë aktivitetet, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe krijojnë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.".
- Ajo që konstatohet nga materiali i studiuar dhe nga inspektimet në terren, pranë P. A. Amantia është moskoordinimi ndërinstitucional për të zgjidhur në themel çështjen e staneve të ngritura në këtë sit, pavarësisht zellit dhe përkushtimit të DRKK –së Vlorë. Prania e staneve është duke degraduar mjedisin dhe duke krijuar vështirësi të papranueshme për vizitorët, të cilët duhet të kalojnë në parcela të kufizuara nga gardhet e tyre dhe që kutérbojnë erë të keqe.
- Në Parkun Kombëtar të Butrintit ka mungesë të ndjeshme vendesh parkimi për makinat dhe autobusët, me të cilat udhëtojnë vizitorët. Çështja është diskutuar në të gjitha nivelet dhe duhet të marrë një zgjidhje përfundimtare, duke qenë e përfshirë edhe në Planin e Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar Butrint 2020 - 2030
- Në Parkun Kombëtar Butrint problemi i radhëve të gjata në biletari është shumë i mprehtë dhe krijon shqetësim tek vizitorët.
- Mungojnë krejtësisht shërbimet higjeniko – sanitare në parkun arkeologjik të Orikumit dhe në parkun arkeologjik të Amantias. Ndërkohë që në këto dy parqe mungojnë edhe linjat elektrike. Ndërsa Parku Kombëtar Butrint ka nevojë të restaurojë shërbimet higjeniko – sanitare tek Kalaja dhe të instalojë nyje higjenike të reja, sikurse konstatuar dhe vënë në dukje kjo domosdoshmëri edhe në mbledhjet e Bordit Kombëtar të Parkut të Butrintit.
- Përjashtuar Parkun Kombëtar Butrint, në parqet e tjera arkeologjike mungojnë këndet e shitjes së souvenireve, pijeve freskuese dhe prodhimeve të zonës. Nxjstra dhe përfshirja në njësitë tregtuese, që mund të bëhen pjesë e këtyre realitetev turistike, e operatorëve që shesin souvenire dhe produkte vendase sezonalisht, do ishte një ndihmë dhe mundësi ekonomike për komunitetet lokale.
- Në strukturën dhe organikën e parqeve arkeologjike, nuk parashikohen pozicione me detyrë funksionale, vetëm shoqërimin e vizitorëve.
- Edhe në raport me rekrutimet e punonjësve sezonalë të cilët ofrojnë shërbimin e guidës vihet re se, ose rritja e numrit tyre ka mbetur e njëjtë, si në rastin e ZAKPA Apoloni, ose nuk ka patur asnjë punësim sezonal për të ofruar këtë shërbim, sikurse në rastet ZAKPA Bylis, ZAKPA Butrint, DRTK Vlorë (Sektori i Parqeve Amantia-

Orikum) në vitin 2019, pavarësisht se fluksi i vizitorëve është rritur progresivisht vit pas viti.

- Në parqet arkeologjike të Amantias dhe të Orikumit sinjalistika orientuese dhe shpjeguese ka nevojë për përmirësim. Në brendësi të Parkut të Bylis, duhen vendosur tabelat, të cilat mungojnë krejtësisht që nga viti 2019.
- Në organigramën dhe strukturën e NJAKPA – ve mungon pozicioni me detyrë funksionale dedikuar marrëdhënieve me publikun”.
- Në sitet arkeologjike të audituara, vizitat e turistëve zhvillohen pa mbështetjen e teknologjive të audioguidës dhe të videoguidës.

Rekomandimi:

5.1 Ministria e Kulturës të formulojë një plan veprimi, me qëllim rikualifikimin e rrugës që çon në parkun arkeologjik të Bylisit dhe ta materializojë me veprime konkrete, të cilat synojnë sensibilizimin e gjithë faktorëve që mundësojnë zgjidhjen.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

5.2 Ministria e Kulturës të vlerësojë me propozimet e bëra nga Ministria e Mbrojtjes, lidhur me mundësinë e ndërtimit të rrugës alternative dhe të marrë masa në bashkëpunim me pushtetin lokal, për dhëni e një zgjidhjeje përfundimtare për problematikën e hyrjes pa pengesa të vizitorëve në parkun arkeologjik të Orikumit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

5.3 ARRSH - ja të plotësojë tabelat që mungojnë drejt parkut arkeologjik Apoloni, sikurse kërkuar nga NJAKPA Apoloni – Bylis, si dhe të vendosë tabelën që orienton drejt sitit arkeologjik të Amantias, në pikën e lënies të rrugës së Lumit të Vlorës.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

5.4 NJAKPA e Bylisit dhe Amantias të kërkojnë zgjidhjen e problemit të transportit publik me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore nën juridiksion territorial të të cilave janë, duke siguruar transportin publik për këto dy site, të paktën gjatë sezonit turistik.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

5.5 DRKK Vlorë në koordinim të ngushtë dhe me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, si dhe duke përfshirë të gjitha institucionet që kanë kompetencat përkatëse ligjore, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për heqjen e staneve dhe rehabilitimin e Zonës A të parkut arkeologjik të Amantias.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

5.6 Bordi i Parkut Kombëtar të Butrintit dhe Ministri i Kulturës, në cilësinë e Kryetarit të këtij Bordi, në përgjigje të nevojës së rritjes së sipërfaqes së parkimit, të kërkojë pranë Këshillit të Ministrave, vënien në dispozicion të një mjeti të përshtatshëm për këtë qëllim.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- 5.7 Bordi i Parkut Kombëtar Butrint dhe AADF, të cilit i është dhënë me koncesion shërbimi i biletarisë së Parkut, të vlerësojnë dhe të marrin masa për rritjen e numrit të sporteve të biletarisë.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- 5.8 Ministria e Kulturës dhe DRKK Vlorë të përgatisin projektet përkatëse për garantimin e kushteve higjeniko – sanitare, si dhe shtrirjen e linjave elektrike në P. A. të Orikumit dhe në P. A. të Amantias. Ministria e Kulturës të sigurojë mbështetjen buxhetore për realizimin e këtyre nismave. Për Parkun Kombëtar të Butrintit të miratohet restaurimi i shërbimeve higjenike dhe të parashikohet shtimi i nyjeve të tjera higjenike.

Brenda vitit 2021

- 5.9 DRKK Vlorë të marrë kontakt me Dhomën e Tregtisë Vlorë, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore dhe operatorë tregtarë vendas, me synimin për të sugjeruar dhe mundësuar çeljen e pikave, që ofrojnë një gamë minimale produktesh tipike të zonës, gjatë sezonit turistik.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- 5.10 NJAKPA – të në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të vlerësojnë dhe të ndjekin procedurat e nevojshme për të propozuar miratimin e strukturave dhe organikave të reja, për NJAKPA – të, në të cilat të parashikohen pozicione me detyrë funksionale vetëm shoqërimin e vizitorëve, si dhe ai me detyrë funksionale dedikuar administrimit të marrëdhënieve me publikun.

Brenda vitit 2021

- 5.11 NJAKPA – të të parashikojnë nevojat për punonjës sezonali, në kushtet e rritjes së fluksit të vizitorëve në sitet arkeologjike gjatë sezonit turistik dhe të ndjekin gjithë procedurën e parashikuar për punësimin e tyre.

Brenda dymbëdhjetë muajsh

- 5.12 ZAKPA Bylis të marrë të gjitha masat për vendosjen e tabelave orientuese dhe shpjeguese në parkun arkeologjik të Bylisit, sikurse dhe DRTK Vlorë, të marrë të gjitha masat për plotësimin dhe përmirësimin e tabelave orientuese dhe shpjeguese në parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikumit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- 5.13 Ministria e Kulturës dhe NJAKPA – të të ngrenë një grup të përbashkët pune, për të diskutuar, vlerësuar dhe vendosur, mbi nevojat dhe mundësitet efektive për futjen e përdorimit të teknologjive të audioguidave dhe videoguidave.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

VI. Për pyetjen audituese: Sa efektive rezultojnë masat e ndërmarra për njohjen dhe promovimin e parqeve/siteve arkeologjike?

Gjetje nga auditimi:

- Mungon një bashkëpunim formal dhe i thelluar midis MK - së e institucioneve në varësi të saj, të dedikuara me parqet arkeologjike, nga njëra anë dhe AKT – së ana tjeter, e cila ka si mision promovimin e turizmit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkontrollor dhe krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkontrollor.
- Mungon bashkëpunimi i ngushtë dhe rezultativ midis MK – së, NJAKPA –ve nga njëra anë dhe shoqatave të operatorëve turistike shqiptarë nga ana tjeter.
- Mungesa e një webfaqeje zyrtare të administruar nga MK – ja në ndërveprim me NJAKPA – të, ku të përfshihet informacioni i detajuar dhe i certifikuar, mbi të gjitha parqet arkeologjike shqiptare.
- Sitet arkeologjike jo gjithnjë kanë në dispozicion materiale të mjaftueshme informuese për t'ua dhënë vizitorëve.
- Në parqet arkeologjike të Bylisit, Amantias dhe Orikumit aktivitetet kulturore të realizuara kanë qenë të pakta në periudhën objekt auditimi.
- Nuk ka një pjesëmarrje në aktivitetet e parqeve të Butrintit dhe Apolonisë nga nxënësit e shkollave të Tiranës, si dhe të qyteteve të tjera të vendit.
- Ministria e Kulturës nuk ka asnjë program financimi për prodhimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike shqiptare. Ndryshe nga rasti i nënshkrimit të Memorandumit me MAS për “Edukim përmes kulturës”, e vlerësuar si përvjohje pozitive, ajo nuk ka nënshkuar asnjë marrëveshje me Televizionin Publik Shqiptar, qoftë për prodhimin e tyre, qoftë dhe për transmetimin e tyre periodik, sikurse nuk ka përpunuuar asnjë plan veprimi në drejtim të nxitjes së kanaleve televizive private, që reportazhet dhe dokumentarët mbi sitet arkeologjike, të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

Rekomandimi:

6.1 Ministria e Kulturës të përgatisë dhe t'i propozojë Agjencisë Kombëtare të Turizmit nënshkrimin e një “Memorandumi bashkëpunimi”, lidhur me mënyrën dhe kriteret e promovimit të parqeve arkeologjike shqiptare, në nivel kombëtar dhe ndërkontrollor.

Brenda dymbëdhjetë muajsh

6.2 Ministria e Kulturës së bashku me institucionet e varësisë, të ngrejë një grup pune me synim përgatitjen e një plani ndërveprimi me shoqatat e operatorëve turistikë, i cili duhet të ketë si objektiv, nxitjen e përfshirjes së siteve arkeologjike shqiptare në stacionet e itinerareve turistike të të huajve që vizitojnë Shqipërinë.

Brenda dymbëdhjetë muajsh

6.3 Ministria e Kulturës në ndërveprim me IKT – në dhe NJAKPA – të, të ngrejë një grup pune, i cili duhet të përcaktojë strukturën e një faqeje zyrtare ku të përfshihen të gjitha sitet arkeologjike të vendit tonë dhe më pas të krijojë e administrojë faqen e parqeve arkeologjike shqiptare.

Brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2021

6.4 NJAKPA – të Bylis dhe Orikum në bashkërendim me MK – në, të marrin masa që të mos kenë mungesa të fletëpalosjeve informuese mbi vlerat e parqeve përkatëse dhe të sigurojnë eksplorimin e tyre të vazhdueshëm në hyrje të siteve.

Brenda gjashtë muajsh dhe në vijimësi

6.5 NJAKPA – të e Bylisit, Amantias dhe Orikumit, të përgatisin një program në fillim të vitit mbi aktivitete që do zhvillojnë gjatë vitit për njojhen e këtyre siteve.

Brenda gjashtë muajsh dhe në vijimësi

6.6 Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të kërkojnë dhe gjejnë modalitetet me të cilat t'u mundësohen nxënësve të shkollave, vizitat në sitet kryesore arkeologjike të vendit.


Brenda gjashtë muajsh dhe në vijimësi

6.7 Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë të cilat administrojnë sitet arkeologjike, të ngrejnë një grup pune, i cili duhet të përgatisë një plan veprimi që parashikon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si me Televizionin Publik Shqiptar, për realizimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi parqet dhe trasmetimin e tyre periodik, ashtu dhe me televizionet private, të cilat të angazhohen që reportazhe dhe dokumentarë mbi realitetin arkeologjik shqiptar të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

Brenda gjashtëmuorit të dytë të vitit 2021

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkese si dhe në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

K R Y E T A R





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI



Nr. Prot. 646/
5


Tiranë, më 30/4/2021

Miratohet

Raport Auditimi Performance

**“EFEKTIVITETI I POLITIKAVE NË
RUAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E
SITEVE ARKEOLOGJIKE, PËR
PERIUDHËN 2016-2019”**

KRYETAR
ARBEN SHEHU





Yllka PULASHI

Drejtor i Departamentit



Prill 2021

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 646/1 prot., datë 30.09.2020, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Faza studimore e auditimit nisi në datë 02.07.2020 me shkresën për njoftim-fillim auditimi nr. 646 prot., datë 02.07.2020. dhe përfundoi më datë 15.09.2020.

Faza e terrenit të auditimit nisi në datë 15.09.2020 me Programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi në 15.10.2020.

Projekt-Raporti i auditimit mori formë përfundimtare më datë 26.11.2020 dhe me shkresën nr. 646/2 prot., datë 26.11.2020 iu përcoll subjekteve nën auditim, respektivisht, Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të varësisë: Institut Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, Parkut Kombëtar Butrint, Njësisë së Administrimit dhe Kordinimit të Parqeve Arkeologjike Apolloni dhe Bylis.

Pesë subjektet e audituara, nuk përcollën pranë KLSH asnjë obsevacion mbi Projekt-Raportin, ndaj dhe grupi i auditimit procedoi mbi bazën e Projekt Raportit dhe konfirmimit të plotë të tij, në hartimin e Raportit.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

Z. Ardian Simoni (Përgjegjës Grupi)
Znj. Marjana Lako (Anëtare)
Znj. Megi Rusi (Anëtare)

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kontrollit të Cilësisë dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.

PËRMBAJTJA

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT	5
1.1. Konteksti i problemit social.....	6
1.2. Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës	7
1.3. Auditime të mëparshme në këtë fushë.....	8
1.4 Subjektet nën auditim	8
1.4.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	10
1.4.2. Politikat e institucioneve	13
1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB	14
1.4.4. Risqet e aktivitetit të subjektit	15
1.4.5. Rëndësia e produkteve të subjektit.....	18
1.4.6. Feedback-u i subjektit gjatë auditimit	18
2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT	18
2.1. Objektivi dhe problemi i performancës	18
2.1.1. Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës	18
2.1.2. Objektivi i auditimit	19
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia.....	19
2.3 Kriteret	21
2.3.1 Kriteret e politikës.....	21
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit	21
2.3.3 Kriteret teknike	21
2.3.4 Kriteret e tjera	22
2.4 Piramida E Pyetjeve Të Auditimit	23
2.5 Skema e auditimit	24
2.5.1. Qasja/metodologjia e auditimit	24
2.5.2. Metodat/teknikat audituese	24
2.6. Rezultatet e parashikuara.....	25
2.6.1. Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë	25
2.6.2. Impakti për publikun dhe palët e interesit.....	25
2.6.3. Forma e publikimit.....	26
2. SHTJELLIMI I I PIRAMIDËS SË PYETJEVE TË AUDITIMIT	27
3.1 A është hartuar një kuadër ligjor dhe strategjik i plotë për ruajtjen dhe administrimin e parqeve/siteve arkeologjike?	27
3.1.1 Sa efektiv është kuadri rregulator për parqet/sitet arkeologjike?	27
3.1.2 Sa efektive janë njësitë e administrimit dhe koordinimit të parqeve/siteve arkeologjike?	45
3.2 A janë zbatuar në mënyrë të përshtatshme politikat për ruajtjen dhe mbrojtjen e parqeve/siteve arkeologjike	62
3.2.1 A janë ndërmarrë masa efektive për mbrojtjen e parqeve/siteve arkeologjike?	62
3.2.2 A janë efektive strukturat përgjegjëse për kryerjen e proceseve sistematike në ruajtjen e parqeve/siteve arkeologjike?	69
3.3 A janë ndërmarrë masa efektive për valorizimin e parqeve/siteve arkeologjike?	73
3.3.1 A janë ndërmarrë masa efektive për të siguruar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin publik të parqeve/siteve arkeologjike?	73
3.3.2 Sa efektive rezultojnë masat e ndërmarra për njohjen dhe promovimin e parqeve/siteve arkeologjike?	90
4. PËRMBLEDHJE	104
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	106

< LISTA E SHKURTIMEVE

RSH	- Republika e Shqipërisë
KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
INTOSAI	- Organizata Ndërkombejtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
EUROSAI	- Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit.
SAI	- Institucioni Suprem i Auditimit
KLSH	-Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	-Bashkimi Evropian
MK	-Ministria e Kulturës
SA	-Site arkeologjike
TK	-Trashëgimia Kulturore
SA	-Site Arkeologjike
IMK	-Instituti i Monumenteve të Kulturës
ASHA	-Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike
DRKK	-Drejtoria Rajonale Kulturës Kombëtare
DRTK	-Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore
IKTK	-Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
DPPSTK	-Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë Kulturore
BKPA	-Bordi Kombëtar i Parqeve Arkeologjike
DTKMM	-Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturore, Materiale dhe Muzeve
DSHA	-Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik
KKR	-Këshilli Kombëtar i Restaurimeve
DKA	-Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë
QRRKMK	-Qendra Rajonale për Restaurimin dhe Konservimin e Monumenteve të Kulturës.
KKTKM	-Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM)
KKMPK	-Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore (KKMPK)
QKIPK	-Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore
IKMTK	-Inspektoriat Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore
IKRTK	-Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
RKPK	-Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore
NJAKPA	- Njësia e Administrimit dhe Kordinimit të Parkut Arkeologjik
ZAKPA	- Zyra e Administrimit dhe e Koordinimit të Parkut Arkeologjik
DMK	-Drejtoria e Monumenteve të Kulturës

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim realizimin e misionit të tij, duke u mbështetur në eksperiencat më të mira të vendeve të BE-së, auditon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjera juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka rezultuar me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre.

Nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparent përdorimin e fondeve publike, përgjegjshmërinë në përdorimin e tyre, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike. Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti bëhet në përputhje të plotë me standartet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSASI 2017-2023 të cilat gjunjë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, motoja e së cilës është “KLSH shërbestar i qytetarit”.¹ Bazuar në këtë Strategji, KLSH aspiron që nëpërmjet auditimeve të tij të sjellë vlerë të shtuar në shërbimin ndaj qytetarit, Kuvendit dhe subjekteve publike që auditon, gjithmonë në shërbim të qeverisjes së mirë². Angazhimi i KLSH-së në auditimin e performancës, lidhur me efektivitetin e politikave shtetërore në menaxhimin e siteve Butrint, Apoloni, Bylis, Orikut Amantia, pati si shtysë dëmtimin e dy kolonave të fasadës së fontanës monumentale të Apolonisë në datën 13 prill 2020, gjatë izolimit nga COVID-19. Dëmtime të tillë, vjedhje të objekteve të trashëgimisë kulturore në Apoloni, botuar në gazeten “MAPO” dt. 13 shkurt 2017, gjermimet ilegale në këto site si edhe shumë probleme të tjera të kësaj natyre të konstatuara dhe të evidentuara mediatikisht për to, bën të domosdoshëm këtë auditim me synim transparencën në përdorimin dhe mirëmenaxhimin e pronës publike. Trashëgimia Kulturore luan një rol të rëndësishëm në krijimin e vlerave kombëtare dhe identitetit të një kombi. Gjithashtu, ajo luan një rol të rëndësishëm në edukimin e vlerave qytetare, demokratike dhe zhvillimin e ekonomik të vendit. SA janë asete kombëtare, me vlera të jashtëzakonshme jo vetëm historike, kulturore, sociale dhe ekonomike, por mund të quhen themelë të një kombi me lidhje të drejtëpërdrejtë me të gjitha politikat e tjera të zhvillimit të tij dhe orientimin drejt BE. Krahas vlerave në planin kombëtar, SA mbartin vlera dhe në planin ndërkontinentar, qoftë si dëshmi autentike të kulturës vendase, qoftë si interpretime madhore gjinish, brenda hapësirash të gjera kulturore, në të cilat u përfshinë natyrshëm shqiptarët në shekuj. Shqipëria është një vend i pasur në trashëgimi kulturore, të të gjitha epokave e prej shumë origjinash, përballet qytetërimet e tjerë që e rrrethojnë. Për të qenë dëshmi e historisë, kulturës dhe zhvillimit, këto site dhe të gjitha monumentet e kulturës duhet të mirëmenaxohen dhe mbrohen nga të gjithë, veçanërisht nga institucionet përkatëse shtetërore të cilat janë përgjegjëse për to.

Trashëgimia Kulturore na lejon të kuptojmë më mirë gjeneratat e mëparshme dhe historinë nga ku kemi ardhur. Si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, qytetet historike dhe vendet që mbartin trashëgimi kulturore, tashmë shihen si motorët e mundshëm të zhvillimit ekonomik lokal dhe një burim të ardhurash e stabiliteti social për komunitetet. Të gjitha këto vlera të marra së bashku, flasin për rëndësinë e këtij auditimi, i cili do të shqyrtojë në thelb veprimtaritë që ndërmerren për ruajtjen dhe administrimin e tyre.

KLSH vazhdimeshtë është angazhuar në evidentimin e çështjeve problematike dhe emergjente që shqetësojnë taksapaguesit shqiptarë me qëllim promovimin e vlerës dhe përfitimeve të punës së institucioneve supreme të auditimit, të cilat kanë si synim kryesor forcimin e llogaridhëni, transparencën dhe integrititetin e qeverisjes dhe institucioneve publike. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, me qëllim mbrojtjen e interesave publike si edhe përmirësimin e cilësisë së jetës, nëpërmjet këtij auditimi synon të japë rekomandimet e duhura për përmirësimin e procesit të menaxhimit të sítave

¹ Strategjia e Zhvillimit KLSH fq. 54

² Strategjia e Zhvillimit KLSH fq. 56

arkeologjike, në përputhje me bazën ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe praktikat e mira të vendeve të zhvilluara.

1.1. Konteksti i problemit social

Sitet arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, të çfarëdo lloj natyre dhe kulture, mjedisë social dhe natyror, përkatesie të të njëjtët civilizim klasik mesdhetar, varësie, menaxhimi, madhësie apo pozicioni gjeografik ku ndodhen, kanë qenë dhe do të mbeten një faktor i rëndësishëm i zhvillimit historik, kulturor dhe social ekonomik në vendin tonë. Siç u përmend më sipër, sitet arkeologjike krijojnë mundësinë e nxitjes dhe aktivizimit të të mirave materiale dhe shërbimeve, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht të komuniteteve përreth, të cilët e kanë kuptuar se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me kontekstin në të cilin jetojnë dhe punojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor dhe shërben si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës. Meqenëse trashëgimia kulturore materiale është një prej burimeve më të rëndësishme kombëtare në vend, i cili nuk ripërtërihet, duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi.

Duke qenë atraksione turistike të rëndësishme dhe falë ndërthurjes së pasurive ekologjike dhe arkeologjike, të njohura tashmë në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, sitet arkeologjike zënë një vend të veçantë në spektrin e ashtuquajtur të “destinacioneve ekoturistike”.

Në ditët e sotme, koncepti i sitit arkeologjik po ndryshon drejt një perspektive të re që nuk bazohet vetëm në aspektet mbrojtëse, por edhe në zhvillimin ekonomik si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë. Kjo do të thotë që koncepti i sitit arkeologjik nuk mund të kufizohet vetëm në rregullat mbrojtëse strikte, por duhet trajtuar në një perspektivë sistemike për të plotësuar nevojat e popullsisë, për të ngritur ekonominë dhe mirëqenien e tyre drejt standardeve evropiane.

Menaxhimi i siteve arkeologjike, përballja me çështje kontradiktore lidhur me, zotërimin e pronësisë, gjërmimin, konservimin, ndryshimet klimatike globale, ndotjen, ruajtjen e asaj që ekziston, që është e njohur, e pranuar dhe e kuptuar dhe asaj ç'ka është akoma për t'u zbuluar dhe nevojës për ta shfrytëzuar këtë burim përfitime socio-ekonomike të komuniteteve lokale, aksesueshmërinë për publikun, financimin, etj, të cilat janë në qendër të politikave të institucioneve shtetërore që merren me to, ka mangësi të cilat shfaqen dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve dhe, në kushtet aktuale nuk mund të sigurojnë dhe garantojnë ruajtjen e tyre, duke rrezikuar dhe ekzistencën e tyre.

Në prill të vitit 2003 u miratua Ligji nr. 9048, datë 7 prill 2003³, ku përvëç Butrintit, u njohën edhe 8 parqet e tjera arkeologjike si: Lezhë, Shkodër, Apoloni, Bylis, Amantia, Orikum, Antigonea, dhe Finiqi. Në dhjetor të vitit 2003 u miratua Rregullorja e Funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit. U krijua Bordi Kombëtar, si bord vendim-marrës dhe rregulloret e administrimit të Parqeve Arkeologjike: Shkodër, Lezhë, Apoloni, Bylis, Amanatia, Orikum, Antigonea, Finiq dhe Butrint. Në këto rregullore u përcaktuan rolet dhe rregullat e menaxhimit të parqeve arekologjike. Në vijim janë miratuar ligjet për mjedisin, për peshkimin dhe akuakulturën, etj. Në nëntor 2005 u përcaktua kompleksi Butrinti si park kombëtar dhe në vijim kemi ndryshime aktesh ligjore dhe nënligjore, etj, deri në miratimin e ligjit nr. 27/2018⁴. Këto kanë sjellë ndryshimin e strukturave drejtuese dhe menaxhuese të ministrisë së linjës dhe të institucioneve të varësisë përgjegjëse për menaxhimin e siteve arkeologjike si edhe ndryshime në statuset e tyre. Reformat strukturore në Ministrinë e Kulturës, agjencitë e varësisë dhe ministritë e tjera që merren me parqet dhe sitet arkeologjike, nuk kanë shmangur ekzistencën e konfliktave në menaxhimin e tyre. Përvëç të tjerash, me daljen e Ligjit të ri 27/ 2018, duhet të theksojmë se mungesa e akteve nënligjore për menaxhimin e parqeve/siteve arkeologjike, mungesa e

³ Ligji nr. 9048, datë 7 prill 2003 “Mbi Trashëgiminë Kulturore”.

⁴ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”.

planeve të menaxhimit të tyre, mungesa e bashkëpunimit me pushtetin vendor, centralizimi i kompetencave si edhe shumë problematika të tjera të shfaqura në vazhdimësi, kanë vënë në rrezik gjithnjë e më shumë ruajtjen dhe administrimin e tyre. Sitet arkeologjike, parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura duhet të vendosin një ekuilibër midis përdorimit dhe ruajtjes. Në disa nga SA, kombinimi i arkeologjisë dhe natyrës, ende i paprekur nga zhvillimi modern, u jep atyre një identitet të veçantë dhe autenticitet, çka është identifikuar si vlera kryesore e qenësishme. Nëse institucionet shtetërore me politikat e tyre nuk janë në gjendje të njohin dinamikat e zhvillimit dhe sfidat themelore, menaxhimi i parqeve dhe siteve arkeologjike është i pamundur. Kjo gjë tregon rëndësinë e menaxhimit të përdorimit nga vizitorët dhe vendim-marrjen e integruar, në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara dhe të parapercaktuara në objektivat strategjikë të MK, IKTK dhe institucioneve të tjera të varësisë. Për këtë nevojitet angazhimi i të gjithë grupeve të interesit që janë ngarkuar me përgjegjësinë për të punuar bashkërisht drejt arritjes së qëllimit të përbashkët. Këto grupe duhet të janë proaktive në përcaktimin e interesave të përbashkëta dhe hartimin e strategjive afatgjata me plane veprimi konkrete. Strategji të tillë do të kenë një impakt kulturor, social dhe ekonomik në të gjithë vendin, veçanërisht në komunitetin përreth, që nga ndërgjegjësimi i tyre nëpërmjet trajnimeve, edukimit, punësimit, përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe logistike, zhvillimit të ekosistemeve përreth zonës dhe ngritjen e cilësisë së jetës dhe përfshireve të komuniteteve lokale dhe vendeve pritëse. Këto strategji do të rrisin dhe performancën e institucioneve përgjegjëse.

Gjykuar në sa më sipër, për shkak të vlerave që mbart menaxhimi i siteve arkeologjike, problemi social në fokus është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i tyre, si domosdoshmëri për zhvillimin e kulturës, ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies kombëtare. Duke marrë parasysh shqetësimin e opinionit publik të shprehur së fundmi në media dhe forume të ndryshme, lidhur me dëmet që po i shkaktohen kësaj pasurie kulturore, e konsideruam të rëndësishëm kryerjen e auditimit, duke u fokusuar më konkretisht. Mos realizimi në mënyrë efektive i funksioneve parësore të subjekteve nën auditim, përbën një dëm të konsiderueshëm në aspektin kulturor, social, por edhe ekonomik në vend.

1.2. Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2023, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (INTOSAI dhe EUROSAI), dhe në zbatim të funksionit të tij kushtetues, kryen me përparrësi auditimin e performancës. Sipas përkufizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) auditimi i performancës është një "shqyrtim i pavarrur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomicitetin dhe me synim përmirësimin". Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga Ekzekutivi dhe mund të kryhet në të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditimet standarde financiare apo të ligjshmërisë pasi karakterizohet nga fleksibiliteti në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve. Auditimi i performancës është një metodë moderne nëpërmjet të cilës taksapaguesit, financierët, vendim-marrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi ushtrojnë kontroll mbi mënyrën e kryerjes së punës dhe arritjen e objektivave nga ana e enteve shtetërore. Ky lloj auditimi ka si synim të arrijë korrektimet e duhura, përmirësimin e 3E-ve dhe rritjen e mirëqenies sociale përmes aktiviteteve publike.⁵ Auditimi i Performancës nuk është më një praktikë e re në eksperiencën institucionale. I konceptuar në strategjinë e kaluar si një nga dy shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, sfidë madhore në rritjen e rolit auditues suprem në Shqipëri dhe e ardhmja e

⁵Economicitet, Eficiencë, Efektivitet, ndërkohë që nga zhvillimet e fundit promovohet aplikimi i 6E-ve, së bashku me Energy, Environment, Ethics (Energji, Mjedis, Etikë).

natyrshme institucionale, në linjë kjo me eksperientat botërore, performanca është rritur shëndetshëm gjatë 8-vjeçarit të kaluar, duke e bazuar punën e saj në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin e ri 154/2014⁶. Në strategjinë e KLSH-së, puna audituese në departamentin e performancës, krahas çështjeve mikro-ekonomike është fokusuar edhe në ato makro-ekonomike. Auditimi i Performancës në KLSH synon të rritet duke u bërë promotor i zhvillimit institucional dhe duke u konsoliduar në një auditim analistik, këshillues, bashkëpunues e vlerështues.

1.3. Auditime të mëparshme në këtë fushë

Menaxhimi i siveve arkeologjike është një proces që ndërlidh veprimtarinë e disa institucioneve qëndrore dhe vendore. Vlerat e tyre janë me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Është detyrim institucional dhe ligjor domosdoshmëria e auditimit, duke vënë në dukje akoma më shumë domosdoshmërinë e eficiencës dhe efektivitetit që ky proces ka në vetvete, për një performancë më të mirë. KLSH ka kryer më parë dy auditime në ministrinë përgjegjëse për kulturën dhe në disa institucione në varësi të saj, një auditim performance dhe një auditim përputhshmërie. Në auditimin e performancës në MK me fokus “Mbi menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore”, i cili u krye në vitin 2015, për periudhën 2012-2014, mesazhi kryesor i këtij auditimi, përcjellë me Vendimin nr. 87, datë 30.06.2015 të Kryetarit të KLSH-së është: “Për periudhën e audituar, pak është bërë nga entet përgjegjëse shtetërore në miratimin e politikave dhe monitorimin e vazhdueshëm të proceseve për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike dhe asaj Monumentale, pasuri e brezave, si detyrimi ynë madhor kundrejt së shkuarës dhe së ardhmes”. Në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Institutin e Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, mesazhi kryesor i këtij auditimi, përcjellë me Vendimin nr. 189, dt. 31.12.2016 të Kryetarit të KLSH-së është: “Nga auditimi i ligjshmërisë, mbështetur në standartet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Instituti i Monumenteve të Kulturës, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregulator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarrur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënen e një opinioni të kualifikuar.”

1.4 Subjektet nën auditim

Subjekt i këtij auditimi janë institucionet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e siveve arkeologjike, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin me sukses të procesit.

Subjektet nën auditim janë:

1. Ministria e Kulturës;
 2. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
 3. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë;
 4. Njësität e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike (Butrint, Orikum, Amantia, Apoloni & Bylis)
1. **Ministria e Kulturës**, është ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësítë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Struktura organizative e MK përban tre drejtori të përgjithshme:
 - Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, që ka në varësi “Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor”, “Drejtorinë e

⁶ Ligji Nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".


Zhvillimit të Programeve të Kulturës”, “Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve”;

- Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë për Kulturën.

Nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, dhe institucioneve në varësi, MK është administratori shtetëror më i rëndësishëm i Trashëgimisë Kulturore. Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore materiale, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e administrimin e saj.

2. **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore**, krijuar me VKM nr. 364/2019⁷, struktura e të cilët është miratuar me Urdhrin nr. 137/2019⁸ të Kryeministrat të Shqipërisë ka në varësi dy drejtori: “Drejtorinë e Monumenteve të Kulturës” dhe “Drejtorinë e Shërbimeve Arkeologjike”.
3. **Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), Vlorë**, bazuar në VKM nr. 581, datë 28.08.2019⁹ ushtron veprimtarinë në dy qarqet Vlorë dhe Fier dhe është struktura përgjegjëse për **NJAKPA Orikum dhe Amantia**, (ish-ZAKPA Orikum dhe Amantia). Kjo drejtori ka në varësi dhe sektorin e Fierit. Struktura e kësaj drejtorie është miratuar me Urdhrin nr. 139/2019¹⁰ të Kryeministrat të Shqipërisë.
4. **Njësia e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Kombëtar Butrint**, (ish-ZAKPA Kombëtar Butrint), struktura e së cilës është miratuar me urdhrin nr. 186, dt. 04.07.2014¹¹.
5. **Njësia e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis**, (ish-ZAKPA Apoloni dhe ish-ZAKPA Bylis), struktura e së cilës është miratuar me Urdhrin nr. 132, dt. 21.10.2019¹² të Kryeministrat të Shqipërisë.

Skema 1: Institucionet në auditim 2016-2019



⁷ VKM nr. 364, datë 29.5.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimitarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

⁸ Urdhri nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, i Kryeministrat të Shqipërisë.

⁹ VKM nr. 581, datë 28.08.2019⁹ “Për funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të veprimitarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”.

¹⁰ Urdhri nr. 139, dt. 21.10.2019 “ Për miratimin e strukturës dhe organikës së DRTK” i Kryeministrat të Shqipërisë.

¹¹ Urdhri nr. 186, dt. 04.07.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZARPA Butrint” i Kryeministrat të Shqipërisë.

¹² Urdhri nr. 132, dt. 21.10.2019 i Kryeministrat të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZAKPA Apoloni & Bylis”.

1.4.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Menaxhimi i siteve arkeologjike në Shqipëri është rezultat i procesit të lidhur me zhvillimin e shoqërisë, vlerat dhe kërkesat e saj. Këto kanë bërë që njerëzit të kuptojnë se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me kontekstin në të cilin jetojnë dhe punojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor dhe shërben edhe si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës.

Trashëgimia Kulturore në Republikën e Shqipërisë, si një element i rëndësishëm në edukimin me qytetari demokratike dhe zhvillimin social, kulturor, ekonomik të vendit, mbrohet nga Shteti, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë¹³ dhe Ligjin nr. 27/2018¹⁴. Duke njohur rëndësinë ekonomike dhe kulturore të sistemit të parqeve arkeologjike në Shqipëri, në vitin 2000, Qeveria Shqiptare me VKM nr. 82/2000¹⁵ shpalli Zonën Arkeologjike të Butrintit si Park Arkeologjik Kombëtar në mbrojtje të shtetit. Sistemi i parqeve arkeologjike u miratua me aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 9048/2003¹⁶, të ndryshuar, ku përvëç Butrintit, me VKM nr. 396/2005¹⁷ u njohën edhe 8 parqet e tjera arkeologjike si: Lezhë, Shkodër, Apoloni, Bylis, Amantia, Orikum, Antigonea dhe Finiqi. Me këtë ligj u vendosën disa rregulla që kishin të bënin me mbrojtjen e territorit nga ndërtimet pa leje dhe ruajtjen. Sistemi i parqeve arkeologjike në Shqipëri menaxhohet nga ministria përkatëse e linjës për TK, njësitë përbërëse të saj dhe institucionet e varësisë, bazuar në Ligjin 27/2018 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ministria e Kulturës, është ministria e linjës përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e vlerave të luajtshme dhe të paluajtshme të TK. Në përputhje me programin e Qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore ajo harton strategjinë kombëtare të kulturës, harton planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore, ndjek zbatimin e kontratave të rrijetëzimit, ushtron veprimtarinë e saj bazuar në legjislacionin përkatës për trashëgiminë kulturore, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore materiale si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e saj.

Bazuar në Ligjin nr. 9048/2003¹⁸, me VKM nr. 396/2005¹⁹, të ndryshuar, u krijuar Bordi Kombëtar i Parqeve Arkeologjike, si organ vendimmarrës, i cili mbikëqyrte veprimtarinë e ZAKPA-ve dhe strukturave përkatëse pranë DRKK-ve, miratonte strategjitet dhe programet e zhvillimit për parqet arkeologjike kombëtare, miratonte planet vjetore të parqeve arkeologjike, etj. Nga kjo VKM u përjashtua Butrinti, pasi rregullorja e administrimit të tij ishte miratuar në dhjetor 2003²⁰.

Bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003, me VKM nr. 725, datë 21.5.2008²¹ u ngrit KKA-ja si organ kolegjal vendimmarrës për miratimin në parim, të kritereve të kërkimit,

¹³ Neni 59, Kreu V, Kushtetuta e Shqipërisë .

¹⁴ Ligji nr. 27/2018¹⁴ “Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

¹⁵ VKM nr. 82, datë 2 Mars 2000 “Mbi klasifikimin e Parkut Kombëtar Butrint si park Arkeologjik i Mbrojtur nga Shteti”

¹⁶ Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” dhe ndryshimet që i janë bërë këtij ligji përkatësisht me Ligjin nr.9592, datë 27.07.2006, Ligjin nr.9882, datë 28.02.2008, Ligjin nr.77/2013 dhe Ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në legjislacionin për licencat.

¹⁷ VKM nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të shkodrës, lezhës, apolonisë, bylisit, amantias, orikumit, antigonesë, finiqit dhe butrintit” i përditësuar me: VKM nr. 163, datë 27.02.2013, VKM nr. 249, datë 30.04.2014

¹⁸ Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar

¹⁹VKM nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit” i përditësuar me: VKM nr.163, datë 27.02.2013, VKM nr. 249, datë 30.04.2014

²⁰VKM nr. 857, datë 19 dhjetor 2003, “Mbi Miratimin e Rregullores së Funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit”.

²¹ VKM nr. 725, datë 21.5.2008 “ Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë”.

dokumentimit dhe arkivimit të të dhënavë e të materialeve arkeologjike, strategjisë së integrimit të kërkimit arkeologjik, lejeve të subjekteve private dhe të individëve, si edhe të gjitha projekteve të ndërhyrjes në zonat arkeologjike

Me përcaktimin e strukturave përgjegjëse për parqet arkeologjike sipas VKM-së nr. 249/2014²², u rishikuan detyrat e BKPA. Për të rritur transparencën dhe menaxhimin e parqeve në mbledhjet e BKPA do të merrnin pjesë dhe drejtoret e drejtive rjonale të kulturës kombëtare të Gjirokastrës, Shkodrës, Vlorës dhe drejtori i ZAKPA-së Apoloni-Bylis, por pa të drejtë vote.

Me miratimin e Ligjit 27/2018 organe kolegiale vendimmarrëse pranë ministrit të kulturës janë: KTKM dhe KKMPK.

- KTKM-ja miratuar me VKM nr. 208, datë 10.04.2019²³, licencon subjektet, personat fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, të aktivitetave arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit, miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim, miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, miraton në parim shpalljen e parqeve dhe zonave arkeologjike, etj.
- KKMPK-ja miratuar me Urdhrin nr. 535, datë 24.09.2019²⁴, miraton strategjinë për administrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore, miraton programin e zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore, konsulton ministrin për trashëgiminë kulturore për tipologjinë e aktivitetave tregtare që zhvillohen në ambientet e pasurive kulturore dhe në zonat e mbrojtura, miraton kriteret për licencimin e subjekteve tregtare të dedikuara në fushën e promovimit e të prezantimit të vlerave kulturore, etj.

ITKK-ja krijuar me VKM nr. 364/2019²⁵, struktura dhe organika e të cilit është miratuar me Urdhrin nr. 137, datë 21.10.2019²⁶ të Kryeministrit të Shqipërisë, ka në varësi dy drejtori: "Drejtorinë e Monumenteve të Kulturës" dhe "Drejtorinë e Shërbimeve Arkeologjike".

ITKK-ja është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Kulturës, financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Misioni i tij është gjurmimi, hulumtimi, studimi, projektimi, konservimi, restaurimi, mbikëqyrja, kolaudimi, promovimi, publikimi i trashëgimisë kulturore materiale, arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimi i trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë. ITKK-ja har ton kriteret e hulumtimeve arkeologjike, shqyrton dokumentacionin teknik në lidhje me to, si dhe kryen mbikëqyrjen e proceseve arkeologjike dhe ecurisë së projekteve zhvillimore, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegiale.

ITKK-ja, har ton, përditëson dhe publikon platformën digitale për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë si edhe bashkërendon punën me DRTK, NJAKPA, NJVQV, subjektet publike dhe private, vendase apo të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore

²² VKM nr. 249/2014²² "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit", të ndryshuar.

²³ VKM nr. 208, datë 10.04.2019²³ për "Përbëren, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit Kombëtar të trashëgimisë Kulturore Materiale".

²⁴ Urdhri nr. 535, datë 24.09.2019²⁴ "Për caktimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore".

²⁵ VKM nr. 364, datë 29.5.2019 "Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore".


²⁶ Urdhri nr. 137, datë 21.10.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore".

materiale.

Me Urdhrin nr. 456, datë 15.10.2003 të Ministrit të Kulturës u ngrit KKR-ja i cili miratonte, kriteret për licencimin e subjekteve të personave fizikë e juridikë në fushën e projektimit apo restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, bënte studime vlerësuese për të gjitha kategoritë e monumenteve të trashëgimisë materiale, si dhe miratonte projekte restaurimi të cilat ishin shqyrtuar më parë në Këshillin Shkencor të IMK-së, si organ këshillimor, jofunksionar dhe ndihmone drejtorin në studimet shkencore për konservimin dhe restaurimin e monumenteve.

Me Vendim të KM nr.426/ 2007²⁷ u miratua Karta Shqiptare e Restaurimeve në të cilën përcaktoheshin rregullat dhe kriteret e punimeve të restaurimit në objektet e trashëgimisë kulturore.

Skema 2: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore



DRTK Vlorë, (ish-DRKK Vlorë), miratuar me Urdhrin nr. 139/2019²⁸ të Kryeministrit të Shqipërisë, është institucion rajonal i specializuar, tekniko-administrativ buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për TK. Me VKM Nr.163/2013²⁹ dhe më pas VKM nr. 249/2014³⁰, struktura përgjegjëse për administrimin e parqeve arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq, ishte DRKK Vlorë, sot DRTK Vlorë. DRTK-ja e Vlorës ka për mision, gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që administron, financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe monitorohet dhe koordinohet nga ITK-ja, si njësia përgjegjëse për mbavetje e DRTK-ve.

Skema 3: Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë



NJAKPA, Butrint, Orikum, Amantia, Apoloni & Bylis (ish-ZAKPA-të), janë institucione tekniko-administrative në varësi të MK dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të tyre gjeografik, administrojnë, koordinojnë dhe hartojnë plane zhvillimi, projekte, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve/siteve arkeologjike, të përcaktuara nga plani i menaxhimit. Planet e zhvillimit, projektet restauruese dhe konservuese, projektet kërkimore-shkencore, të NJAKPA-ve, koordinohen nga ITK-ja dhe

²⁷ VKM Nr.426, datë 13.7.2007²⁷ “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”.

²⁸ Urdhri nr. 139/2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së DRTK”.

²⁹ VKM nr. 163, datë 27.02.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave.


³⁰ VKM nr. 249, datë 30.4.2014 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.

shqyrtohen e miratohen nga KTKM-ja, në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve.

Bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 dhe në zbatim të VKM-së nr. 249/2014³¹ parqet arkeologjike Apoloni dhe Bylis funksionin si struktura më vete, me autonomi administrative, juridike dhe buxhetore. ZAKPA Apoloni ishte strukturë përgjegjëse e parkut dhe organika ishte miratuar me Urdhrin nr. 184/2014³². Gjithashtu dhe ZAKPA Bylis, ishte strukturë përgjegjëse e parkut dhe organika e saj ishte miratuar me Urdhrin nr. 185/2014³³.

Parku Kombëtar i Butrintit funksionon si strukturë më vete, me autonomi administrative, juridike dhe buxhetore. Drejtohet nga Bordi për Administrimin dhe Koordinimin e Butrintit dhe NJAKPA (ish-ZAKPAK Butrint), e cila është struktura përgjegjëse e tij, në varësi të MK, si autoriteti përgjegjës për administrimin e tij. Bordi është organ vendimmarrës dhe mbikëqyr veprimtarinë e NJAKPAK Butrint.

Skema 4: Varësia institucionale e subjekteve nën auditim, përjashtuar Butrintin (bord më vete)



Me miratimin e Ligjit 27/2018 dhe akteve nënligjore në varësi të tij, ndryshoi struktura përgjegjëse për parqet Apoloni dhe Bylis. Me Urdhrin nr. 132/2019³⁴ të Kryeministrit u miratua struktura dhe organika e NJAKPA Apolloni dhe Bylis. Pra, këto parqe nuk funksionojnë më si strukturë më vete. Struktura përgjegjëse e tyre është NJAKPA Apoloni & Bylis.

Pra siç duket, varësia e parqeve arkeologjike dhe menaxhimi i tyre nuk është e njëjtë. Në Butrint, Apoloni dhe Bylis funksionojnë NJAKPA, ndërsa NJAKPA Orlikum dhe Amantia janë në varësi të DRTK Vlorë. Kjo mënyrë e ndryshme menaxhimi ka ndikuar dhe do të ndikojë në performancën e tyre.

1.4.2. Politikat e institucioneve

Ministria e Kulturës harton dhe zbaton politika që synojnë realizimin e programit politik të qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore, për, ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore kombëtare, përfaqësimin material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitja e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandaluar trajtimin e paligjshëm të objekteve kulturore në përputhje me legjisacionin në fuqi.

³¹ VKM nr. 249, datë 30.4.2014 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orlikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit", të ndryshuar.

³² Urdhri nr. 184, dt. 23.06.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZARPA Apoloni".

³³ Urdhri nr. 185, dt. 23.06.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZARPA Bylis."

³⁴ Urdhri nr. 132/2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së ZAKPA Apoloni&Bylis" i Kryeministrit të Shqipërisë.

Periudha 2016-2018 përfaqëson një vakum strategjik të kësaj fushe, gjatë së cilës nuk ka dokument të miratuar, me objektiva dhe plane veprimi konkrete për menaxhimin e siteve arkeologjike. Menaxhimi i tyre është bazuar në miratimin e disa akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe të programeve për trashëgiminë kulturore. Në faqen e Websitet të MK, për një pjesë të periudhës objekt auditimi, ka programin e trashëgimisë kulturore 2013-2017 me detyra për institucionet e varësisë. Ministria e Kulturës ka hartuar dhe miratuar Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, vizioni i së cilës është “Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit. Nëpërmjet kësaj strategjie synohet ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, nxitja dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë, etj.

IKTK-ja, DRTK dhe NJAKPA, si institucionë përgjegjëse dhe të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, në bashkëpunim me institucionet e vetëqeverisjes vendore, me zbatimin e politikave qendrore duhet të krijojnë mundësinë e nxitjes dhe aktivizimit të të mirave materiale dhe shërbimeve ndaj qytetarëve, veçanërisht të komuniteteve përreth siteve arkeologjike, të cilët e kanë kuptuar se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me to.

Mbështetur në direktivat e BE, MK dhe institucionet e varësisë me politikat e tyre synojnë, ruajtjen e identitetit kombëtar. Këto institucionë me politikat e tyre duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për rivendosjen e ekuilibrave ndërmjet nevojave për zhvillim të popullsisë dhe mbrojtjes së TK. Në këto kushte TK do të të shërbejë si një motor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit.

1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB

Sektori i turizmit, pjesë e rëndësishme e të cilit janë sitet arkeologjike është mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë. Investimet e kryera në këtë fushë janë mjaft të rëndësishme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, përbashkët me detyrimet ndaj brezave të kaluar të tashëm dhe në të ardhmen, mbrojtur mjedisin, si dhe përritjen ekonomike të vendit.


Tabela 1 Pesha që zënë sitet arkeologjike në buxhetin e MKRS

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019	000/lekë
Buxheti total MKRS	1,699,187	1,900,895	2,257,486	2,128,700	
Buxheti për sitet arkeologjike	180,459	189,240	198,077	217,550	
<i>SA/Buxhetit MKRS</i>	10.6 %	10 %	8.7 %	10.2%	

Burimi: MKRS; Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e analizuara nga grupi i auditimit, rezulton se buxheti i alokuar ndër vite nga ministria përgjegjëse për të mbështetur sektorin e arkeologjisë, nuk shfaq një trend të qëndrueshëm.

Të dhënat e mësipërme në mënyrë grafike paraqiten si më poshtë:



Burimi: MKRS; Përpunoi: Grupi i auditimit

Megjithëse buxheti i alokuar për sitet arkeologjike është rritur nga viti në vit, pesha e tij (relative) ndaj buxhetit total të ministrisë ka pësuar luhatje.

Tabela 2: Pesha që zë Buxheti për sitet arkeologjike në buxhetin qendror të shtetit
000/lekë

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019
Buxheti i Shtetit	264,141,978	283,299,687	306,174,422	308,078,194
Buxheti për sitet arkeol.	180,459	189,240	198,077	217,550
SA/Buxhetit të Shtetit	0.7 %	0.67 %	0.64 %	0.7 %

Burimi: MKRS; Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet e planifikuara për sitet arkeologjike në vendin tonë për periudhën 2016 - 2019, zinin rreth 0.6 deri 0.7 % të buxhetit të shtetit, një nivel shumë ulët ky për një sektor që duhet të promovohet në fushën e turizmit, ndërsa krahasuar me PBB nivelit që zë financimit të siteve arkeologjike për këtë periudhë në vendin tonë, është i papërfillshëm.

Grupi i auditimit shqyrtoi dhe të ardhurat e realizuara nga sitet arkeologjike për periudhën objekt auditimi, nga ku rezulton se këto të ardhura kanë patur rritje të konsiderueshme nga viti në vit: kështu për vitin 2017 janë realizuar 13 % më shumë se në v. 2016; në v. 2018/17, 33 % më shumë, dhe në v. 2019/18 janë realizuar 14 %.

Tabela 3: Të ardhurat e realizuara nga sitet arkeologjike (vizitore, të dhëna me qira etj.)
000/lekë

Të ardhura Emërtimi	2016	2017	2018	2019
Planifikuar	8 700	8 600	9 434	30 800
Realizuar gjithsej	101 613	113 817	151 469	172 830

Burimi: MK; Përpunoi: Grupi i auditimit

Siq del nga të dhënat e mësipërme të ardhurat nga sitet çdo vit janë realizuar disafish më shumë se sa planifikimi, i cili rezulton të jetë shumë i pabazuar, duke mos marrë parasysh as realizimet e viteve të mëparshme.

Duhet theksuar se pjesa kryesore e të ardhurave nga sitet është realizuar ne Parkun Arkeologjik të Butrintit, ku çdo vit realizohen mesatarisht 57 % e të ardhurave gjithsej të realizuara nga sitet arkeologjike në shkallë vendi.

1.4.4. Risqet e aktivitetit të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato me të cilat përballen Ministria e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj në realizimin e përgjegjësive të veta, të cilat rrjedhin nga

aktiviteti në tërësi, fokusuar në politikat, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucionale për sitet arkeologjike.

Nëpërmjet evidentimit të pikave të fortë, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimitarisë së institucioneve subjekt auditimi, për të adresuar dhe ndarë faktorët / e riskut sipas përkatësisë së tyre, “brenda kontrollit menaxherial” dhe “jashtë kontrollit menaxherial”.

Këto risqe janë analizuar, evidentuar dhe klasifikuar sipas analizës SËOT, në faktorë të brendshëm (pikat e fortë dhe të dobëta) dhe faktorë të jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet).

Në vijim është bërë edhe kategorizimi i risqeve në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, për të adresuar përgjegjësitet vendim-marrëse, të “inputit”, “procesit” apo “outputit”, etj.

Analiza SWOT

PIKA TË FORTA	PIKA TË DOBËTA
<ul style="list-style-type: none"> • Kuadri ligjor. • Pasuri me vlera kombëtare dhe ndërkontëtare, risi për turizmin dhe kulturën kombëtare. • Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, si edhe pozicioni i vendosjes së SA, pamja dhe gërvhetimi i këtyre parqeve me parqet natyrore, malin dhe detin. • Interesi në rritje për trashëgiminë kulturore dhe sitet arkeologjike. • Financim nga buxheti qendror. • Ekzistencë e nismave private dhe bizneseve lokale, që përfshijnë akomodimin, restorante, bare, ture dhe guidat e SA. • Ekzistencë e strukturave drejtuese dhe menaxhuese në nivel qendror dhe vendor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e strategjisë së TK, planeve konkrete të veprimit (2016-2018), kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit për TKM. • Mbivendosja e kompetencave dhe komunikimi ndërinstitucional i dobët, midis institucioneve publike. • Mungesa e planeve të menaxhimit. • Financimi nga qeveria i pamjaftueshëm dhe i pabazuar në analiza për nevojat dhe shërbimet, ku të detajohen dhe kostimet për to. • Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe logistike. • Mungojnë rregulloret fokusuar në kompetencat për punimet arkeologjike brenda siteve. • Mungesë transparence dhe komunikimi me donatorët dhe komunitetin, për të rritur ndjeshmërinë sociale të tyre për SA. • Reforma të shpeshta strukturore.
MUNDËSITË	KËRCËNIME
<ul style="list-style-type: none"> • Praktikat më të mira rajonale. • Njohja nga qeveria e rëndësishëm së turizmit ndërkombëtar, si pjesë e axhendës më të gjërë socio-demografike. • Prania e institucioneve donatore që operojnë në shkallë kombëtare dhe rajonale në turizëm, kulturë. • Përfshirja e grupeve të interesit në hartimin e politikave. • Statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. • Iniciativa të reja të propozuara nga 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e Inspektoriatit Kombëtar për Mbrojtjen e TK. • Centralizimi dhe burokracitë e qeverisjes qendrore në sektorët e ekonomisë. • Mungesa e rregulloreve të brendshme lidhur me menaxhimin e marrëdhënieve brenda parkut, sipas specifikës së zonës. • Politika konkuruese dhe kërcënuuese në

<p>sektori privat duke përfshirë dhe qeverinë për zhvillime strategjike me qëndrueshmëri financiare afatgjatë dhe efektive.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i konceptit të SA, jo vetëm në aspektet mbrojtëse, por si faktor zhvillimi ekonomik dhe social. • Strategji, fushata dhe projekte për vullnetarë dhe donatorë, të inicuara nga drejtorët e parqeve për zhvillimin e SA. • Autonomia ekonomike është baza e zhvillimit të SA. 	<p>rajon, konkurrenca e rrezikshme me Greqinë dhe Italinë, si edhe rënia e nivelit të turizmit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekonomia e vendit dhe ajo rajonale. • Fatkeqësitë natyrore dhe pandemitë botërore. • Konflikti mes rregulloreve për parqet arkeologjike dhe kuadrit rregulator urban, i cili është kompetencë e NJVQV.
--	--

Kategorizimi i risqeve në strategjik, finanziar, juridik dhe operacional është si më poshtë vijon:

Nr.	Risqet e subjekteve	Kategorizimi i Riskut	Nivel i riskut
1	Mungesa e strategjisë për TK dhe akteve nënligjore.	Strategjik dhe Juridik	I lartë
	Mungesa e planeve të menaxhimit të SA.		I lartë
2	Reformat strukturore dhe burimet njerëzore.		I mesëm
3	Mungesa e strukturave inspektuese IKTK-së.	Strategjik dhe Operacional	I lartë
4	Fondet e kufizuara të financimit dhe mungesë analize kostosh.	Strategjik dhe Financiar	I lartë
5	Mbivendosja e kompetencave midis institucioneve publike që merren SA dhe koordinimi i dobët ndërinstitucional.	Strategjik dhe Financiar	I lartë
6	Mungesa koordinimi, transparence dhe bashkëpunimi pushtet qendror dhe vendor.	Operacional	I mesëm
7	Mungesa e sistemeve elektronike të menaxhimit të SA	Operacional	I mesëm
8	Politika konkurruese dhe kërcënuese në rajon, si edhe rënia e nivelit të turizmit.	Financiar dhe Operacional	I lartë
9	Ekonomia e vendit, fatkeqësitë natyrore dhe pandemitë.	Strategjik	I mesëm

1.4.5. Rëndësia e produkteve të subjektit

Ministria e Kulturës është institucioni përgjegjës, për realizimin e programit politik të qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore, menaxhimin e siveve arkeologjike dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Menaxhimi i parqeve dhe siveve arkeologjike është i lidhur me zhvillimin e ekonomik, social kulturor të shoqërisë, vlerat dhe kërkesat e saj për integrimin drejt BE. Ruajtja dhe rjetëzimi i tyre përbën thelbin e identitetit kulturor dhe shërben si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës.

Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, misionin e saj MK e realizon në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore publike që merren me menaxhimin e siveve arkeologjike. IKT, i cili është institucion kombëtar i specializuar shkencor, ka vlera si në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, ashtu edhe në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, në shërbim të planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

Trashëgimia Kulturore është dëshmi e qytetërimeve të së kaluarës. Në këto kushte vetëm nëse mbrohet nga shteti dhe institucionet e tjera publike dhe private, trashëgimia kulturore do të rruhet në shekuj dhe do të vihet në shërbim të zhvillimit të shoqërisë dhe edukimit të brezit të ri me ndjenja kombëtare.

1.4.6. Feedback-u i subjektit gjatë auditimit

Gjatë auditimit, bashkëpunimi i subjekteve nën auditim ka qenë i kënaqshëm. Grupi ka komunikuar me strukturat përgjegjëse në MK, IKT, DRTK dhe NJAKPA. Personat përgjegjës dhe të autorizuar në Ministrinë e Kulturës i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për t'u pajisur me zyrë pune dhe gjithë pajisjet logistike të nevojshme për auditim. Përsa i përket bashkëpunimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e auditimit, vlen të theksojmë se, IKT është përgjigjur brenda afateve kohore të përcaktuara, ndërsa informacioni i dërguar nga MK ka qenë i vonuar në kohë, me justifikimin e mungesës së punonjësve për shkak të pandemisë.

2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT

2.1. Objektivi dhe problemi i performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur i *efiqencës* dhe *efektivitetit* të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike, duke iu përbajtur *ekonomicitetit* dhe me synim identifikimin e përmirësimeve. Grupi i auditimit do të auditojë performancën në ruajtjen dhe administrimin e siveve arkeologjike për periudhën në fokus auditimi. Në këtë kontekst, *efektiviteti* do të jetë objektivi rreth të cilit do të zhvillohet auditimi i performancës, për temën e zgjedhur.

2.1.1. Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës

Parqet arkeologjike janë vende ose peizazhe natyrore ku ka objekte të luajtshme ose të paluajtshme, të gërmuara ose jo të cilat ndodhen në sipërfaqe, nën tokë ose nën ujë, që studiohen duke përdorur metoda arkeologjike. Ato përbajnjë vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik. Në ditët e sotme siti apo parku arkeologjik është një vend, vlerat të cilit bazohen jo vetëm në gjurmët monumentale, por edhe në kontekstin natyror dhe mjedisor.

Sistemi i parqeve arkeologjike në Shqipëri është miratuar me Ligjin nr. 9048, datë 7 prill 2003 “Mbi Trashëgiminë Kulturore”. Konkretnisht me nenin 53, ku përvçeç Butrintit, u njoftë

edhe 8 parqet e tjera arkeologjike si: Lezha, Shkodra, Apollonia, Byllis, Amantia, Orikumi, Antigonea, dhe Finiqi. Me këtë ligj u evidentuan vlerat e trashëgimisë kulturore dhe u vendosën disa rregulla që kanë të bëjnë me mbrojtjen e territorit të parqeve dhe detyrat e përgjegjësitë e organeve që veprojnë në këtë fushë.

Koncepti i parkut arkeologjik po ndryshon drejt një perspektive të re që nuk bazohet vetëm në aspektet mbrojtëse, por edhe në zhvillimin ekonomik si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë.

Pavarësisht se së fundmi në qendër të investimeve me qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion turistik është vendosur trashëgimia kulturore përfshirë parqet dhe sitet arkeologjike, si burim i pashfrytëzuar për zhvillim të qëndrueshëm sociale ekonomik, janë identifikuar probleme dhe sfida që kanë të bëjnë pikërisht me mirë-menaxhimin e këtyre të fundit dhe problemet që kushtëzojnë zhvillimin e fryshtës së zhvillimit e korekt të tyre drejt standardeve të mira kulturore, ekonomike dhe turistike.

2.1.2. Objektivi i auditimit

Shqipëria edhe pse një vend relativisht i vogël gjëzon privilegjin e pasjes së 9 parqeve arkeologjike të miratuar, të cilat me menaxhimin e duhur kanë potencialin e madh që të kthehen në motor të rëndësishëm zhvillimi ekonomik të vendeve ku ato ndodhen.

Me qëllim që menaxhimi i tyre të rezultojë efektiv në arritjen e këtyre objektivave, kontrolli në vazhdimësi i zbatueshmërisë së akteve ligjore, përmirësimi i tyre, hartimi dhe zbatimi i masave të duhura përruajtjen, mbrojtjen, nxitjen dhe mbështetjen e vlerave kulturore duhet të përbëjnë hallkat kryesore të këtij procesi.

Për sa më lart, objektivi kryesor i këtij auditimi është efektiviteti i implementimit të politikave shtetërore përmirësimi i parqeve arkeologjike dhe zhvillimin e tyre në aspektin ekonomik kulturor e turistik, si dhe veprimtaria e institucioneve përgjegjëse përmirësimi i mekanizmat e menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të tyre, përiudhën 2016 –2019.

2.2 Përkufizimet dhe terminologja

Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- “*Auditimi i performances*” përfshin një vlerësim të ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës së veprimitarës dhe përdorimin e fondeve nga njësia e sektorit publik në përbushjen e objektivave.
- “*Bazë të dhënash shtetërore e pasurive kulturore*” është grumbullimi i organizuar i informacionit përrtakor i gjitha pasuritë kulturore kombëtare, në pronësi publike e private, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administruar.
- “*Certifikatë e pasurive kulturore*” është dokumenti zyrtar, i lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, që përcakton statusin juridik të pasurive kulturore, në pronësi publike dhe private, sipas dispozitave të këtij ligji dhe përmban të dhënavë identifikuuese të pasurive kulturore në Republikën e Shqipërisë, referuar kritereve dhe standardeve ndërkombëtare, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Pasurive.
- “*Dëmtimi*” është tërësia e veprimeve, të qëllimta ose jo, në pasuritë kulturore, që cenojnë të dhënavët ose elemente të veçanta të këtyre pasurive.
- “*Gërmim arkeologjik*” është ndërhyrja e plotë në nëntokën arkeologjike. Ai kryhet sipas mënyrës frontale të avancimit, zgjerimit të sipërfaqes së gërmimit të mëparshëm, ose nëpërmjet parcelimit (copëzimit) të sipërfaqes arkeologjike, të diktuar prej hapave paralelë të ndërtimit. Për të gjitha këto raste, secilës njësi arkeologjike që zbulohet do t'i bëhet prerja, hulumtimi dhe dokumentimi. Ajo do të kryhet nga arkeologu (drejtuesi i gërmimit), tekniku i gërmimit, konservuesi i mjediseve arkeologjike, personeli plotësues teknik (skicograf, fotograf).

- “*Hulumtim arkeologjik*” eshtë vlerësimi i potentialit arkeologjik, vëzhgimi sipërfaqësor (sipas nacionit klasik, si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si p.sh. studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjedoradar etj.), sondazhet arkeologjike, gërmimi arkeologjik, monitorimi, konservimi, administrimi arkeologjik, si dhe përpilimi i dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimtarie, raporteve paraprake dhe përfundimtare, deri në botimin e rezultateve.
- “*Inventarizim*” eshtë regjistrimi dhe identifikimi i objekteve të pasurive kulturore.
- “*Katalogim*” eshtë regjistrimi i të dhënave, sipas kritereve të caktuara shkencore, për identifikimin dhe administrimin e pasurive kulturore.
- “*Katalogu Kombëtar i Pasurive Kulturore*” eshtë baza e të dhënave shtetërore, që mbledh dhe administron, në nivel qendror, të dhënat mbi pasuritë kulturore kombëtare nëpërmjet Sistemit Informatik Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore.
- “*Konservimi paraprak*” janë të gjitha masat e ndërmarra, që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, siç janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagësti relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.
- “*Konservim i integruar*” eshtë metodologjia, që nënkupton pajtimin e kërkeseve të konservimit me objektivat e planifikimit dhe menaxhimit urban, të cilat duhet të kenë për qëllim krijimin e harmonisë, shmangjen e funksioneve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e nivelit ekzistues të vlerave funksionale dhe kulturore.
- “*Mbrojtja*” eshtë ndërmarrja e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit.
- “*Mirëmbajtja*” janë të gjitha masat praktike dhe teknike që duhen ndërmarrë, në mënyrë që pasuria kulturore të mbahet në ato lloj kushtesh e standardesh që japos kënaqësinë maksimale, pa dëmtuar vlerat kulturore. Ky eshtë një proces i vazhdueshëm, programi i të cilit monitorohet.
- “*Monitorimi arkeologjik*” eshtë një program vëzhgimi dhe hetimi i kryer gjatë zbatimit të një projekti zhvillimor, brenda një zone të caktuar apo siti, në tokë ose nën ujë, ku ekziston mundësia që depozitimet arkeologjike mund të prishen ose të shkatërrohen. Ky proces nënkupton praninë e specialistëve arkeologë gjatë zhvillimit të punimeve të projektit deri në përfundim të gërmimeve dhe rezulton me përgatitjen e një raporti dhe arkivimin e të dhënave.
- “*Mbikëqyrje arkeologjike*” eshtë procesi i këqyrjes në terren, nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe subjektet e licencuara, i proceseve arkeologjike dhe ecurisë së punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore, të miratuara nga organi vendimmarrës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- “*Pasuri arkeologjike*” janë monumente, vendbanime historike të llojeve të ndryshme, objekte ose pjesë veprash ndërtimore apo vendbanimesh, të dala prej gërmimeve arkeologjike, me vlera historiko-kulturore.
- “*Park arkeologjik*” eshtë territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.
- “*Restaurim*” eshtë vlerësimi i thelbit original të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor.
- “*Registri kombëtar i pasurive kulturore*” eshtë dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e çdo certifikat pasurie kulturore, të krijuara në letër dhe/ose në formë elektronike, në pronësi publike e private, materiale dhe jomateriale në Republikën e

Shqipërisë. Përcakton qëndrueshmérinë në terma cilësorë dhe sasiorë të pasurive kulturore kombëtare, si dhe përgjegjësinë e institucioneve që i posedojnë për regjistrim e përditësim.

- **“Ruajtja”** është proces i vazhdueshëm, sistematik, i koordinuar dhe i programuar hulumtimi, studimi, kërkimi, dokumentimi, regjistrimi, parandalimi, mirëmbajtjeje, konservimi, restaurimi, përshtatjeje dhe vlerësimi të trashëgimisë kulturore.
- **“Rijetëzimi”** është dhënia në përdorim e pasurisë kulturore për funksione administrative e social-kulturore, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.
- **“Site”** janë vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik.
- **“Trashëgimi kulturore”** është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupei ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruan në të tashmen, për t'u përçuar brezave në të ardhmen si pjesë pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njoftimit, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.
- **“Trashëgimi arkeologjike”** është pjesë e trashëgimisë kulturore, elemente të së cilës janë të gjitha gjurmët e ekzistencës së njerëzimit, ruajtja dhe studimi i të cilave lejojnë ndjekjen e zhvillimit të historisë së tij dhe marrëdhëniet e njerëzimit me mjedisin natyror.
- **“Veprimitari arkeologjike nënujore”** janë gërmimet, sondazhet, kërkimet, zhvendosjet dhe shfaqjet në zonën arkeologjike nënujore.
- **“Vlerësimi”** është ushtrimi i funksioneve dhe veprimtarive që kanë për qëllim promovimin e zhvillimin e trashëgimisë kulturore, si dhe krijimin e kushteve më të mira për përdorimin dhe gëzimin publik të saj. Në lidhje me peizazhin kulturor, vlerësimi përfshin, gjithashtu, rikualifikimin e objekteve të paluajtshme dhe të hapësirave të vendosura në mbrojtje, të dëmtuara ose degraduara.
- **“UNESCO”** është Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara.
- **“Zonë arkeologjike”** është vendi ose peizazhi natyror ku ka objekte të luajtshme ose të paluajtshme, të gërmuara ose jo, që janë gjendur ose gjenden në sipërfaqe, nën tokë ose nën ujërat territoriale shqiptare, që mund të studiohen duke përdorur metoda arkeologjike.

2.3 Kriteret

2.3.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025

2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Planifikimi i menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. –
- Udhëzime për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit me shembuj të siteve të UNESCO-snë rajonin e Adriatikut

2.3.3 Kriteret teknike

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligj Nr.9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar me ligjin 9592 datë 27.07.2006, ligjin 9882 datë 28.02.2008, ligjin 10137 datë 11.05.2009 dhe ligjin 77/2013.
- Ligji nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”
- Ligj Nr.9806, datë 17.9.2007 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” (të rishikuar)
- Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 30.4.2014 për “disa ndryshime në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së


administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit Dhe Butrintit", të ndryshuar

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 163, datë 27.2.2013 për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005 "Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit"
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 31.3.2005 për "Miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit Dhe Butrintit"
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 531. Date 31.10.2002 për "Shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit dhe të territorit përreth tij zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listen e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate te shpendëve ujorë".
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.857, datë 19.12.2003 Për "miratimin e rregullores se funksionimit të zyrës së administrimit dhe koordinimit të parkut kombëtar të Butrintit
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.6, datë 7.1.2005 Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë.
- Urdhër i Kryeminisrit Nr.22 date 25.01.2014 për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë së shërbimit Arkeologjik Tirane.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.724, datë 21.5.2008 Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së shërbimit arkeologjik në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.928, Datë 28.12.2011 Për përdorimin e të ardhurave të parkut kombëtar të Butrintit.

2.3.4 Kriteret e tjera

- Auditime të SAI-ve të vendeve më të zhvilluara në fushën e Trashëgimisë Kulturore

2.4 Piramida E Pyetjeve Të Auditimit



2.5 Skema e auditimit

Grupi i auditimit do të aplikojë qasjen pragmatike, pasi tërësia e të dhënave dhe materialeve, ka nevojë për vëzhgime dhe analizë cilësore e sasiore të lidhur me efektivitetin e politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016 – 2019.

2.5.1. Qasja/metodologja e auditimit

Gjatë këtij auditimi kemi gjykuar si më të përshtatshme qasjen e orientuar kah rezultati duke identifikuar, verifikuar dhe analizuar çështjet dhe problemet e veçanta, që lidhen me “Efektivitetin e politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016 – 2019”, si në nivel institucionesh qendrore që prodhojnë politika dhe monitorojnë administrimin e siteve arkeologjike, ashtu dhe në rrafshin e situatave konkrete me të cilat përballet administrimi i siteve të caktuara. Rrjedhimisht, metodologjia e përdorur është pragmatike dhe përmban elementë vlerësues, krahasues, analistikë dhe rekomandues.

Paradigma kryesore e këtij auditimi është: “Një efektivitet i munguar në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, cënon vlerësimin e trashëgimisë kulturore dhe historike si pasuri, dëmton turizmin në peshën ekonomike të kësaj komponenteje, si dhe zbeh identitetin tonë historik dhe kombëtar”.

Përsa më sipër, grupi i auditimit do të përdorë qasjen **kah sistemi** pasi është analizuar struktura, detyrat dhe funksionimi i njësive qendrore të cilat janë të ngarkuara nga ligji me ruajtjen dhe administrimin e siteve dhe ajo e njësive koordinuese dhe administruese të pesë siteve të lartpërmendura (Apolloni, Bylis, Butrint, Amantia, Orikum).

Pjesë e qasjes do të jenë edhe auditimet e rezultatit, pasi gjatë fazës studimore është konstatuar se ekzistojnë faktorë të jashtëm, që ndikojnë në rezultatet e subjekteve të auditimit, për pasojë tek ruajtja dhe administrimi i siteve arkeologjike.

Grupi i auditimit do të përdorë edhe **metodën krahasimore**, sepse ndërveprimi midis institucioneve në kuadër të këtij objktivi, në përputhje me praktikat më të mira, ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e performancës në raport me rezultatet e synuara.

Epistemologjia do të jetë **interpretuese** dhe **pragmatike**.

2.5.2. Metodat/teknikat audituese

Në përputhje me metodologjinë e përzgjedhur, teknikat për mbledhjen, përpunimin, analizimin e informacionit do të jenë një gërshetim i metodave cilësore dhe sasiore. Në mënyrë që të garantojmë cilësi të lartë, auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet e Auditimit, duke përzgjedhur burimet e informacionit, duke mbledhur, shqyrtuar dhe analizuar dokumentet e vëna në dispozicion, duke siguruar të dhëna shtesë gjatë fazës së terrenit, duke kryer intervista dhe komunikime me subjektet, me ekspertë të sektorit, palë të treta, etj.

Në mënyrë të përbledhur metodat dhe teknikat audituese do të jenë:

- Rishikimi, analiza dhe vlerësimi i raporteve dhe të dhënave të mbledhura gjatë fazës studimore të auditimit;
- Intervista dhe pyetje të hapura me stafin e njësive të administrimit dhe koordinimit të siteve nën auditim, të institucioneve qendrore që ndjekin dhe udhëheqin politikat e siteve, përpunim dhe analizim cilësor e sasior i përgjigjeve të tyre;
- Mbledhje të dhënash nga burime sekondare dhe analizë e tyre;
- Vizita pranë siteve arkeologjike;
- Marrje të dhënash dhe studim i tyre nga botime dhe publikime të ndryshme për politikat e ruajtjes dhe administrimi të siteve;

- Krahasime me literaturën dhe praktikat e vendeve të tjera me përvojë pozitive;
- Analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të mbledhura gjatë fazës së terrenit;
- Analizë cilësore e politikave të ndjekura lidhur me sitet arkeologjike;
- Konsulta me ekspertë të fushës dhe studiues, jashtë subjekteve të auditimit.

2.6. Rezultatet e parashikuara

2.6.1. Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë

Në këtë kuadër, KLSH nëpërmjet mesazhit auditues synon, bërjen transparente të mangësive dhe dobësive të punës së subjekteve që auditohen, të cilat kanë detyra dhe kompetenca të mirëpërcaktuara, në gjenerimin dhe ndjekjen e politikave, me synim ruajtjen dhe administrimin e siteve me efektivitet, si dhe të ofrojë këshillim për përmirësimin e performancës të këtyre strukturave, si në nivel institucional qendror, ashtu dhe siteve specifike, në drejtim të realizimit më efektiv, të objektivave të ruajtjes dhe miradministrimit të tyre.

Me anë të këtij auditimi merr informacion të zgjeruar si ligjvënesi, ashtu dhe ekzekutivi (nëpërmjet Ministrisë së Kulturës), mbi ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, të cilët janë një pasuri multivalente, si kulturore, ashtu dhe historike, me efekte të drejtpërdrejta promovuese të një sektori të ekonomisë tonë, atë të turizmit.

Të njëjtë do marrin informacion edhe mbi vështirësitë, mangësitë dhe dobësitë që karakterizojnë ruajtjen dhe administrimin e siteve të përgjedhur, në terma konkretë, duke e shoqëruar të gjithën edhe me sugjerimet përkatëse, në funksion të përmirësimit të aktivitetit të tyre.

2.6.2. Impakti për publikun dhe palët e interesit

Auditimi i performancës mbi “Efektivitetin e politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016 – 2019”, pritet të ketë një impakt të ndjeshëm për publikun shqiptar.

Qytetari shqiptar përgjatë këtyre dekadave ka krijuar bindjen e vet lidhur me trajtimin dhe vëmendjen që shteti shqiptar i rezervon trashëgimisë kulturore dhe historike në përgjithësi, sikurse dhe siteve arkeologjike në të gjitha kjo përfundimtari përkatëse, që ai merr nga burime të ndryshme.

Ndaj gjykojmë, se ai është shumë i interesuar, të ketë një panoramë të detajuar dhe objektive, të prodhuar nga një autoritet i paanshëm, sikurse është KLSH, me disa nga arsyet e përsene të mangësive, vështirësive, apo arritjeve të vonuara dhe të pjesshme, lidhur me menaxhimin dhe ruajtjen e kësaj pasurie të paçmuar.

Po ashtu, ky auditim përbën një kontribut në përmirësimin e efektivitetit të mbrojtjes dhe promovimit të kësaj trashëgimie, meqë synon të ofrojë këshillim dhe sugjerime për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen MK, Institucionet e specializuara dhe Njësitet e Administrimit dhe Koordinimit në rrafshin e aktivitetit të ushtruar prej tyre, për sitet përkatëse.

Ky auditim do synojë të ndërgjegjësojë NjAKPA-të e siteve, Qeverisjen Qendrore (nëpërmjet Ministrisë së Kulturës), subjekte të tjera shtetërore të lidhura direkt ose indirekt me procesin e administrimit dhe ruajtjes së tyre, lidhur me dobësitë dhe mangësitë që shoqërojnë realizimin e këtyre objektiva.

Që gjatë fazës studimore, grupi i auditimit ka evidentuar disa faktorë që kanë ndikuar në performancën e NjAK-ve dhe rolin e organeve të institucioneve qendrore, lidhur me këto objektiva. Për këto mangësi, të cilat do të janë pjesë e fazës së auditimit që do të ushtrohet në terren dhe të tjera që do të identifikohen gjatë auditimit në terren, grupi i auditimit do të dalë me

konkluzione dhe rekomandime, për të cilat KLSH do të njoftojë subjektet e audituara. Në përfundim të këtij auditimi, do të njoftohen palët e interesit mbi mangësitë, risqet dhe problematikat, strukturat përgjegjëse, si dhe rekomandimet për përmirësimin e tyre në të ardhmen, masat që duhet të merren për plotësimin e tyre, si nga Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, po ashtu edhe institucionet qendrore, të përfshira në auditim.

2.6.3. Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit do të përgatitet projekt-raporti i auditimit, i cili do t'i përcillet MK-së, dhe nëpërmjet saj institucioneve të saj të varësisë, si institucione publike të përfshira në auditim. Mbi këtë bazë dhe diskutimeve interaktive me subjektet e audituara, mbi opinionet e shfaqura prej tyre, do përgatitet raporti përfundimtar i auditimit, një kopje e të cilit do t'i dërgohet edhe subjekteve të audituara si më sipër.

Në zbatim të nenit 34, të Ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ky Raport Auditimi do bëhet i njobur për opinionin publik, në format dhe me mjetet, që do vlerësohen të përshtatshme nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve (*follow-up*), do të bëhet në përputhje me Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenet 15 dhe 30, ku brenda 20 ditëve nga data e marrjes së Raportit të Auditimit, subjektet e audituara do të informojnë rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet.

Subjektet e audituara, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raportojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi securinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

KLSH çdo 6-mujor do të shikojë securinë e rekomandimeve për këtë problem dhe çdo vit do të raportohet në Kuvend. Gjithashtu në bazë të Planit Vjetor të Auditimeve të Departamentit të Performancës, do të auditohet me Program të veçantë të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, zbatimi i rekomandimeve të propozuara nga ky auditim.

2. SHTJELLIMI I I PIRAMIDËS SË PYETJEVE TË AUDITIMIT A KANË REZULTUAR EFEKTIVE POLITIKAT PËR MENAXHIMIN E SITEVE ARKEOLOGJIKE PËR PERIUDHËN 2016 - 2019?

Politikat shtetërore të ndjekura nga Ministria e Kulturës, si ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e siteve arkeologjike, për shkak të mungesës së një kuadri rregullator të plotë në menaxhimin e tyre, nuk kanë rezultuar efektive. Mbivendosja e legjislacionit, si pasojë e funksionimit të njëkohshëm të dy ligjeve për trashëgiminë kulturore, mungesa e akteve nënligjore zbatuese, miratimi i dokumentit strategjik pa plane konkrete veprimi, komunikimi ndërshtitacional i dobët, kanë bërë që menaxhimi i siteve të mos jenë efektiv. Përzgjedhja e kritereve të menaxhimit nuk është bërë mbi bazën e studimeve të kryera nga Ministria e Kulturës, si dhe modelit më të mirë të integruar në kushtet shqiptare. Ndryshimi i strukturave të organizimit, funksionimit dhe administrimit të NJAKPA-ve është kryer pa analiza financiare, pa analiza burimesh njerëzore dhe nevojash për aftësi profesionale specifike, pa një planifikim mbi nevojat e konstatuara dhe rezultatet e dëshiruara.

Ministria e Kulturës, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore dhe NJAKPA-të kanë shfaqur dobësi në marrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të parqeve arkeologjike. Në mungesë të planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore, menaxhimi i siteve në këtë aspekt, nuk ka pasur efektivitet të plotë. Mangësitë infrastrukturore, logjistike dhe njerëzore, në administrimin e parqeve, janë bërë pengesë për krijimit e kushteve sa më të përshtatshme për shfrytëzimin publik të tyre, nga ana e vizitorëve. Mangësi konstatohen edhe në promovimin e tyre nëpërmjet kanaleve të komunikimit masiv. Ministria e Kulturës nuk ka asnjë plan veprimi, sa i takon marrëdhënieve me mediat vizive, lidhur me prodhimin, promovimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike.

3.1 A është hartuar një kuadër ligjor dhe strategjik i plotë për ruajtjen dhe administrimin e parqeve/siteve arkeologjike?

3.1.1 Sa efektiv është kuadri rregullator për parqet/sitet arkeologjike?

Sitet arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, janë një faktor i rëndësishëm i zhvillimit historik, kulturor dhe social ekonomik në vendin tonë. Sitet krijojnë mundësinë e nxitjes dhe aktivizimit të të mirave materiale dhe shërbimeve, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës. Duke qenë atraksione turistike të rëndësishme dhe falë ndërthurjes së pasurive ekologjike dhe arkeologjike, të njobura tashmë në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, sitet arkeologjike zënë një vend të veçantë në spektrin e destinacioneve ekoturistike.

Menaxhimi i parqeve arkeologjike, përballja me çështje kontradiktore lidhur me zotërimin e pronësisë, gërmimin, konservimin, ndryshimet klimatike globale, ndotjen, administrimin etj, të cilat janë në qendër të politikave të institucioneve shtetërore që merren me to, ka mangësi që shfaqen dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve të cilat në kushtet aktuale nuk mund të sigurojnë dhe garantojnë ruajtjen e tyre, duke rrezikuar edhe ekzistencën e tyre.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 kultura dhe trashëgimia përbëjnë një prej sektorëve me ndikimin më të fortë në zhvillimin demokratik të vendit dhe riafirmojnë identitetin kulturor në rajon dhe në Evropë. Në kuadër të kësaj strategjie, synim ka qenë thelli i zhvillimi më tej i industrisë kulturore vendore, si edhe mbrojtja, ruajtja, integrimi dhe transmetimi i tërësisë së vlerave kulturore të krijuara nga populli shqiptar në

shekuj. Në këtë strategji janë të shprehura dhe drejtimet kryesore të politikës shqiptare shtetërore në lidhje me TK materiale dhe jomateriale. Ministria e Kulturës, si institucioni kryesor përgjegjës për hartimin e politikave kombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore, së bashku me organet kolegiale, institucionet e specializuara dhe njësitë e administrimit dhe koordinimit të siteve arkeologjike, janë përgjegjësit kryesorë të zbatimit, monitorimit dhe raportimit të realizimit të tyre. Reformat strukturore, ndryshimet e strukturave hierarkike dhe organeve kolegiale vendimmarrëse, kanë ndikuar dhe në menaxhimin e siteve arkeologjike. Një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave shtetërore të trashëgimisë kulturore luajnë edhe institucionet e tjera shtetërore qendrore, të cilat me harmonizimin e politikave të përbashkëta për TK kanë patur ndikimin e tyre në menaxhimin e siteve. Por, reformat strukturore në këto institucione, si edhe objektivat strategjikë të tyre, në disa raste nuk kanë përkuar në kohë dhe në veprim me ato të ministrisë përgjegjëse për TK.

Menaxhimi i parqeve arkeologjike nënkupton: analizë të detajuar të rëndësisë së tij, kuadër rregullator në funksion të zbatimit të politikave shtetërore, punonjës që arrijnë të kuptojnë vlerat kulturore që duhen ruajtur, plane menaxhimi të cilat duhet të mbajnë parasysh planet kombëtare dhe vendore, ndryshimet demografike, faktorët ekonomikë, planifikimin urban dhe zhvillimin e territorit, inspektimin dhe hartimin e raporteve nga profesionistët me kualifikimet e duhura, hartimin e planeve strategjike të mirëmbajtjes, ruajtjes, konservimit të integruara me planet vjetore të punës, etj.³⁵ Gjatë periudhës objekt auditimi 2016-2019, kuadri rregullator për menaxhimin e parqeve arkeologjike në Ministrinë e Kulturës ka qenë bazuar në Ligjin Nr. 9048, datë 7 prill 2003³⁶, të ndryshuar dhe Ligjin Nr. 27 datë 17. 05. 2018³⁷ dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre. Gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime dhe reforma strukturore në fushën e administrimit dhe menaxhimit të parqeve arkeologjike.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim(SKZHI) 2015-2020³⁸, vizioni i Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë kulturore ka qenë “Artet dhe trashëgimia kulturore, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomiko-shoqëror të vendit”, (paraqitur në draft të pa miratuar) i cili është i njëjtë dhe në dokumentin strategjik të Ministrisë së Kulturës, miratuar me VKM Nr. 903, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”. Në SKZHI 2015-2020, një nga detyrat e lëna për Ministrinë e Kulturës në vijim ka qenë përfundimi i strategjisë për artin dhe kulturën. Ministria e Kulturës që në vitin 2016 ka qenë në proces të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Kulturën për periudhën 2019 – 2025. Gjatë kësaj periudhe është punuar me Programin e Trashëgimisë Kulturore 2013-2017, i cili është hartuar në zbatim të VKM-së Nr. 844, datë 27.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”³⁹. Me daljen e VKM-së Nr. 507, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”⁴⁰, VKM-ja Nr. 844/2013 është shfuqizuar. Në vijim, në mungesë të dokumentit strategjik, zbatimi i këtij programi është bërë në kuadër të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) që miratohet çdo vit. Dokumenti i PBA-së paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të MK dhe mundëson realizimin afatmesëm, për periudhë 4 mujore, 8 mujore dhe vjetore, të objektivave të politikave, me shpërndarjen e burimeve buxhetore, përkatësisht në nivel programi, ***por nuk***

³⁵ “Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore” © Cultural Heritage WithoutBorders 2010. Bernard M. Feilden dhe Jukka Jokilehto.

³⁶ Ligji Nr. 9048, datë 7 prill 2003 “Mbi Trashëgiminë Kulturore”.

³⁷ Ligji Nr. 27, datë 17.05.2018 “Mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

³⁸ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

³⁹ VKM Nr. 844, datë 27.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”.

⁴⁰ VKM-së Nr. 507, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”.

garanton realizimin e objektivave strategjikë të Ministrisë së Kulturës, e cila për këtë periudhë nuk ka patur një dokument të përfunduar.

Në Programin e Trashëgimisë Kulturore 2013-2017 jo vetëm që një nga detyrat e përcaktuara ishte përgatitja e një strategjie kombëtare për artin dhe kulturën, duke përfshirë të gjithë aktorët e fushës, por ndërmjet të tjerash, për parqet arkeologjike duhej: *të përpilohej një hartë rishikim e gjitha parqet, të rishikohej hierarkia e institucioneve qendrore dhe këshillave kombëtare që ekzistonin brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe të riorganizoheshin të gjitha procedurat e vendimmarrjes së tyre, të ndërtohej një strategji e re koordinimi dhe monitorimi e projekteve me donatorët në parqet arkeologjike, të përmirësohej kuadri ligjor për trashëgiminë kulturore*, të verifikoheshin denoncimet e bëra në media lidhur me dëmtimet e trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me policinë e shtetit, si dhe të ndiqeshin me rreptësi të gjitha ngjarjet etj.⁴¹ Disa nga detyrat e sipërpërmendura të këtij programi në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe strategjik për sitet arkeologjike, pavarësisht punës dhe angazhimeve, nuk u realizuan plotësisht deri në vitin 2019.

Nëpërmjet Programit Buxhetor Afatmesëm për sitet arkeologjike parashtronen planet e shpenzimeve të buxhetit përmes lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve me veprimtaritë, objektivat dhe qëllimet e politikës, por këto nuk pasqyrojnë objektivat strategjikë të institucionit, me plane veprimi konkrete dhe përgjegjësit për realizimin e tyre.

Në raportet e punës të vëna në dispozicion nga DPPSTK/DPPZHK⁴², gjatë periudhës 2016-2019, shprehen se kanë patur për detyrë, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, fuqizimin e infrastrukturës së parqeve arkeologjike, rishikimin e strukturave ekzistuese me të cilin operojnë NJAKPA-të për pozicionet e dubluara, përmirësimin e strukturave duke rekrutuar personel që i përgjigjet menaxhimit efektiv të parqeve arkeologjike, rishikimin e zonifikimit dhe rregulloreve ekzistuese, ngritjen e kapaciteteve profesionale në sistemin e trashëgimisë kulturore materiale, vendosjen e biletarive elektronike në institucionet e trashëgimisë kulturore, vendosjen e sistemit të kamerave në 7 sitet e trashëgimisë me qëllim monitorimin e procesit, i cili do të realizohej në ambientet e Ministrisë së Kulturës, përmirësimin e shërbimit dhe performancës së institacioneve të trashëgimisë ndaj vizitorëve, rritjen e transparencës fiskale përmes monitorimit në vazhdimësi të procesit dhe përfthimin e të dhënave në kohë reale drejt institacioneve përfituese dhe Ministrisë së Kulturës, hartimin, përfundimin dhe miratimin e ligjit të ri “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, *si një domosdoshmëri e shtruar nga kërkesat që sistemi i trashëgimisë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit*. Nga mosrealizimi i detyrave të sipërpërmendura, siç konfirmojnë vetë eprorët, ishin vënë re probleme në menaxhimin e siteve, të cilat duhet të përmirësohen më tej dhe kjo nxorri domosdoshmërinë e hartimit të ligjit të ri.⁴³.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9048/2003, të ndryshuar, *shumë dispozita të tij nuk kanë funksionuar siç duhet, pasi nuk u arritën objektivat e parashikuara në*, realizimin konkret të bashkëpunimit privat-shtet, mirëmbajtjen e objekteve të pasurive të paluajtshme, raportet e krijuara ndërmjet privatit dhe shtetit për shfrytëzimin e monumenteve të kulturës ndërmjet rrijetëzimit, kërkesat që sistemi i trashëgimisë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit, administrimin, kontrollin dhe masat për ruajtjen të fondeve të pasurisë kulturore të cilat ishin shoqëruar me dëmtime të monumente me vlera të veçanta kulturore, rrëmbime të objekteve të TK, etj.⁴⁴

⁴¹Programi i Trashëgimisë Kulturore 2013-2017 (Website i MK)

⁴²Raportet e MK (2016-2019) <https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1Yv0M7MPPO3Hë>

⁴³Raportet e MK (2016-2019) <https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1Yv0M7MPPO3Hë>

⁴⁴Përgjigjet e pyetësorëve të ardhura nga MK.

Gjithashtu, bazuar në këtë ligj nuk u realizua harmonizimi i legjislacionit mbi trashëgiminë kulturore me direktivat dhe rregulloret të BE-së për lëvizjen e objekteve kulturore, direktivë e Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian të 15 maj 2014, 2014/60/EU, mbi “Kthimin e objekteve kulturore të hequr në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar dhe amendon rregulloren (EU) nr.1024/2012”, Rregullore e Këshillit të Evropës nr.116/2009, datë 18 dhjetor 2008, për “Ekspordin e mallrave kulturore”. Bazuar në një ligj jo shumë funksional, i cili ishte amenduar tri herë (2006, 2008, 2013), në vitin 2015 u miratua “Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm për Ministrinë e Kulturës”, e cila ishte në fuqi deri në miratimin e rregullores së re me Urdhrin Nr. 92, datë 19.02.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për MK”⁴⁵. Detyrat e stafit të MK-së, janë të përcaktuara në përshkrimin individual të punës, të cilat janë hartuar sipas përcaktiveve të VKM-së Nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruara”. Me miratimin e Urdhrit Nr. 348, datë 18.09.2015 të ministrit të Kulturës “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për MK”, (jashtë afateve) janë rishikuar detyrat e stafit të MK-së, ndërsa ato të institucioneve në varësi të MK-së janë të përcaktuara në kontratën individuale të punës dhe në përshkrimet e punës për çdo punonjës.

Sipas përgjigjeve të MK, gjatë periudhës objekt auditimi e në vijim, kompetencat e stafit të MK-së derivojnë nga VKM nr.507, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës” dhe për institucionet në varësi nga ligji nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si dhe VKM nr.364, datë 29.5.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institututit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

Gjykuar në sa më sipër, ka një problem lidhur me kompetencat dhe detyrat e stafit të Ministrisë së Kulturës. Në VKM-në Nr. 844, datë 27.09.2013, e cila është shfuqizuar me VKM-në Nr. 507 dt. 13.09.2017 përcaktohet fusha e përgjegjësisë së institucionit për zbatimin e politikave shtetërore dhe kjo e fundit ka qenë në fuqi deri në daljen e Ligjit Nr. 27/2018. Bazuar në VKM-në Nr. 142 datë 12.03.2014 e cila është për të gjithë administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura, si edhe në orientim të politikave shtetërore, MK duhet të hartonte dhe miratonte statutet dhe rregulloret e brendshme me detyrat specifike përkatëse dhe përshkrimet e punës për stafin dhe institucionet e varësisë. *Rregullorja bazuar* në Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar, *e miratuar në vitin 2015*, ka qenë në fuqi deri në *miratimin e rregullores bazuar në Ligjin Nr. 27/2018, me Urdhrin Nr. 92, datë 19.02.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për MK”*. Gjatë periudhës objekt auditimi dhe ITKT-ja ka funksionuar *me statutin dhe rregulloren bazuar në ligjin 9048/2003, të ndryshuar*, respektivisht, statuti miratuar me Urdhrin Nr. 9, datë 23.01.2017 “Për miratimin e statutit të Institucionit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri””, dhe rregulloren miratuar me Urdhrin Nr. 128, datë 24.01.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme të IMK”, ndërkohë që rregullorja e MK kishte dalë që në vitin 2015. Gjykuar në sa më sipër konstatohet se, për shkak të funksionimit të njëkohshëm të dy ligjeve dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre dhe mbivendosjes së legjislacionit (VKM të miratuara në periudhën 1998– 2014-2017), *nuk janë rishikuar aktet nënligjore dhe administrative të institucioneve të varësisë ku përcaktohen kompetencat e tyre deri në kohën e miratimit të ligjit të ri*.⁴⁶ Me miratimin e Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ndryshuan strukturat, institucionet e varësisë, u krijuan

⁴⁵Urdhër Nr. 92, datë 19.02.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për MK”.

⁴⁶Përgjigjet e pyetësorëve të ardhura nga MK.

organe të reja kolegiale dhe MK-ja ka miratuar organigramën, por ***nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara rregulloren e brendshme administrative***, mbi bazën e së cilës hartohen dosjet me përshkrimin e funksioneve të punonjësve dhe stafit drejtues, specifikat e procedurave të punës së tyre si edhe në çdo drejtori, evidentohen modalitetet, rregulla, kërkesa dhe procedura që i shërbejnë efektivitetit të shërbimit të administratës së institucionit, gjithashtu dhe institacioneve të varësisë. ***Kjo rregullore është miratuar me Urdhrin Nr. 92, datë 19.02.2020 të ministrit të Kulturës “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për MK”, jashtë afateve ligjore të parashikuara.***

Ministria ka rikonceptuar sistemin strukturor të trashëgimisë kulturore brenda strukturës së saj, nëpërmjet ristrukturimit të ish-Drejtorisë së Përgjithshme për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor në Drejtori të Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës. Gjatë periudhës 2016-2019, këto drejtori kanë ushtruar rolin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe hartimin e kuadrit të ri ligjor, plan veprimeve, planeve operacionale përmes të cilave janë paraqitur objektivat duke propozuar modelet më të mira në funksion të menaxhimit të sive dhe të kuadrit strategjik, por gjykuar në sa më sipër, veprimtaria e kësaj drejtorie, pa përshkrimet punës, nuk është bazuar në rregulloren e brendshme administrative institucionale, e cila nuk ka qenë e miratuar në këtë periudhë.

Bazuar në Urdhrin Nr. 220, datë 12.04.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025”, një nga detyrat e grupit ka qenë hartimi i, objektivave strategjikë, ***planit të veprimit të realizimit të tij dhe raportimi i realizimit.*** Gjithashtu bazuar në Urdhrin Nr. 624 datë 12.09.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore të Ligjit Nr. 27.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, grupi i punës ka patur për detyrë miratimin e një ***kalendari pune duke përcaktuar prioritetin e secilit akt sipas fushës së kompetencës dhe afatin ligjor për nxjerrjen e tij. Ky kalendar është ngritur vetëm për vitin 2020, pa ndarë prioritetet.*** Me VKM Nr.887 datë 24.12.2019 është miratuar Programi i Përgjithshëm Analistik i Projekt akteve dhe i vetmi akt nënligjor i parashikuar, lidhur me parqet arkeologjike është projektvendimi “ Për përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës”, i cili është miratuar me Vendimin Nr. 339 dt.13.05.2020. Në zbatim të, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit Nr.22 dt 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, DPTDK/DPPZHK ushtron rolin e saj nëpërmjet pjesëmarrjes në përbërjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) të Ministrisë së Kulturës. Këto drejtori, pavarësisht se kanë qenë aktor i rëndësishëm në Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019-2025, nuk kanë qenë shumë eficiente gjatë periudhës objekt auditimi, ***pasi disa nga detyrat funksionale të tyre nuk janë realizuar brenda afateve ligjore të parashikuara. Si rezultat i funksionimit të dy ligjeve,*** Ligjit Nr. 9048/2003 “Për Trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar dhe jo funksional në disa aspekte dhe Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” konceptuar si Kod që të përfshijë të gjithë kuadrin ligjor të detajuar për trashëgiminë kulturore, ligj voluminoz, ***pa një dokument strategjik të miratuar, me mungesë aktesh nënligjore, me mosfunkcionim të bordit, me mbivendosje kompetencash dhe komunikim institucional e ndërinstitucional të dobët,*** (mos akordime për sa i takon aspektave të fushës së kompetencës me Ministrinë e Kulturës apo institucionë të tjera ku ndërthuren fushat e kompetencës, vonesa në kthimin e përgjigjeve përmarrje/dhënie mendimi mbi projektvendimet, bashkërendimi me disa institucionë nuk ka qenë gjithmonë i lehtë, pasi ka pasur pika të cilat palët i kanë mbrojtur dhe nuk kanë dashur të

ndryshojnë qëndrimin e tyre), *menaxhimi i siteve arkeologjike ka patur problematika të shfaqura dhe të evidentuara në përgjigjet e pyetësorëve, raportet e MK-së ashtu dhe në takimet me drejtuesit e tyre.*⁴⁷

Institucioni i specializuar IKTK-ja (ish- IMK), gjatë periudhës objekt auditimi ka funksionuar me statutin dhe rregulloren bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar, respektivisht, statuti i miratuar me Urdhrin Nr. 9, datë 23.01.2017 “Për miratimin e statutit të Institucionit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, dhe rregulloren e miratuar me Urdhrin Nr. 128 datë, 24.01.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme të IMK”. Struktura e tij në këtë periudhë ka qenë sipas skemës së mëposhtme:


Skema 5: *Instituti i Monumenteve të Kulturës 2016-2018.*



Burimi: *Ministria e Kulturës.*

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, krijuar me VKM nr. 364/2019⁴⁸, struktura e të cilit është miratuar me Urdhrin nr. 137/2019⁴⁹ të Kryeministrit të Shqipërisë, ka në varësi dy drejtori: “Drejtorinë e Monumenteve të Kulturës” dhe “Drejtorinë e Shërbimeve Arkeologjike”. Struktura e tij sot është sipas skemës së mëposhtme:

Skema 6: *Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore 2018-2019.*



Burimi: *Ministria e Kulturës*

⁴⁷ Përgjigje e pyetësorëve nga MK dhe intervistat me stafin dhe drejtuesit e NJAKPA.

⁴⁸ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 364, datë 29.5.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”

⁴⁹ Urdhër Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”

Në shkresën nr. 4018/1 prot, dt. 23.09.2020 me Urdhrin Nr. 342, dt. 22.09.2020 të ministrit të Kulturës, është miratuar *statuti i ri i IKTK-së*. Me Urdhrin nr.344, datë 22.09.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të IKTK”, është miratuar dhe *rregullorja e IKTK-së*. *Të dyja aktet nënligjore si edhe struktura e IKTK nuk janë miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara*. Ndryshimi i roleve dhe përgjegjësive të strukturave, i pa përfaqësuar në aktet nënligjore dhe administrative përkatëse, gjatë periudhës objekt auditimi ka bërë që të ketë papërgjegjshmëri dhe komunikim institucional të dobët, gjë e cila *shfaqet në vonesat e hartimit të akteve*.

Siq u shprehëm më lart, me miratimin e Ligjit Nr. 27/2018, kanë ndryshuar varësitë institucionale të disa njësive të administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike.

Ndërsa varësitë institucionale kanë ndryshuar, *parjet arkeologjike funksionojnë ende në bazë të rregulloreve të administrimit miratuar me VKM Nr. 396/ 2005⁵⁰, të ndryshuar, jo të rishikuar bazuar në detyrat funksionale dhe legjislacionin përkatës*.

Ligji Nr.27/2018 nuk parashikon rregullore për administrimin dhe funksionimin e parqeve arkeologjike, por plane menaxhimi dhe plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore. Siq shprehen dhe vetë eprorët e MK-së, *nuk është hartuar asnjë plan menaxhimi, përvèç Planit të Menaxhimit të Integruar të Butrintit*. Drejtuesit e MK-së janë të mendimit se përfshirja e NJAKPA-ve në strukturat e DRTK-ve, krahasuar me strukturat e vjetra ku NJAKPA-të kanë qenë institucionë më *vete do të çojnë në përmirësimin e situatës dhe rritjen e efektivitetit të tyre, por kjo e pabuar në ndonjë analizë dhe studim. Në pyetësorët e dërguar në Ministrinë e Kulturës kjo nuk u evidentua në asnjë dokument*.

Me hyrjen në fuqi e Ligjit Nr. 27/2018, në kushtet e hartimit të planeve të menaxhimit, Ministria e Kulturës duhet të kishte miratuar vendimin për kufijtë e territorit gjeografik, strukturën dhe organikën e NJAKPA-ve.

Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 janë krijuar institucionet e specializuara dhe organe të reja kolegiale vendimmarrëse. Lidhur me menaxhimin e siteve mund të themi se, bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr. 27/2018, *termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme i nënshtrohen miratimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore pas marrjes së mendimit paraprak nga KKTJM-ja dhe KKMPK-ja*.

VKM-ja Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, e cila ka dalë brenda afateve ligjore të parashikuara, *nuk shprehet për këtë kompetencë, pra, për funksionin këshillues të KKTJM-së*.

Megjithëse VKM-ja për KKTJM-në ka dalë brenda afateve ligjore të parashikuara, *Urdhri Nr. 223, datë 3.7.2020* për “Miratimin e rregullores “Për veprimtarinë e KKTJM, Këshillit Teknik, të sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj” *nuk është miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara*. Në zbatim të pikës 4, të nenit 38, të Ligjit Nr. 27/2018, *ky urdhër duhet të dilte brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji*. Ka një kontradiktë në këto dy akte, pasi *rregullorja e veprimtarisë së këtij organi kolegjal vendimmarrës, nuk mund të dilte përpresa daljes së aktit*. Bazuar në VKM Nr. 208, datë 10.04.2019, ky organ duhet të ishte në veprim dhe

⁵⁰VKM Nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të shkodrës, lezhës, apolonisë, bylisit, amantias, orikumit, antigonesë, finiqit dhe butrintit” i azhornuar me: VKM nr.163,datë 27.02.2013, vkm nr.249, datë 30.04.2014.

⁵⁰ VKM Nr. 249/2014⁵⁰ “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikutit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.

vendimet duhet të merreshin prej tij. Në informacionin e vënë në dispozicion nga MK-ja rezulton se dhe pas datës 10.04.2019, *disa vendime janë miratuar nga KKR-ja⁵¹ dhe KKA-ja⁵²*, dhe *procedurat nuk janë kryer sipas rregullores së veprimtarisë së KKTKM-së, pasi kjo nuk ishte miratuar ende*. Ky proces nuk është kryer konform legjislacionit në fuqi dhe ka mbivendosje kompetencash midis organeve kolegiale vendimmarrëse.

Në VKM-në Nr. 279 datë 02.05.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore”, në pikën i. Paragrafi IV “Kompetencat e KKMPK-së”, *citohet funksioni këshillues i KKMPK-së*.

Në VKM-në Nr. 279, datë 02.05.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të KKMPK”, shprehet funksioni këshillues i këtij këshilli për miratimin e termave të referencës dhe planeve të menaxhimit, gjithashtu edhe kompetencat e tij. Për të realizuar funksionin vendimmarrës të këtij këshilli, *MK-ja në kundërshtim me detyrimin ligor nuk ka miratuar rregulloren për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike të tij*. Mungesa e këtyre akteve ka sjellë mbivendosje kompetencash midis BKPA/ BKPAK Butrint dhe KKMPK-së në menaxhimin e siteve.

Miratimi i akteve nënligjore dhe administrative në përgjithësi si dhe funksionimi i organeve kolegiale vendimmarrëse është domosdoshmëri për transparencën e proceseve, shmangjen e mbivendosjes së kompetencave, menaxhimin efektiv të siteve.

BKPA-ja, i krijuar me VKM-në Nr. 396, datë 31.3.2005⁵³, të ndryshuar, si organ vendimmarrës, i cili mbikëqyr veprimtarinë e NJAKPA-ve dhe strukturave përkatëse pranë DRKK-ve, i cili kryesohet nga Ministri i Kulturës *ka për detyrë, hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e strategjisë së zhvillimit të gjithë parqeve/siteve arkeologjike, (përjashtuar PK Butrintin), miratimin e programeve dhe projekteve të paraqitura nga NJAKPA-të dhe përcaktimin e mënyrave të bashkëpunimit me institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe atyre natyrore e mjedisore, aprovimin e planeve vjetore të parqeve arkeologjike etj.* BKPA mbikëqyr veprimtarinë, *miraton buxhetin e NJAKPA-ve, si dhe shpërndarjen e të ardhurave që vijnë nga aktivitetet dhe administrimi i parqeve, mbështetur në raportimet zyrtare të paraqitura nga drejtoret e NJAKPA-ve*.

Gjithashtu, në pikën 20, të Kreut V të VKM-së Nr. 396, datë 31.03.2005, të ndryshuar, citohet që *“Institucionet përfaqësuese në BKPA kontribuojnë financiarisht për zbatimin e projekteve në parqet arkeologjike”, gjë e cila nuk ka funksionuar gjatë kësaj periudhe*.

Me përcaktimin e strukturave përgjegjëse për parqet arkeologjike sipas VKM-së Nr. 249/2014⁵⁴, u rishikuan detyrat e bordit. *Për të rritur transparencën dhe menaxhimin e parqeve në*

⁵¹ Vendim KKR Nr. 228, datë 05.07.2019.

Vendim KKR Nr. 257, datë 23.07.2019.

Vendim KKR Nr. 326, datë 10.10.2019.

Vendim KKR Nr. 363, datë 01.11.2019.

⁵² Vendim KKA Nr. 237 datë 31.10.2019 “Relacion verifikimi - gjetje arkeologjike rastësore, Gjorm, Vlorë”.

Vendim KKA Nr. 180 datë 31.07.2019 “Plotësim me ambiente shërbimi në lokalini “Leon Ray”, Apoloni”.

Vendim KKA Nr.137 datë 28.05.2019 “Projekt për ndërhyrje rehabilituese në parkun arkeologjik të Amantias”.

⁵³ VKM Nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të shkodrës, lezhës, apolonisë, bylisit, amantias, orikumit, antigonesë, finiqit dhe butrintit” *i azhornuar me: vkm nr.163, datë 27.02.2013, vkm nr.249, datë 30.04.2014.*

⁵⁴ VKM Nr. 249/2014⁵⁴ “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.

mbledhjet e BKPA-së do të merrnin pjesë dhe drejtorët e drejtorive rafionale të kulturës kombëtare të Gjirokastrës, Shkodrës, Vlorës dhe drejtori i NJAKPA-së Apoloni-Bylis, por pa të drejtë vote.

Ky bord gjatë periudhës objekt auditimi dhe në vijim pothuajse ka qenë inekzistent dhe nga Ministria e Kulturës nuk na u paraqit asnjë dokumentacion lidhur me veprimitarë e bordit, takimet dhe vendimet e tij. Gjithashtu dhe drejtuesit e parqeve arkeologjike nuk kishin dijeni për ekzistencën e bordit, si organ vendimmarrës për to. Problematikat dhe çështjet që lidheshin me sitet nuk janë bërë prezent te BKPA, përjashtuar bordin e Butrintit, siç ka qenë detyrimi bazuar në aktet nënligjore të mësipërme. Në përgjigjet e ardhura nga MK, IKTK dhe në takimet me drejtuesit e parqeve arkeologjike, nuk shprehen për bordin e parqeve arkeologjike dhe as nuk janë vënë në dispozicion vendimet e tij, përvèç bordit të Butrintit. BKPA ka ekzistuar vetëm në letra dhe nuk ka kryer asnjë lloj funksioni në përbushje të detyrimeve ligjore.

*Në përgjigjet e pyetësorëve nga MK, na u konfirmua se, rregulloret e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të NJAKPA-ve si dhe statutet e DRTK-ve, janë në proces rishikimi. Rregulloret e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, **nuk janë detyrim ligjor për miratim nga Ministria e Kulturës, prandaj nuk duhet të miratohen prej saj. Por mungesa e BKPA ka bërë që rregulloret e brendshme të miratohen në MK. Kjo është një parregullsi organizative e institucionit, pasi anashkalon përgjegjësitë për kryerjen e detyrave.***

Mosfunkcionimi i BKPA-së, si një organ kolegjal vendimmarrës për menaxhimin e parqeve, ka bërë që të ketë mbivendosje kompetencash, vonesa dhe mungesë transparence në vendimmarrje dhe joefektivitet në zbatimin e politikave shtetërore.

Bordi i Butrintit dhe NJAKPK Butrint (ish-ZAKPK Butrint), rregullorja e të cilit është miratuar me VKM-në Nr.857, datë 19.12.2003⁵⁵ “Rregullorja e funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint”, janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e programit vjetor në PK të Butrintit, në bashkëpunim me IKTK-në, sipas politikave dhe objektivave të zhvillimit.

Përsa i takon BKPK Butrint mund të thuhet se ky ka qenë funksional, si në vendimmarrje dhe në veprim dhe për këtë bord na janë vënë në dispozicion vendimet e marra prej tij, lidhur me menaxhimin e PK Butrint. Pra, gjykuar në sa më sipër, pavarësisht se NJAKPA-të kanë patur organe kolegiale si edhe Butrinti, **nga Ministria e Kulturës janë ndjekur dy standarde për menaxhimin e tyre, e cila nuk shpjegohet në përgjigjet e pyetësorëve.**

Gjatë periudhës objekt auditimi, Ministria e Kulturës, BKPA/BKPA Butrint, DPPSTK/DPPZHK dhe institucionet në varësi të saj, kanë qenë përgjegjësit kryesor për hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së zhvillimit. Duhet theksuar se problematikat e sipërpërmendura, të lidhura me planifikimin, programimin dhe buxhetimin, eprorët e MK i konsiderojnë të rëndësishme për menaxhimin, por më të rëndësishëm konsiderojnë planifikimin pasi nëpërmjet tyre orientohet programimi dhe buxhetimi. **Në këto kushte, gjykuar si nga rëndësia e planifikimit, por dhe nga detyrimi ligjor, Ministria e Kulturës nuk ka hartuar asnjë plan menaxhimi, përvèç Butrintit.**

Ministria e Kulturës, me VKM-në Nr. 903, datë 24.12.2019⁵⁶ ka miratuar “Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë 2019-2025”, përgatitja e së cilës ka filluar që në 2016. Referuar qëllimeve politike dhe objektivave specifike në lidhje me sitet arkeologjike

⁵⁵VKM nr.857, datë 19.12.2003⁵⁵ “Rregullorja e funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint”.

⁵⁶VKM Nr. 903, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025”.

konfirmojmë se janë po ato qëllime dhe objektiva që kanë qenë të pasqyruara në SKZHI 2015-2020. Në proces janë përfshirë fillimisht ekspertët kombëtare dhe ndërkombëtare të cilët kanë prodhuar një set me dokumente, *por ky proces rezultoi në një draft dokument të pamiratuar. Strategja Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë 2019-2025, miratuar me VKM-në Nr. 903, datë 24.12.2019⁵⁷*, nuk ka një plan konkret veprimi me aktivitete për realizimin e objektivave strategjikë, me afate kohore dhe përgjegjës për realizimin e tij.

Bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, *në kuadrin e planeve të veta sektoriale*, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, *harton planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara*. Gjykuar në sa më sipër, *bazuar në pikën 4 të nenit 245*, për të zgjidhur sa më shpejt problematikat e shfaqura në menaxhimin e parqeve arkeologjike, *Ministria e Kulturës duhet të propozojë dhe të miratojë Planin Kombëtar të Peizazhit, sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithashtu, në zbatim të pikës 8 të nenit 30 të Ligjit Nr. 27/2018, IKTK-ja nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit në bashkëpunim me institucione të vëtëqeverisjes vendore, partnerë publikë e privatë, vendas dhe të huaj, mund të luajë rolë të madh në kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut.*

Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, grupi i auditimit ka konstatuar si më poshtë:

Në kundërshtim me nenin 263, Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar brenda afateve liggore të parashikuara aktet nënligjore të mëposhtme:

- Në zbatim të pikës 3, të nenit 19, VKM-në “*Për përcaktimin e rregullave të administrimit të Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore Materiale*”.
- Në zbatim të pikës 1, dhe 2 të nenit 28, VKM-në “*Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të TK*”.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 186, VKM-në “*Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të kontratës së riqetëzimit*”.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 37, VKM-në “*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegiale në fushën e trashëgimisë kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 9, të nenit 29, VKM-në “*Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së “Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim” (QRKR)*”.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 46, VKM-në “*Për shtrirjen, strukturën, përbajtjen dhe metodologjinë e përgatitjes së planeve të menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 82, VKM-në “*Për kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategorië e licencave, procedurat për dhënien, pezullimin ose revokimin e tyre, si dhe kuotizacioni vjetor i tyre për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore material*”.
- Në zbatim të pikës 3, nenit 90, VKM-në “*Për procedurat e përzgjedhjes për investimet me fonde publike*”.

⁵⁷ VKM Nr. 903, datë 24.12.2019⁵⁷ “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”.

- Në zbatim të pikës 4, të nenit 136, VKM-në “*Për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike*”.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 178, dhe pika 4 nenit 184, VKM-në “*Për procedurat dhe kriteret e konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore*”.

Në kundërshtim me nenin 263, Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar aktet nënligjore të mëposhtme, të cilat nuk janë dërguar nga MK:

- Në zbatim të pikës 3, të nenit 11, VKM-në “*Për ruajtjen e TK nga rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktet e armatosura*”.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 12, VKM-në “*Për rregullat e administrimit të pasurive kulturore dhe funksionimin e subjekteve juridike, me qëllim vlerësimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 27, VKM-në “*Për mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 96, VKM-në “*Për përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin*”.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 109, VKM-në “*Për procedurat dhe kriteret e konkurrimit për tjetësimin e pasurive kulturore jopublike në pronësi të shtetit*”.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 116, VKM-në “*Për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 6, të nenit 133, VKM-në “*Për procedurat për hulumtimet arkeologjike*”.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 139, VKM-në “*Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike*”.
- Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 171, VKM-në “*Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore*”.

Në kundërshtim me nenin 264 dhe nenin 268 Ministria e Kulturës nuk ka miratuar aktet nënligjore:

- “*Komentarin dhe manualin e përkufizimeve*”.
- Në zbatim të pikës 3 të nenit 10 “*Udhëzimin për kriteret dhe procedurat standarde të kalimit të pronës në administrim*”.
- Në zbatim të pikës 3 të nenit 12 “*Udhëzimin për rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 19 “*Udhëzimin për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 40 “*Urdhrin për rregulloren për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike*”.

- Në zbatim të pikës 6, të nenit 53 “*Udhëzimin për termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme*”.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 56 “*Udhëzimin për procedurat dhe mënyrat e inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit të pasurive kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 8, të nenit 56 “*Udhëzimin për funksionimin e Sistemit digital për bazën e të dhënavë të pasurive kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 1 të nenit 58 “*Udhëzimin për kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim, metodologjinë e tarifave, organet këshillimore, kriteret për marrjen e vendimit, si dhe dokumentacionin shoqëruesh të aplikimit*”.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 58 “*Udhëzimin për kriteret e përpilimit të listave të pasurive të paluajtshme në pronë shtetërore, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruuese dhe dërgimin e tyre për verifikim*”.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 59 “*Udhëzimin për mënyrën e funksionimit të komisionit këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jomateriale*”.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 59 “*Udhëzimin për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së*”.
- Në zbatim të pikës 12, të nenit 71 “*Udhëzimin për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshme*”.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 80 “*Urdhrin për formatin e kërkesës dhe dokumentacionin shoqëruesh për lëshimin e lejes për ndërhyrje në pasuritë kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 6, nenit 82, dhe të pikës 2 të nenit 137, “*Udhëzimin për kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues të personave të pajisur me licencë për kryerjen e veprimitarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe me licence për kryerjen e veprimitarive arkeologjike*”.
- Në zbatim të pikës 3, nenit 85; “*Udhëzimin për mënyrën dhe formën e mbajtjes së informacionit nga subjektet publike ose private për pasuritë kulturore që kanë në pronësi ose administrim*”.
- Në zbatim të pikës 9, të nenit 92, “*Udhëzimin për mënyrat e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse*”.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 100, “*Udhëzimin për kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat, kohëzgjatjen dhe tarifat për dhënien e miratimit dhe deklarimin e interesit kulturor*”.
- Në zbatim të pikave 1 dhe 4, të nenit 102, “*Udhëzimin për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve*”.
- Në zbatim të pikës 7, të nenit 116, “*Udhëzimin për krijimin dhe funksionimin e “Regjistrit të tregimit të pasurive kulturore”*”.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 123, “*Udhëzimin për procedurat dhe mënyrat e daljes së pasurive jashtë vendit*”.
- Në zbatim të pikës 6, të nenit 130, “*Udhëzimin për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënavë dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura*”.
- Në zbatim të nenit 140 të këtij ligji “*Udhëzimin për rregullat e hollësishme mbi lejen për hulumtime arkeologjike*”.

- Në zbatim të pikës 2, nenit 150, të këtij ligji “*Udhëzimin për mënyrën e vlerësimit të gjetjeve rastësore të objekteve arkeologjike*”.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 165, “*Udhëzimin për format e mbështetjes së veprimitarive dhe strukturave për vlerësimin e pasurive kulturore në pronësi private*”.
- Në zbatim të pikës 2, nenit 179, “*Udhëzimin për përcaktimin e rregullave për dhënien në përdorim të drejtëpërdrejtë të pasurive kulturore*”.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 96 të këtij ligji *duhet të miratojë “Parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin”*.

Në kundërshtim me nenin 265 Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave nuk kanë miratuar aktet nënligjore:

- Në zbatim të pikës 10, të nenit 29 “Udhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKTK-ja”.
- Në zbatim të pikës 6, nenit 31, “Udhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga DRTK-të”.
- Në zbatim të pikës 7, nenit 32, të këtij ligji “Udhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKRTK-ja”.

Gjetje:

- Ligji Nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, *nuk ka qenë shumë funksional. Në zbatim të tij nuk janë arritur objektivat e parashikuara në, realizimin e bashkëpunimit privat-shtet, mirëmbajtjen e objekteve të pasurive të paluajtshme, harmonizimin e legjislacionit* mbi trashëgiminë kulturore me direktivat dhe rregulloret të BE-së, etj.
- *Ministria e Kulturës* për periudhën 2016-2019 *nuk ka përfunduar dokumentin strategjik* nisur që në vitin 2016, përfundimi i të cilit ka qenë detyrim dhe në SKZHI 2015-2020, si dhe Programin e Trashëgimisë Kulturore 2013-2017. Zbatimi i politikave shtetërore në kuadër të *Planifikimit Buxhetor Afatmesëm, realizon objektiva në nivel programi, por nuk garanton realizimin e objektivave strategjikë të Ministrisë së Kulturës*.
- Bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar si dhe VKM-në nr. 142 datë 12.03.2014 e cila vlen për të gjithë administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura, *Ministria e Kulturës*, ka funksionuar me *rregulloren e brendshme miratuar në vitin 2015*, e cila ka qenë në fuqi deri më datë 19.02.2020. Gjithashtu dhe IKTK-ja ka funksionuar *me statutin dhe rregulloren bazuar po në këtë ligj*, por miratuar më vitin 2017, respektivisht, statuti miratuar me Urdhrin Nr. 9, datë 23.01.2017 “Për miratimin e statutit të Institucionit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri””, dhe rregulloren miratuar me Urdhrin Nr. 128, datë 24.01.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme të IMK”. *Rregullorja e ITKT-së është miratuar me dy vite vonesë nga miratimi i rregullores së institucionit qendror*.
- Emërimi i titullarit të ministrisë në katër nivele të menaxhimit të sitemit të trashëgimisë kulturore, BKPA/ BKKPK Butrint, KTKM, KKMPK, kompromenton ose eliminon hierarkinë për vendimmarrje të natyrave të ndryshme dhe sjell një centralizim të

panevojshëm i cili mund të ndikojë negativisht në realizimin e objektivave të institucionit.

- **Ministria e Kulturës**, me miratimin e Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka miratuar organigramën, ka ndryshuar strukturat, janë krijuar organe të reja kolegiale, por *nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara rregulloren e brendshme administrative. Kjo rregullore është miratuar me Urdhrin Nr. 92, datë 19.02.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për Ministrisë së Kulturës”, jashtë afateve ligjore të parashikuara.*
- Ministria e Kulturës, me VKM-në Nr. 903, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, ka miratuar strategjinë e re, me objektiva të njëjtë me ato SKZHI 2015-2020 dhe pa plane veprimi konkrete. Bazuar në Urdhrin Nr. 220, datë 12.04.2018 “Për ngritjen e grupit të punës pë bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025”, një nga detyrat e grupit ishte *hartimi i planit të veprimit të tij dhe raportimi i realizimit të tij.*
- **Ministria e Kulturës, në kundërshtim me VKM Nr. 396, date 31.03.2005, të ndryshuar, nuk ka realizuar funksionimin e BKPA-së**, (përjashtuar BPKPK Butrint), si organ vendimmarrës, i cili mbikëqyr veprimtarinë e NJAKPA-ve dhe strukturave përkatëse pranë DRTK-ve. Ky bord ekziston vetëm në shkresa. Lidhur me veprimtarinë, takimet dhe vendimet e tij nuk na u paraqit asnjë dokumentacion.
- **DPPSTK/DPPZHK**, si njësia kryesore përgjegjëse dhe *pjesë e grupeve të punës në hartimin e politikave shtetërore për TK*, veçanërisht për sitet arkeologjike *nuk kanë qenë shumë eficiente* pasi veprimtaria e tyre, *nuk është bazuar në rregulloren administrative institucionale*, e cila nuk ka qenë e miratuar në këtë periudhë, si dhe disa nga detyrat funksionale të tyre nuk janë realizuar brenda afateve ligjore të parashikuara.
- **Grupi i punës dhe strukturat përgjegjëse**, bazuar në Urdhrin Nr. 624 datë 12.09.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore të Ligjit Nr. 27.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, *nuk kanë miratuar kalendarin e punës duke përcaktuar prioritetin e secilit akt sipas fushës së kompetencës dhe afatin ligjor për nxjerrjen e tij. Për periudhën 2016-2019 nuk na u vu në dispozicion ky kalendar pune i miratuar.*
- Ministria e Kulturës ka zhvilluar politikat shtetërore për parqet arkeologjike, bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003 “Për Trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, jofunksional në disa aspekte dhe Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, konceptuar dhe parashikuar si Kod që të përfshijë të gjithë kuadrin ligjor të detajuar për trashëgiminë kulturore, ligj voluminoz, pa një dokument strategjik të miratuar, me mungesë aktesh nënligjore. *Funksionimi i njëkohshëm i tyre ka sjellë menaxhim joefektiv të siteve arkeologjike, evidentuar në përgjigjet e pyetësorëve, raportet e MK-së ashtu dhe në takimet me drejtuesit e siteve arkeologjike.*⁵⁸
- **Ministria e Kulturës ka miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara strukturën, statutin dhe rregulloren e IKTK-së**. Ndryshimi i roleve dhe përgjegjësive të strukturave i pa përfaqësuar në aktet nënligjore dhe administrative përkatëse, gjatë periudhës objekt

⁵⁸Përgjigje e pyetësorëve nga MK dhe intervistat me stafin dhe drejtuesit e NJAKPA.

auditimi ka bërë që të ketë papërgjegjshmëri dhe komunikim institucional të dobët, gjë e cila *shfaqet në vonesat e hartimit të akteve*.

- Në VKM-në Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara, *nuk shprehet funksioni këshillues i KTKM-së, lidhur me termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasursive kulturore të paluajtshme*, si kompetencë e tij, detyrim ligjor. (Neni 47 i Ligjit Nr. 27/2018).
- *Ministria e Kulturës nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara* Urdhrin Nr. 223, datë 3.7.2020 për “Miratimin e rregullores për veprimtarinë e KTKM-së, këshillit teknik, të sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj”.
- *Ministria e Kulturës nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara urdhrin për rregulloren për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike të saj.*
- *Në Ligjin Nr. 27/2018 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ka mbivendosje kompetencash* midis institucioneve të specializuara IKTK-së, IKRTK-së dhe organeve kolegjiale KTKM, KKMPK, pa përjashtuar dhe BKPA, respektivisht si më poshtë vijon:
 1. pika 13 neni 30; pika 4 neni 32; pika 2 e nenit 56, të ligjit të sipërpërmendur, lidhur me regjistrat kombëtare të vlerave kulturore materiale.
 2. germat f) h) n) të paragrafit IV të VKM-së Nr. 208/2019;
 3. pika i. ii. iii. iv germa c) të VKM-së Nr. 279, dt. 2.5.2019.
 4. VKM-ja Nr. 279, dt. 02.05.2019 dhe VKM-ja Nr. 396 datë 31.03.2005, mbi kompetencat e BKPA/ BKPAK Butrint dhe KKMPK në menaxhimin e siteve.
- *Ministria e Kulturës*, bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 i cili nuk parashikon rregullore për administrimin dhe funksionimin e siteve arkeologjike, por plane menaxhimi dhe plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasursive kulturore, *nuk ka hartuar planet e menaxhimit, planet e ruajtjes dhe administrimit të parqeve arkeologjike, përvçe Butrintit*.
- *Ministria e Kulturës nuk ka nxjerrë komentarin dhe manualin e përkufizimeve*. Ligji Nr. 27/2018 si ligj inovator është konceptuar dhe parashikuar të jetë një Kod i cili të përfshijë të gjithë kuadrin ligjor të detajuar për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë. Ligji i sipërpërmendur paraqet vështirësi në trajtimin e vet dhe është më se e nevojshme nxjerra menjëherë e manualit të përkufizimeve.
- *Këshilli i Ministrave*, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 263, *nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara aktet nënligjore të sipërpërmendura*.
- *Këshilli i Ministrave*, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 263, *nuk ka miratuar aktet nënligjore të sipërpërmendura*.
- Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 264, *Ministria e Kulturës, nuk ka miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara aktet nënligjore të sipërpërmendura*.
- Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenet 264 dhe 268, *Ministria e Kulturës, nuk ka miratuar aktet nënligjore të sipërpërmendura*.

- Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, në kundërshtim me nenin 265, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave, nuk kanë miratuar aktet nënligjore të sipërpërmendura.

Konkluzione:

- Gjatë zbatimit ndër vite të Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, nga mosrealizimi i objektivave të parashikuara, sistemi i trashëgimisë kulturore ka patur probleme në mënyrën e menaxhimit, konservimit dhe restaurimit, administrimit, kontrollit, bashkëpunimit privat-shtet, shfrytëzimit të monumenteve të kulturës etj. Si pasojë, janë dëmtuar monumente me vlera të veçanta kulturore, nuk është harmonizuar legjislacioni mbi trashëgiminë kulturore me direktivat dhe rregulloret të BE-së si një ndër kushtet e integrimit të vendit drejt BE.
- Mos përfundimi në kohë i një dokumenti strategjik i cili mbeti në kuadrin e draftit të pafinalizuar, duke mos gjetur zbatim në ruajtjen, mbrojtjen dhe kujdesin e TK kombëtare, si edhe hartimi i një dokumenti strategjik për periudhën 2019-2025, me objektiva dhe përparsi strategjike të njëjtë me ato të SKZHI 2015-2020 dëshmon për mosrealizime dhe joefektivitet të politikave shtetërore për periudhën 2016-2019. Gjithashtu, drejtoritë përgjegjëse për hartimin e politikave shtetërore për TK, si pjesë dhe e grupit të punës për hartimin e SKTK, nuk kanë qenë efektive në realizimin e detyrave, pasi nuk kanë hartuar planin e veprimeve për realizimin e objektivave strategjikë dhe për monitorimin e realizimit të saj.
- Sipas strukturave të larta të kësaj ministrie, në mungesë të një dokumenti strategjik prioritetet kryesore të punës së MK, janë realizuar nëpërmjet zbatimit të Programit për TK 2013-2017, në kuadër të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) që miratohet çdo vit. Dokumenti i PBA-së paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të MK dhe mundëson realizimin afatmesëm, për periudha 4 mujore, 8 mujore dhe vjetore, përkatesisht në nivel programi, por nuk garanton realizimin e objektivave strategjikë të Ministrisë së Kulturës, e cila për këtë periudhë nuk ka patur një dokument të përfunduar.
- Funksionimi i njëkohshëm i dy ligjeve, mungesa e akteve nënligjore, mosfunksionimi i organeve kolegiale vendimmarrëse, mbivendosja e kompetencave, bashkërendimi i ulët midis institucioneve qendrore dhe vendore, mosakordimi për sa i takon aspektave të fushës së kompetencës të institucioneve të tjera me Ministrinë e Kulturës pasi palët kanë mbrojtur qëndrimin e tyre, vonesat në kthimin e përgjigjeve për marrje/dhënie mendimi mbi projektvendimet, kanë sjellë probleme në menaxhimin e siteve arkeologjike.⁵⁹.
- Miratimi i akteve nënligjore jashtë afateve ligjore të parashikuara (rregullore administrative e MK, statut dhe rregullore e IKTK, rregullore e KKTKM) si edhe mos miratimi ende i akteve të tjera nënligjore, mbi bazën e të cilave hartohen përshkrimet e funksioneve të punonjësve dhe stafit drejtues, specifikat e procedurave, rregullave, kërkesave, *kanë sjellë komunikim të dobët institucional, mungesë procedurash, pengesa në miratimin e projekteve të paraqitura, mbivendosje kompetencash dhe*

⁵⁹Përgjigje e pyetësorëve nga MK dhe intervistat me stafin dhe drejtuesit e NJAKPA.

mungesë transparency. Këto nuk i kanë shërbyer efektivitetit dhe vlerësimit të performancës së shërbimit të administratës së institucionit, si edhe të institucioneve të varësisë. Ndryshimi i roleve dhe përgjegjësive të strukturave, i pa përfaqësuar në aktet nënligjore dhe administrative përkatëse, gjatë periudhës objekt auditimi ka bërë që të ketë papërgjegjshmëri dhe komunikim institucional të dobët, gjë e cila **shfaqet në vonesat e hartimit të akteve**.

- Mosfunkcionimi i Bordit Kombëtar të Parqeve Arkeologjike si organ kolegjal vendimmarrës për NJAKPA, ka sjellë një menaxhim të dobët të siteve arkeologjike, përjashtojmë BKPA Butrint, si dhe mbivendosje kompetencash midis tij dhe KKMPK-së, si organe kolegiale vendimmarrëse.
- Ligji nr.27/2018, siç e pranojnë dhe vetë drejtuesit e MK, u miratua dhe doli si domosdoshmëri, shtruar nga kërkesat që sistemi i trashëgiminë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit, konservimit dhe restaurimit të tij, administrimit të fondeve të pasurisë kulturore, kontrollit dhe masat për ruajtjen e këtij fondi etj. Drejtoritë përgjegjëse për hartimin e politikave shtetërore për TK, në bashkëpunim me IKTK si pjesë dhe e grupeve të punës për hartimin e SKTK, nuk kanë qenë efektive në realizimin e detyrave, pasi nuk kanë hartuar përcaktuar prioritetet e zhvillimit të politikave lidhur me TK dhe mbi bazën e tyre të hartonin dhe miratonin kalendarin e punës së realizimit të akteve nënligjore.
- Bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut, Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, **në kuadrin e planeve të veta sektoriale**, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, **harton planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara**. Gjykuar në sa më sipër, **bazuar në pikën 4 të nenit 245**, për të zgjidhur sa më shpejt problematikat e shfaqura në menaxhimin e siteve arkeologjike, **Ministria e Kulturës duhet të propozojë dhe të miratojë Planin Kombëtar të Peizazhit, sa më shpejt të jetë e mundur.**

Për këtë rekomandojmë:

- Ministria e Kulturës dhe strukturat përgjegjëse, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojnë planin e veprimit të realizimit dhe raportimit të realizimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Grupi i punës dhe DPPZHK të caktojnë dhe të miratojnë kalendarin e punës, duke përcaktuar prioritetin e secilit akt, sipas fushës së kompetencës dhe afatin ligjor për nxjerrjen e tij.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës të rishikojë aktet nënligjore për funksionimin e BKPA-së dhe të dokumentojë veprimtarinë e tij për marrjen e vendimeve lidhur me sitet arkeologjike.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës bazuar në nenin 142 të Ligjit Nr. 27/2018 të hartojë planet e

menaxhimit të siteve arkeologjike.

Të fillojë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës të rishikojë dhe të rivlerësojë mënyrën e administrimit të NJAKPA-ve në bazë të rregulloreve të funksionimit dhe administrimit apo bordeve (si Butrinti), në mënyrë që të mos krijohet vakum ligjor dhe kaos në menaxhimin dhe funksionimin e tyre, deri në hartimin e planeve të menaxhimit për to.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Të rishikohen aktet nënligjore për organet kolegiale vendimmarrëse, lidhur me emërimin e titullarit të ministrisë, për të shmangur centralizimin e kompetencave dhe eleminimin e hierarkisë për vendimmarrje të natyrave të ndryshme, të cilat mund të pengojnë në realizimin e objektivave të institucionit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të nenit 47 të Ligjit Nr. 27/2018, të rishikojë VKM-në Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, lidhur me funksionin këshillues të KKTKM-së për termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës 4 të nenit 40 të Ligjit Nr. 27/2018, të miratojë Urdhrin për miratimin e rregullores për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike të tij.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës të rishikojë legjislacionin përkatës si dhe aktet nënligjore për të shmangur mbivendosjen e kompetencave për institucionet e specializuara dhe organet kolegiale vendimmarrëse.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës të vodosë bashkërendimin midis institucioneve qendrore, vendore dhe akordimin për sa i takon aspekteve të fushës së kompetencës, për të ndryshuar qëndrimin e tyre lidhur me menaxhimin e siteve arkeologjike.

Deri në fund të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës a) të nenit 264 të Ligjit Nr. 27/2018 **të nxjerrë komentarin dhe manualin e përkufizimeve**.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, të hartojë dhe të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave aktet nënligjore të sipërpërmendura.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, të miratojnë aktet nënligjore të sipërpërmendura.

Brenda vitit 2021

- Ministria e Kulturës, bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, **në kuadrin e planeve të veta sektoriale**, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, **të propozojë, të hartojë dhe të dërgojë për miratim**

në Këshillin e Ministrave Planin Kombëtar të Peizazhit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 27/2018, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara, për kontrollin e zonave të mbrojtura të sive arkeologjike si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të tij.

Deri në fund të vitit 2021

3.1.2 Sa efektive janë njësitë e administrimit dhe koordinimit të parqeve/siveve arkeologjike?

Trashëgimia Kulturore në Republikën e Shqipërisë, si një element i rëndësishëm në edukimin me qytetari demokratike dhe zhvillimin social, kulturor, ekonomik të vendit, mbrohet nga Shteti, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë⁶⁰ dhe Ligjin Nr. 27/2018⁶¹. Duke njojur rëndësinë ekonomike dhe kulturore të sistemit të siveve arkeologjike në Shqipëri, në vitin 2000, Qeveria Shqiptare me VKM-në Nr. 82/2000⁶² shpalli Zonën Arkeologjike të Butrintit si Park Arkeologjik Kombëtar në mbrojtje të shtetit. Sistemi i parqeve arkeologjike është miratuar me VKM Nr. 396, datë 31 Mars 2005⁶³, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”. Kjo rregullore përcaktoi rolet dhe rregullat e menaxhimit të siveve arkeologjike si dhe miratoi Bordin Kombëtar të Parqeve Arkeologjike si organ vendimarrës. Bordi Kombëtar i Parqeve Arkeologjike kryesohej nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Nga kjo rregullore u përashtua Butrinti, pasi rregullorja e administrimit të tij ishte miratuar me VKM-në Nr. 857, datë 19.12.2003⁶⁴, të ndryshuar. Ky bord do të shqyrtonë dhe miratonte strategjinë dhe politikat për zhvillim, mirëmbajtjen, koordinimin, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të Parkut Arkeologjik të Butrintit. Me VKM Nr. 693/2005⁶⁵ Parku Arkeologjik i Butrintit u shpall Park Kombëtar.

BKPA miratuar me VKM Nr. 396, datë 31 Mars 2005⁶⁶, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, kishte kompetencat e mëposhtme: a) hartonte, ekzaminonte dhe miratonte strategjitet e zhvillimit për të gjitha parqet arkeologjike. b) miratonte programe dhe projekte të paraqitura nga ZAKPA-të dhe specifikonte rrugët e bashkëpunimit me institucione të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerave të tjera natyrore dhe mjedisore. c) miratonte planet vjetore të parqeve arkeologjike d) i jepte përparsi procesit të dokumentimit të trashëgimisë kulturore dhe vendoste për destinacionin final të administrimit, mbrojtjes dhe ekspozimit të objekteve të lëvizshme të kulturës kombëtare me vlerë unikale në muzeumet kombëtare me qëllim garantimin e sigurisë⁶⁷. BKPA miratonte

⁶⁰ Neni 59, Kreu V, Kushtetuta e Shqipërisë .

⁶¹ Ligjin Nr. 27/2018⁶¹ “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

⁶² VKM Nr.82, datë 2 Mars 2000 “Mbi klasifikimin e Parkut Kombëtar Butrint si park Arkeologjik i Mbrotur nga Shteti”

⁶³ VKM Nr. 396, datë 31 Mars 2005⁶³, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”⁶³.

⁶⁴ VKM Nr. 857, datë 19 dhjetor 2003, “Mbi Miratimin e Rregullores së Funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit”.

⁶⁵ VKM Nr. 693, datë 10 Nëntor 2005 “Mbi Klasifikimin e Kompleksit të Butrintit si Park Kombëtar ”

⁶⁶ VKM Nr. 396, datë 31.3.2005, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.

⁶⁷ VKM Nr. 396, datë 31.03.2005.

buxhetin e NJAKPA-ve, si dhe shpërndarjen e të ardhurave që vijnë nga aktivitetet dhe administrimi i parqeve, mbështetur në raportimet zyrtare të paraqitura nga drejtorët e NJAKPA-ve.

Gjithashtu, në pikën 20 të Kreut V të VKM-së Nr. 396, datë 31.03.2005, të ndryshuar, citohet : **“Institucionet përfaqësuese në BKPA kontribuojnë financiarisht për zbatimin e projekteve në parqet arkeologjike”, që siç doli nga auditimi dhe siç u konfirmua nga takimet me drejtuesit e parqeve arkeologjike, nuk ka funksionuar gjatë kësaj periudhe.**

Me VKM-në Nr.163/2013⁶⁸ dhe më pas VKM-në Nr. 249/2014⁶⁹, u rishikuan kompetencat e bordit dhe strukturat e NJAKPA-ve(ish ZAKPA-të). Bazuar në VKM-në Nr. 249/2014, të ndryshuar, bordi do mbikëqyrte veprimtarinë e NJAKPA-ve dhe strukturave përkatëse pranë DRTK-ve. Për të rritur transparencën dhe menaxhimin e tij në mbledhjet e bordit do të merrnin pjesë dhe drejtorët e drejtoreve rajonale të kulturës kombëtare të Gjirokastrës, Shkodrës, Vlorës dhe drejtori i ZAKPA-së Apoloni dhe drejtori i ZAKPA Bylis, por pa të drejtë vote.

NJAKPA-të të cilat zhvillojnë funksionet e tyre brenda parqeve arkeologjike nëpërmjet bordit realizonin jo vetëm programet e zhvillimit e administrimit të tyre por dhe bashkëpunonin me të gjithë specialistët dhe institucionet e tjera qendrore dhe vendore, veçanërisht për zhvillimet në territoret brenda kufijve të tyre, duke krijuar kushte sa më të mira për vizitorët nëpërmjet një infrastrukturre bashkëkohore.

Me VKM-në Nr.163/2013⁷⁰ dhe më pas VKM-në Nr. 249/2014⁷¹, struktura përgjegjëse për administrimin e siteve arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq ishte Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë.

Në zbatim të VKM-ve të mësipërme parqet arkeologjike Apoloni dhe Bylis dhe Parku Kombëtar i Butrintit funksionin si struktura më vete me autonomi administrative, juridike dhe buxhetore. ZAKPA Apoloni ishte strukturë përgjegjëse e parkut dhe organika e saj ishte miratuar me Urdhrin Nr. 184/2014⁷². Gjithashtu dhe ZAKPA Bylis, ishte strukturë përgjegjëse e parkut, miratuar me Urdhrin Nr. 185/2014⁷³.

Drejtuesit e NJAKPA-ve dhe DRTK-së Vlorë nuk kishin asnje vendim të marrë nga BKPA dhe për më tepër nuk ishin në dijeni për ekzistencën e tij qoftë dhe në shkresa zyrtare. Gjatë periudhës objekt auditimi, miratimi i buxhetit dhe shpërndarja e të ardhurave që vijnë nga aktivitetet dhe administrimi i parqeve, në NJAKPA-të , në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi është kryer pa miratimin e bordit si organ vendimmarrës, pasi ky i fundit ka qenë inekzistent. Në përgjigjet e marra nëpërmjet pyetësorëve nga Ministria e Kulturës si dhe në takimet me drejtuesit e siteve arkeologjike, problematikat që lidhen me sitet nuk janë bërë

⁶⁸ VKM Nr. 163, datë 27.02.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave,

⁶⁹ VKM Nr. 249, datë 30.4.2014 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, ”Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar

⁷⁰ VKM Nr. 163, datë 27.02.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave,

⁷¹ VKM Nr. 249, datë 30.4.2014 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, ”Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.

⁷² Urdhër Nr. 184, dt. 23.06.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZARPA Apolloni”⁷²

⁷³ Urdhër Nr. 185, dt. 23.06.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZARPA Bylis”.

present te bordi, sipas VKM-së së sipërpermendur, por në ministri, referuar problematikave të paraqitura:

- Çështje dhe problematika të natyrës teknike adresohen në IKTK dhe DRTK që kanë përgjegjësi administrimi në territorin ku ndodhen parqet dhe në koordinim me Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Kulturës.
- Çështje administrative adresohen pranë Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.
- Çështje financiare adresohen pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

NJAKPA-të, në mungesë të bordit si organ vendimmarrës për menaxhimin e sive arkeologjike, nuk kanë vendosur dhe realizuar një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit me qëllim përdorimin e fondeve publike *me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, nuk i kanë kushtuar vëmendje realizimit të shpenzimeve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave si dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, nuk kanë hartuar plane strategjike për minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përm bushjen e objektivave të institucionit, bazuar në planet strategjikë të Ministrisë së Kulturës*⁷⁴. Mungesa e bordit ka bërë që të ketë mungesë transparence në vendimmarjen e vendimeve të tyre, anashkalim kompetencash, komunikim ndërinstitucional të dobët midis institacioneve që lidhen me sitet.

BKPK dhe ZAKPK Butrint, rregullorja e të cilit është miratuar me VKM Nr. 857, datë 19.12.2003⁷⁵ “Rregullorja e funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint”, të ndryshuar, janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e programit vjetor në PK të Butrintit, në bashkëpunim me IKTK-në, sipas politikave dhe objektivave të zhvillimit. Për *BKPK Butrint mund të themi se ka qenë funksional në vendimmarje*, vendimet e të cilit na u vunë në dispozicion, *por dhe ky bord nuk ka qenë në eficencë të plotë përsa i takon menaxhimit të parkut.*

Nga strukturat drejtuese në Ministrinë e Kulturës⁷⁶ konfirmohet se, NJAKPK Butrint në formën aktuale të menaxhimit *nuk ka arritur të shfrytëzojë dhe shpenzojë të gjithë të ardhurat e siguruara dhe akumuluara nga shërbimet që ofron*, si pasojë e, *kushtëzimeve të diktuar nga mosrealizimi i procedurave të prokurimit* për përbushjen e të gjithë nevojave për funksionimin e institucionit dhe menaxhimin e sitit, *kapacitetet e profesionale dhe menaxheriale të kufizuara të stafit përfshirë* këtu aftësitë për tērheqjen e financimeve të qëndrueshme nga donatorë të mundshëm, *mbivendosjes së legjislacionit (VKM të miratuara në periudhën 1998 – 2014)* dhe *kompetencave të institacioneve të ndryshme qendrore dhe vendore duke krijuar paqartësi në mënyrën e menaxhimit të Parkut, mungesës së akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018*⁷⁷.

Nga konstatimet e grupit të auditimit, takimet me drejtuesit, përgjigjet e pyetësorëve dhe siç konfirmohet në raportet e Ministrisë së Kulturës, gjatë periudhës objekt auditimi, në PK Butrint kemi një *mosmenaxhim me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve*. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një dokumenti strategjik të Ministrisë së Kulturës si dhe akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018, pasi, *planet vjetore nuk kanë qenë të orientuara në bazë prioritetesh dhe projektesh sipas strukturës në “arkeologji-monumente të kulturës-mjedis-*

⁷⁴ Raportet e MK.

⁷⁵ VKM Nr.857, datë 19.12.2003⁷⁵ “Rregullorja e funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint”

⁷⁶ Përgjigjet e pyetësorëve.

⁷⁷ Ligji Nr. 27/2018 “Pë trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”.

turizëm”, ka munguar plani i menaxhimit të parkut, ka munguar bashkëpunimi me institucionet përfaqësuese të bordit për mbarëvajtjen e projekteve në park⁷⁸.

Pikërisht, kërkuesat dhe dobësitë që sistemi i trashëgimisë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit, administrimit, kontrollit dhe masave për ruajtjen e fondeve të pasurisë kulturore, nxorën domosdoshmérinë e hartimit të ligjit të ri⁷⁹ dhe nevojën e parashikimit të administrimit indirekt të PK Butrint etj.⁸⁰

Bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003⁸¹, të ndryshuar, i cili nuk kishte parashikime për hartimin e planeve të menaxhimit për pasuritë kulturore, sistemi i menaxhimit të parkut të Butrintit nuk ishte efektiv dhe nuk garantonte në perspektivë zhvillimin e integruar të tij si një park “Miks”. Meqenëse Ligji Nr. 27/2018⁸² përcakton format e menaxhimit të pasurive kulturore dhe mënyrat e administrimit të tyre, Ministria e Kulturës propozoi modelin e Planit të Menaxhimit të Integruar, i cili është ai i administrimit indirekt, përmes një fondacioni të dedikuar të bashkëthemeluar nga qeveria që përfaqësohet nga Ministria e Kulturës, me një partner strategjik. Krijimi i Fondacionit bazohet në, nenin 172 të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM-në Nr.625, datë 4.9.2019⁸³ “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit” dhe Udhëzimin Nr. 583, datë 14.10.2019⁸⁴ të ministrit të Kulturës “Për miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”.

Bazuar në pikën 2 të nenit 38 të Ligjit Nr. 27/2018 dhe VKM-në Nr. 208 datë 10.04.2019,⁸⁵ Ministria e Kulturës, me propozimin e vet, ka miratuar Vendimin Nr. 95, datë 7.04.2020 të KTKM-së “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit 2020-2030”, ndërkohë që ky organ, bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr. 27/2018, **ashtu si dhe KKMPK-ja** ka funksion këshillues pranë ministrit për termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive të paluajtshme. Në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të Ligjit Nr. 27/2018, VKM-ja Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme⁸⁶, **është miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara dhe rregullorja e KTKM-së nuk ishte miratuar akoma dhe kjo gjithashtu e miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara.**

Në këto kushte, si mund të raportohet nga Ministria e Kulturës gjithë procedura e bërë pa miratimin e VKM-së së mësipërme, për më tepër ky vendim për miratimin e PMI të Butrintit miratohet nga një i njëjtë organ kolegjial vendimmarrës, ku kryetare është ministrija.

⁷⁸ Raport Nr. 2936/ 7 prot. datë 13.08.2018.

⁷⁹ Raportimet gjatë periudhës objekt i auditimit (2016-2019)

<https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1Yv0M7MPPO3Hë>

⁸⁰ Përgjigjet e pyetësorëve të ardhura nga MK.

⁸¹ Ligji Nr. 9048/2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

⁸² Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

⁸³ VKM Nr.625, datë 4.9.2019⁸³ “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit”.

⁸⁴ Udhëzim Nr. 583, datë 14.10.2019⁸⁴ të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim”.

⁸⁵ VKM-në Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

⁸⁶ VKM Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.

Gjykuar në sa më sipër, pavarësisht se NJAKPA-të Apoloni, Bylis, Orikum, Amantia kanë patur organe vendimmarrëse si edhe Butrinti, nga Ministria e Kulturës janë ndjekur dy standarde për menaxhimin e tyre, ndërkokë që dhe bordi i PK të Butrintit nuk ka qenë efektiv. VKM-ja Nr. 208 datë 10.04.2019,⁸⁷ e cila ka dalë brenda afateve ligjore të parashikuara, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018, duhet të dilte brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij, ndërsa *Urdhri Nr. 223, datë 3.7.2020*,⁸⁸ i cili *nuk është miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara duhet të dilte brenda 6 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.* Rregullorja e veprimitarisë së këtij organi kolegjial vendimmarrës, nuk mund të dilte përpëra daljes së aktit.

KKTKM-ja bazuar në VKM-në Nr. 208, datë 10.04.2019, duhet të ishte në veprim dhe vendimet pas kësaj date duhet të merreshin prej tij. Në informacionin e vënë në dispozicion nga Ministria rezulton se dhe pas datës 10.04.2019, disa vendime janë miratuar nga KKR-ja⁸⁹ dhe KKA-ja⁹⁰, dhe procedurat nuk janë kryer sipas rregullores së veprimitarisë së KKTKM-së, pasi kjo nuk ishte miratuar ende. *Ky proces nuk është kryer konform legjislacionit në fuqi dhe ka mbivendosje kompetencash midis organeve kolegiale vendimmarrëse. Gjykuar në sa më sipër, ka një mbivendosje kompetencash midis KKTKM-së, KKR-së dhe KKA-së. Pra në miratimin e vendimeve të organeve kolegiale ndiqen dy standarde, ndërsa PMI të Butrintit miratohet nga KKTKM-ja, edhe pse rregullorja e tij nuk ishte miratuar në atë kohë, disa projekte restauruese dhe arkeologjike në parqet janë miratuar nga KKR-ja dhe KKA-ja.*

Në VKM-në Nr. 279, dt. 02.05.2019⁹¹ shprehet funksioni këshillues i KKMPK-së për miratimin e termave të referencës dhe planeve të menaxhimit dhe kompetencat e tij.

KKMPK ka për kompetencë, miratimin e strategjisë për administrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore, miratimin e programit të zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore, konsultimin e ministrit për trashëgiminë kulturore për tipologjinë e aktiviteteve tregtare që zhvillohen në ambientet e pasurive kulturore dhe në zonat e mbrojtura, miratimin e kritereve për licencimin e subjekteve tregtare të dedikuara në fushën e promovimit e të prezantimit të vlerave kulturore, hartimin, miratimin, dhe propozimin te ministri të marrëveshjeve të partneritetit publik privat në lidhje me pasuritë kulturore etj. *Mos miratimi i rregullores për veprimitarinë e KKMPK-së ka sjellë mbivendosje kompetencash të BKPA-së dhe KKMPK-së në menaxhimin e sítave.*

Gjatë periudhës objekt auditimi 2016-2019, Ministria e Kulturës, BKPA/BKPA Butrint, DPPSTK/DPPZHK⁹² kanë qenë përgjegjësit kryesor për hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave shtetërore në fushën e TK.

Në kushtet e mungesës së një strategjie kombëtare për trashëgiminë kulturore, pa objektiva strategjikë dhe plane konkrete veprimi, objektivat mbi të cilat janë ndërtuar veprimitaritë e

⁸⁷ VKM Nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

⁸⁸ Urdhër Nr. 223, datë 3.7.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimitarinë e KKTKM, Këshillit Teknik, të sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj”.

⁸⁹ Vendim KKR Nr. 228, datë 05.07.2019.

Vendim KKR Nr. 257, datë 23.07.2019.

Vendim KKR Nr. 326, datë 10.10.2019.

Vendim KKR Nr. 363, datë 01.11.2019.

⁹⁰ Vendim KKA Nr. 237 datë 31.10.2019 “Relacion verifikimi - gjetje arkeologjike rastësore, Gjorm, Vlorë”.

Vendim KKA Nr. 180 datë 31.07.2019 “Plotësim me ambiente shërbimi në lokalini “Leon Ray”, Apoloni”.

Vendim KKA Nr.137 datë 28.05.2019 “Projekt për ndërhyrje rehabilituese në parkun arkeologjik të Amantias”.

⁹¹ VKM Nr. 279, dt. 02.05.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të KKMPK”.

⁹² Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës.

parqeve arkeologjike kanë qenë në përputhje me Programin në fushën e Trashëgimisë Kulturore 2013 – 2017⁹³, zbatimi i të cilit është bërë në kuadër të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) me plane të bazuara në hartën e nevojave dhe mundësive, referuar kërkesave të vetë NJAKPA-ve, të cilat i dërgojnë në DPPZHK çdo fillim viti.

Detyrat e parashtruara në Programin e Trashëgimisë Kulturore 2013-2017 lidhur me PA, si: *rishikimi i hierarkisë së institucioneve qendrore dhe këshillave kombëtare që ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe riorganizimi i të gjitha procedurave të vendimmarrjes së tyre, ndërtimi i një strategie të re koordinimi dhe monitorimi të projekteve me donatorët në parqet arkeologjike, zhvillimi i partneriteve PP për ritetimin kulturor e social të tyre, duke garantuar transparencë, monitorim, mbrojtje e restaurim të qendrave të trashëgimisë kulturore⁹⁴, nuk janë realizuar plotësisht. Për sa më sipër mund të themi se:*

-Hierarkia e institucioneve qendrore dhe këshillave kombëtare që ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe procedurat e vendimmarrjes së tyre për sitet arkeologjike, nuk funksionojnë siç duhet, pasi bordi nuk ka ekzistuar dhe miratimet në NJAKPA-të janë kryer vetëm nga KKR-ja⁹⁵ dhe KKA-ja⁹⁶, për projekte teknike por pa miratim buxheti nga bordi. Ka një mbivendosje kompetencash në procedurat e vendimmarrjes dhe nuk respektohet hierarkia e institucioneve qendrore brenda sistemit të trashëgimisë kulturore.

Në raportin e mbajtur në Komisionin parlamentar nga strukturat drejtuese të MK⁹⁷ është theksuar domosdoshmëria e vendosjes së rregullave të qarta të lojës së raportimit e të komunikimit të përditshëm mes drejtorive të përmbajtjes në Ministri - Drejtorive Rajonale - IMK - ASHA-s- Institutit të Arkeologjisë si dhe të institucioneve të tjera të specializuara jashtë strukturave të varësisë por pjesë të sektorit të trashëgimisë kulturore. Në raport citohet: "Nga analiza e kryer deri tani shihet qartë se ka një kakofoni dhe mbivendosje kompetencash që shpesh ka ardhur jo aq prej paqartësisë së ligjit kryesor por për shkak të mungesës së vullnetit, të neglizhencave individuale, të një përqëndrimi të tejskajshëm të kompetencave në njëren dorë, të VKM-ve kundërproduktive si dhe të mungesës së koordinimit nga ana e Ministrisë. Ligji Nr. 9048/2003, i ndryshuar, duhet të bëjë një përcaktim shumë më të qartë të kompetencave dhe përgjegjësive të institucioneve të sistemit të TK"⁹⁸. Në vendimet e BPKP të Butrintit të vëna në dispozicion, për periudhën 2016-2019, ka mbivendosje kompetencash për shkak të mosrishikimit të hierarkisë së organeve vendimmarrëse⁹⁹. *Për të shkuar më tej, ministrja është kryetare dhe në këtë bord, si organ vendimmarrës.*

Në procesverbalet e mbledhjeve të BPKP Butrint vihet re se tendenca e ndryshimit të konceptit të parkut si një park "Miks" ka shfaqur dhe do të shfaqë problematika në miratimin e vendimmarrjeve jo vetëm nga institucionet shtetërore pjesë e bordit, por edhe nga institucionet që s'kanë përfaqësues në bord por ndikojnë në vendimmarrje, për shkak të legjislacionit gjithëpërfshirës si, NVQV, ARSH, etj.

- Nuk është ndërtuar një strategji koordinimi dhe monitorimi e projekteve me donatorët në parqet arkeologjike. Grupi i auditimit konstatoi se¹⁰⁰, për periudhën objekt auditimi, për sa i

⁹³ Programi i Trashëgimisë Kulturore 2013-2017 (Website i MK).

⁹⁴ Programi i Trashëgimisë Kulturore 2013-2017.

⁹⁵ Urdhër Nr. 456, datë 15.10.2003 i Ministrit të Kulturës, të ndryshuar.

⁹⁶ VKM Nr.724, datë 21.05.2008 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik", të ndryshuar.

⁹⁷ https://translate.google.com//kultura.gov.al/wpcontent/uploads/2017/12/Raport_në_komis_parlm.doc.

⁹⁸ https://translate.google.com//kultura.gov.al/wpcontent/uploads/2017/12/Raport_në_komis_parlm.doc.

⁹⁹ Vendim Nr. 4, datë 28.01.2016, Vendim Nr. 5, datë 24.02.2017, pikë 4 dhe 5, mbi miratimin e projekteve.

¹⁰⁰ Përgjigjet e pyetësorëve të MK.

përket bashkëpunimit me donatorë/partnerë, Ministria e Kulturës është fokusuar në ruajtjen e marrëdhënieve dhe avancimin e bashkëpunimit me asistencë të partnerëve për hartimin e akteve, por nuk na është vënë në dispozicion ndonjë dokument strategjik për projektet me donatorët dhe as ndonjë studim i kryer për mbështetje nga ta. I vetmi projekt është ai me fondet IPA nga BE në parkun e Apolonisë.

-Nuk janë zhvilluar partneritete për rjetësimin kulturor e social të tyre, duke garantuar transparencë, monitorim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore, pasi bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003¹⁰¹, të ndryshuar, raporti i partneritetit shtet privat si edhe kompetencat në pronësi dhe administrim të pronave që janë vlerë e TK, kanë qenë shumë të paqarta, gjë e cila ka çuar në mungesë bashkëpunimi të të dy palëve në mirëmbajtjen e objekteve të pasurive të paluajtshme, shfrytëzimin e monumenteve të kulturës ndërmjet rjetëzimit, dhe si pasojë dëmtimin e objekteve, etj.¹⁰² Ministria e Kulturës duhet të kishte rishikuar në vite bazën ligjore në këtë pikë lidhur me PP, për të garantuar ruajtjen e pasurive kulturore, për një menaxhim më të mirë të tyre, të integruar në realitetin shqiptar, por pasi të kishte kryer studime dhe analiza për një efektivitet më të lartë, gjë e cila nuk na u përmend në përgjigjet e pyetësorëve.


-Përmirësimi i kuadrit ligjor për sitet arkeologjike është realizuar pjesërisht, pasi siç theksuan ato funksionojnë me VKM-në Nr. 396/2005¹⁰³, të ndryshuar, të cilat duhet të ishin rishikuar bazuar në ndryshimet ligjore përkatëse në vite. Rishikimi i zonifikimit dhe rregulloreve ekzistuese ka qenë dhe një ndër detyrat e Programit të Trashëgimisë Kulturore 2013-2017. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, DPPSTK/DPPZHK në bashkëpunim me IMK-në, ASHA dhe DRKK-të si dhe me drejtorinë juridike në MK, ndër të tjera kanë patur detyrë dhe rishikimin e zonifikimit dhe rregulloreve ekzistuese¹⁰⁴. Përmirësimi i kuadrit ligjor u realizua vetëm me miratimin e Ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore, dhe muzetë”, por duhet të theksojmë se dhe me miratimin e ligjit të ri, kuadri rregulator nuk është i plotë për sitet arkeologjike, pasi shumë akte nënligjore nuk janë miratuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 u realizua dhe riorganizimi i strukturave organizative të NJAKPA-ve dhe DRTK-ve.¹⁰⁵

❖ NJAKPA Apoloni dhe Bylis (ish –ZAKPA Apoloni dhe Bylis).

Bazuar në Urdhrin nr. 132, dt. 21.10.2019 të Kryeministratit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZAKPA Apoloni & Bylis”, sitet arkeologjike të Apolonisë dhe të Bylisit, strukturë përgjegjëse kanë NJAKPA Apoloni dhe Bylis, sipas skemës së mëposhtme:

Skema 6: NJAKPA Apoloni dhe Bylis (ish –ZAKPA Apoloni dhe Bylis).



¹⁰¹ Ligji Nr. 9048/ 2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

¹⁰² Konfirmuar nga drejtuesit e MK në përgjigjet e pyetësorëve.


¹⁰³ VKM Nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit” i azhornuar me: vkm nr.163, datë 27.02.2013, vkm nr.249, datë 30.04.2014.

¹⁰⁴ Raportimet gjatë periudhës objekt i auditimit (2016-2019).

<https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1Yv0M7MPPO3Hë>.

¹⁰⁵ Raportimet dhe përgjigjet e pyetësorëve gjatë periudhës objekt i auditimit (2016-2019).


<https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1Yv0M7MPPO3Hë>.



Burimi: Ministria e Kulturës.

- ❖ NJAKPK Butrint (ish-ZAKPAK Butrint), bazuar në urdhrin nr. 186, dt. 04.07.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZARPA Butrint”, ka strukturën sipas skemës së mëposhtme:


Skema 7: NJAKPK Butrint (ish-ZAKPK Butrint)



Burimi: Ministria e Kulturës.

- ❖ **Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), Vlorë**, bazuar në VKM nr. 581, datë 28.08.2019¹⁰⁶, ushtron veprimtarinë në dy qarqet Vlorë dhe Fier dhe ka në varësi dy site arkeologjike, Amantia dhe Orikum, si edhe sektorin e Fierit. Struktura e kësaj drejtorie, miratuar me Urdhrin Nr. 139/2019¹⁰⁷ është sipas skemës së mëposhtme:

Skema 8: Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë



Burimi: Ministria e Kulturës.

Reformat strukturore në Ministrinë e Kulturës kanë sjellë ndryshimin e titullarëve të NJAKPA-ve dhe DRTK-ve dhe emërimi i përkohshëm i tyre¹⁰⁸, është kryer *jo sipas procedurave të*

¹⁰⁶ VKM Nr. 581, datë 28.08.2019¹⁰⁶ “Për funksionimin dhe Mënyrën e Zhvilit të veprimitarisë së Drejtorive Rajonale Të Trashëgimisë Kulturore”.

¹⁰⁷ Urdhër Nr. 139, dt. 21.10.2019 “ Për miratimin e strukturës dhe organikës së DRTK”.

¹⁰⁸ Shkresa përcjellëse Nr. 8121prot, datë 15.11.2017, Urdhër Nr. 798, datë 15.11.2017 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”. DRKK Vlorë.

përcaktuara në VKM nr. 173, datë 07.03.2003 të KM “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të KM, Kryeministrat ose të Ministrit”, të ndryshuar.

Nga drejtuesit e Ministrisë së Kulturës riorganizimi i strukturave doli si një domosdoshmëri e shtruar nga kërkësat që sistemi i trashëgimisë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit, konservimit dhe restaurimit të tij, administrimit, kontrollit dhe masave për ruajtjen të fondeve të pasurisë kulturore, *por kjo e pa shoqëruar me analiza konkrete apo studime për mënyrat e reja të administrimit dhe menaxhimit të parqeve*. Struktura organizative e ZAKPA Apoloni dhe ZAKPA Bylis, u riorganizuan në një strukturë të vetme *për shkak të numrit të vogël të punonjësve të ZAKPA Bylis*). *Funksionet financiare të kësaj zyre mbuloheshin nga ZAKPA Apoloni*, gjë që sillte pengesa të vazhdueshme administrative, financiare si dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore. Gjithashtu, sektori i Fierit kaloi në varësi të DRTK-së Vlorë, por *kjo e pashpjeguar me ndonjë analizë konkrete*. Gjatë periudhës objekt auditimi, nga konstatimet e dhe raportet e vëna në dispozicion nga Ministria e Kulturës¹⁰⁹, për ZAKPA-në Bylis, organizimi dhe funksionimi i brendshëm nuk ka qenë i plotë, baza ligjore me të cilën zhvillonte aktivitetet nuk kishte reflektuar ndryshimet ligjore të bëra në vite, etj¹¹⁰. Me ndryshimin e strukturës së organizimit, NJAKPA Bylis, ka kaluar në varësi të NJAKPA-së Apoloni.

NJAKPA-ja Apoloni ka rregullore të organizimit dhe funksionimit të brendshëm, por siç na u konfirmua nga drejtoresha dhe nga përgjigjet e pyetësorëve, ato janë në proces rishikimi. Me miratimin e rregulloreve nga Ministria e Kulturës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë NJAKPA-së Apoloni duhet të rishikojë për çdo punonjës dosjet, që të jenë të plotësuara me dokumentacionin përkatës, konform pikës 3 të VKM Nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendorr të personelit”.¹¹¹

Ndryshimi i strukturave administrative për NJAKPA-në Apoloni dhe Bylis, siç u konfirmua nga drejtuesit e parkut, ka patur një “përfitim”, nëse mund ta quajmë të tillë, sepse ka kursyer fondet, por nuk ka ndihmuar shumë në proceset brenda sitit. Sipas grupit të auditimit ky ndryshim nuk është bërë bazuar në analiza dhe studime konkrete me synim rritjen e efektivitetit të institucionit. Ndërkohë që thuhet se kursehen fonde duke reduktuar staf, por shpenzimet më të mëdha në buxhetin e NJAKPA-së kryhen për karburant dhe roje. *Strukturat e NJAKPA Apoloni dhe Bylis për shkak të numrit të vogël të punonjësve, nuk mund të realizojnë konform legjisacionit në fuqi veprimtarinë e tyre, nuk mbulojnë të gjitha funksionet e parashikuara për të përbushur realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucioneve dhe sipas kërkësave ligjore të funksionimit. Kjo ka bërë që të ketë mbivendosje të detyrave funksionale, pozicione të dubluara, pamundësi në realizimin në kohë të proceseve, si dhe angazhime personale për kryerjen e shërbimeve në sitet arkeologjike*. Drejtuesit e siteve u shprehën që struktura dhe organigrama duhet të ishin më shumë në përputhje me *nevojat për aftësi profesionale specifike* dhe jo administrative, për shkak të natyrës specifike dhe kushteve në të cilat ndodhen sitet.

NJAKPK Butrint ka rregullore të brendshme administrative, por siç na u theksua nga strukturat e Ministrisë së Kulturës rregulloret janë në proces rishikimi pranë saj. Nga drejtuesit e NJAKPK Butrint, na u konfirmua se *strukturat e NJAKPK Butrint për shkak të numrit të vogël të punonjësve, nuk mund të mbulojnë të gjitha funksionet e parashikuara për të përbushur*

¹⁰⁹Raportet e MK (2016-2019) <https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1Yv0M7MPPO3Hë>

¹¹⁰Raport i MK Nr. 2843/4 prot, datë 20.09.2016

¹¹¹Raport i MK Nr. 6172/9 prot, datë 06.02.2018

realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkesave ligjore të funksionimit, në kundërshtim me VKM nr. 893, dt. 17.12.2014¹¹². Siç u konfirmua dhe nga stafi drejtues i NJAKPK-së Butrint struktura duhet të kishte më shumë punonjës. Në raportet e vëna në dispozicion nga Ministria e Kulturës, vihet re se struktura jo e plotë, stafi i kufizuar dhe i pamjaftueshëm ka bërë mbivendosje të detyrave funksionale, pozicione të dubluara, përshkrime të pozicioneve të punës jo të plota, si dhe mosfunkcionim të sistemit të kontrollit të brendshëm si një proces i vazhdueshëm në zbatim të ligjshmërisë dhe akteve nënligjore në fuqi në procedurat e punës së tyre¹¹³. Në vendimet e BKPA Butrint, të vëna në dispozicion nga MK, në asnjë nga takimet nuk është marrë në shqyrtim struktura dhe efektiviteti i saj në realizimin e objektivave të institucionit.

DRTK Vlorë vazhdon të ushtrojë funksionet në mbështetje të statutit të miratuar me Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar. Drejtoria e institucionit ka përgatitur statutin e ri, bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 dhe e ka dërguar për miratim në ministri. Titullari i DRTK Vlorë ka miratuar rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm dhe në raportet dhe analizat vjetore për periudhën objekt auditimi shpreh mendimin *se struktura është jo shumë e përshtatshme*, duhen më shumë punonjës mirëmbajtje. *Për shkak të numrit të vogël të punonjësve, nuk mund të mbulohen të gjitha funksionet e parashikuara për të përbushur realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkesave ligjore të funksionimit*. Pavarësisht punës së vazhdueshme në mirëmbajtje të DRTK-së Vlorë, nevoja për ndërhyrje është mbi kapacitetin e institucionit për t'ju përgjigjur në kohë dhe në çdo monument. Kjo për arsyen e numrit jo të vogël të objekteve dhe shpërndarjes së madhe gjeografike që kanë, si edhe, për shkak të kapaciteteve njerëzore po ashtu dhe financiare të pamjaftueshme¹¹⁴.

Mungesa e një dokumenti strategjik në ministri me plane veprimi konkrete, mospërmirësimi i kuadrit ligjor, *ka sjellë mungesën e planeve strategjike afatmesëm dhe vjetore në NJAKPA, ku të përcaktohen objektivat kryesore dhe të hartohet plani i veprimeve për arritjen e objektivave*¹¹⁵, bazuar në plane strategjike, për minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përbushjen dhe realizimin e tyre. Nga drejtuesit e NJAKPA-ve dhe DRTK-së Vlorë, na u vunë në dispozicion planet dhe analizat vjetore, por të pa orientuara në plane strategjikë dhe të pa miratuara nga Bordi, në kundërshtim me VKM-në Nr. 249/2014¹¹⁶, pasi dhe strategjia e Ministrisë së Kulturës është e miratuar pa plane veprimi dhe afate kohore të parashikuara në realizimin e tij.

Sitet arkeologjike vuajnë nga centralizimi dhe burokracitë e qeverisjes qendrore në sektorët e ekonomisë, bujqësisë, mjedisit, arsimi ose institucione të tjera që merren me to, të cilat janë pengesë për menaxhimin e tyre dhe vendimmarrjen në kohën e duhur. Në NJAKPA-të ka një mbivendosje kompetencash midis institacioneve publike shtetërore e cila ka sjellë, vonesa në

¹¹² VKM nr. 893, dt. 17.12.2014 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institacioneve të administratës publike”

¹¹³ Raport MK Nr. 2936/ 7 datë 13.08.2018. për PK Butrint.

¹¹⁴ Raport/ analiza DRTK Vlorë.

¹¹⁵ Raport MK Nr. 6172/9 prot, datë 06.02.2018 “Dërgohet reporti final mbi auditimin e ushtruar në ZAKPKApoloni”.

¹¹⁶ VKM Nr. 249/2014¹¹⁶ “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonës, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar,

kthimin e përgjigjeve për vendimmarje dhe marrie/dhënie mendimi mbi aktet nënligjore, mos akordime lidhur me aspekte të fushës së kompetencës midis Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera ku ndërthuren fushat e kompetencës, etj. *Grupi konstatoi se bashkëpunimi me institucionet e tjera qendrore nuk ka qenë gjithmonë i lehtë, pasi ka pasur pika të cilat palët i kanë mbrojtur dhe nuk kanë dashur të ndryshojnë qëndrimin e tyre. Kjo vjen sepse Ligji Nr. 9048/2003, i ndryshuar ka qenë i paqartë dhe jo në harmoni me ligjet kombëtare të tjera në fuqi, si me atë të Buxhetit, Planifikimit të Territorit, Turizmit, Arsimit, Mbrotjes, etj.*¹¹⁷

Ka një konflikt aktual mes rregulloreve të zonave të mbrojtura arkeologjike dhe disiplinës urbane, ku kjo e fundit është kompetencë e NJQV-ve. Megjithëse në Ligjin Nr. 9048/2003 u vendosën disa rregulla që kishin të bënин me mbrojtjen e territorit nga ndërtimet pa leje, *paqartësitë në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pushtetit vendor lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së territorit të tyre si edhe mos harmonia me ligjet e tjera,* ka bërë që ky problem të jetë prezent dhe sot, pasi *nuk ka patur një trajtim në themel të problematikës ligjore, por vetëm institucional ndërmjet NJAKPA-ve dhe NJQV apo Njësive Administrative.* Komunikimi është realizuar nëpërmjet korrespondencës zyrtare përmes informimit të Ministrisë së Kulturës dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrotjes së Territorit, INUK, IKTK, etj. Gjithashtu Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është pjesë e BKPK të Butrintit në të cilin është ftuar të marrë pjesë edhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrotitura¹¹⁸.

Funksionimi njëkohësisht i dy rregulloreve në sitin arkeologjik Orlikum, rregullorja SOP1 miratuar nga Ministria e Mbrotjes dhe rregullorja miratuar me VKM-në nr. 396, datë 31.3.2005, të ndryshuar, ka patur probleme, por komunikimi është realizuar nëpërmjet korrespondencës zyrtare përmes informimit të Ministrisë së Kulturës.

Grupi i auditimit evidentoi *probleme lidhur me bizneset e ngritura brenda parqeve arkeologjike dhe me marrëdhëniet që ato kanë me operatorët privatë që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre*, dy restorante brenda Parkut Arkeologjik të Apolonisë (bar restorant “Leon Rey” dhe bar-restorant “Apolonia”, midis manastirit dhe murit të lashtë mbrojtës, pak metra nga hyrja kryesore e Parkut), një restorant në Bylis (restorant brenda Parkut Bylis) dhe në Butrint (restorant Livia brenda zonës së mbrojtur). Marrëdhëniet me të tretët në dhënien e ambienteve me qira dhe përdorimin e tyre, kryhen në bazë të Ligjit Nr. 9048/2003, me VKM-në Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe Udhëzimit Nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës për qëllim rijetëzimi”, i ndryshuar¹¹⁹. Lidhur me këto operatorë ka probleme pronësie, mungesë kontratasht, dosje të parregullta nga qiramarrësit, nuk kanë dokument mbi objektin, vlera shumë të ulëta të qirave, etj¹²⁰. Të gjitha parimet, ligjet dhe konventat kundërshtojnë restorantet në zonat arkeologjike. Aktiviteti i tyre është absolutisht i palejueshëm. Është shumë e rëndësishme që të dalë në pah siti arkeologjik dhe asnë objekt nuk mund të jetë mbi monumentet arkeologjike apo zonat brenda sitit arkeologjik me potencial arkeologjik të pazbuluar akoma apo në proces gërmimi dhe evidentimi, që ende s'janë nxjerrë nga toka. *Kjo veprimtari jo vetëm*

¹¹⁷ Përgjigjet e pyetësorëve të MK.

¹¹⁸ https://translate.google.com//kultura.gov.al/ëpcontent/uploads/2017/12/Raport_ne_komis_parlm.doc

¹¹⁹ Raport i MK nr. 6172/9 prot, datë 06.02.2018 për Apoloni, Raport i MK Nr. 2843/4 prot, datë 20.09.2016 për Bylis, Raport Nr. 2936/1 prot, datë 13.08.2018 për Butrintin.

¹²⁰ Intervista me drejtuesit e parqeve dhe në raportet e auditimit të MK.

është në kundërshtim me ligjin por përbën një risk të madh për këto site dhe rrezikon humbjen e vlerave te trashëgimisë kulturore që ato mbartin.

Ndërkokë, në kundërshtim me aktet nënligjore Ministria e Kulturës ka lejuar miratimin e Vendimit Nr. 180 datë 31.07.2019 të KKA-së për “Plotësim me ambiente shërbimi në lokalin Leon Ray, Apoloni”.

Sistemi i parqeve arkeologjike funksionon me *VKM Nr. 396, datë 31.3.2005, të ndryshuar. Brenda territoreve të parqeve arkeologjike e vetmja rregullore që duhet të kishte funksionuar duhet të ishte ajo e parkut.* Në të vërtetë, *parqet arkeologjike*, deri më sot, nuk kanë patur një rregullore të brendshme që të përmbajë në thelb mënyrën si do të menaxhohen marrëdhëniet brenda parkut, marrëdhëniet me pronarët e tokës, me vizitorët apo me entitetet publike dhe private sipas specifikës së zonës. Kjo gjë e ka vështirësuar dhe më shumë menaxhimin e tyre.

Bazuar në pikën 2 të nenit 142 të Ligjit Nr. 27/2018, NJAKPA-të do të zhvillojnë veprimtaritë e tyre bazuar në planet e menaxhimit dhe jo mbi rregulloret e administrimit. Mos hartimi i planeve të menaxhimit brenda afateve ligjore të parashikuara ka krijuar kaos në funksionimin dhe administrimin e siteve.

Për kontrollin e zonave të mbrojtura të siteve arkeologjike si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të Parkut, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse përmes mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, *harton planet kombëtar të peizazhit* në përpunje me dispozitat e ligjit të ri, *ligjit të planifikimit territorit dhe marrëveshjeve ndërkombe të trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara*. Gjykuar në sa më sipër, *bazuar në pikën 4 të nenit 245*, për të zgjidhur sa më shpejt problematikat e shfaqura në menaxhimin e siteve arkeologjike, *MK duhet të propozojë dhe të miratojë Planin Kombëtar të Peizazhit, sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithashtu, në zbatim të pikës 8 të nenit 30 të Ligjit Nr. 27/2018, IKTK-ja nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit në bashkëpunim me institucionë të vetëqeverisjes vendore, partnerë publikë e privatë, vendas dhe të huaj, mund të luajë rolë të madh në kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të Parkut. Për të shkuar më tej, MK duhet të hartojë menjëherë planet e menaxhimit të siteve arkeologjike, për të zgjidhur të gjitha problematikat me sitet dhe për të rregulluar funksionimin normal dhe me efektivitet të tyre.*

Nga auditimi rezulton se në NJAKPA-të, buxhetimi dhe programimi nuk janë hartuar në përpunje me nevojat financiare sipas prioriteteve strategjike të institucioneve, gjë e cila ka sjellë *pamjaftueshmrinë përfunksionimin normal të tyre*. Rregullimi i fondeve për sitet kryhet në kuadër të Projekt Buxhetit Afatmesëm ose gjatë vitit, ku Ministria e Kulturës paraqet kërkesat në Ministrinë përgjegjëse përmes Financave si dhe shqyrton të gjitha mundësitë që paraqiten gjatë vitit për rishpërndarje fondesh me qëllim përbushjen e nevojave të institucioneve. Mungesa e, *planeve të veprimit, analizave sipas nevojave, analizave sipas kostove financiare, burimeve njerëzore, pa lënë mënjanë edhe risqet që mbartin sitet në vettete* ka sjellë dhe mungesën e hartimit të planeve strategjikë afatmesëm dhe vjetor sipas nevojave, ku të përcaktohen objektivat kryesorë për investime strategjike afatgjata. Grupi konstatoi se fonda investimeve për vitet e fundit kanë qenë të përqëndruara në aktivitete të tjera të ministrisë të paparashikuara në një dokument strategjik¹²¹ të miratuar. NJAKPA-të nuk kanë hartuar strategjinë e menaxhimit të riskut. Nga NJAKPA nuk i është kushtuar vëmendje realizimit të shpenzimeve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave, gjë e cila ka bërë që performanca e këtyre institucioneve të jetë e ulët¹²².

¹²¹ Informacion nga drejtoria e financave.

¹²² Raportet e mësipërme.

Në kushtet e mungesës së dokumentit strategjik të ministrisë, ekzistencës së njëkohshme të dy ligjeve dhe mospërmirësimit të kuadrit ligjor për të një menaxhim efektiv të tyre dhe ai “pak” buxhet i parashikuar për NJAKPA-të rialokohej në vite, duke i lënë vend rastësisë së shfaqjes së problemeve në sitet. Vërtet risqet që sitet mbartin për shkak të veçorive të tyre duhen mbajtur parasysh, por dhe fondet e miratuara për to duhen planifikuar mbi analiza konkrete.

Mënyrat e menaxhimit të siteve nëpërmjet BKPA, DRTK-ve dhe NJAKPA nuk kanë rezultuar efektive, pasi vendosja e këtyre formave nuk është kryer mbi bazën e analizave dhe studimeve të kryera nga Ministria e Kulturës si dhe modelit më të mirë të integruar në kushtet shqiptare.

Gjetje:

- Gjatë periudhës objekt auditimi, në kundërshtim me VKM-në Nr. 396/2005, të ndryshuar, NJAKPA-të kanë funksionuar pa bord, me vendime të pamiratuara prej tij si organ vendimmarrës.
- *Hierarkia e institucioneve qendrore dhe këshillave kombëtare që ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe procedurat e vendimmarrjes së tyre për sitet arkeologjike, nuk funksionojnë siç duhet, pasi Bordi nuk ka ekzistuar dhe miratimet në NJAKPA-të për projekte teknike janë kryer vetëm nga KKR-ja¹²³ dhe KKA-ja¹²⁴, pa miratim buxheti nga bordi. Ka një mbivendosje kompetencash në procedurat e vendimmarrjes dhe mosrespektim të hierarkisë së institucioneve qendrore brenda sistemit të trashëgimisë kulturore.*
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të Ligjit Nr. 27/2018, VKM-ja Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”, nuk është miratuar brenda afateve ligjore të parashikuara.
- Në zbatim të shkronjës “c”, pika 3, të nenit 171, të Ligjit Nr. 27/2018, Ministria e Kulturës nuk ka miratuar VKM-në për “Përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore”.
- Grupi konstatoi se, bazuar në pikën 2 të nenit 38 të Ligjit Nr. 27/2018 dhe VKM-së Nr. 208 datë 10.04.2019¹²⁵ Ministria e Kulturës, me propozimin e vet, ka miratuar Vendimin Nr. 95, datë 7.04.2020 të KKTKM-së “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit 2020-2030”, ndërkohë që Urdhri Nr. 223, datë 3.7.2020¹²⁶, si edhe disa nga aktet nënligjore që lidhen me administrimin e siteve nuk ishin miratuar. Bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr. 27/2018, KKTKM-ja ka *funkcion këshillues lidhur me termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme. Nga MK raportohet gjithë procedura e bërë pa miratimin e VKM-së* në zbatim të shkronjës “c”, pika 3, e nenit 171, të Ligjit Nr. 27/2018.
- Gjatë periudhës objekt auditimi, Ministria e Kulturës, në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi ka ndjekur dy standarde për menaxhimin e siteve arkeologjike, gjë kjo e

¹²³ Urdhër Nr. 456, datë 15.10.2003 i Ministrit të Kulturës, të ndryshuar.

¹²⁴ VKM nr.724, datë 21.05.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik”, të ndryshuar.

¹²⁵ VKM Nr. 208 datë 10.04.2019.

¹²⁶ Urdhër Nr. 223, datë 3.7.2020¹²⁶ për “Miratimin e rregullores “Për veprimtarinë e KKTKM, Këshillit Teknik, të sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj”.

pashpjeguar dhe e justifikuar në përgjigjet e pyetësorëve, ndërkokë që dhe bordi i Butrintit nuk ka qenë efektiv.

- *Mungesa e dokumentit strategjik të Ministrisë*, kapacitetave profesionale dhe menaxheriale të kufizuara të stafeve të NJAKPA, përfshirë këtu aftësitë për tërheqjen e financimeve të qëndrueshme nga donatorë të mundshëm, **ka sjellë mungesën e strategjive të koordinimit dhe monitorimit të projekteve me donatorët në sitet arkeologjike si edhe mungesën e investimeve nga donatorët.**
- Miratimi i dokumentit strategjik me VKM-në Nr. 903, datë 24.12.2019¹²⁷ “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, pa plane veprimi konkrete si dhe kuadri rregullator jo i plotë për NJAKPA-të dhe DRTK-të, **ka sjellë mungesën e planeve strategjike afatmesëm dhe vjetore në to**, bazuar në plane strategjikë, për minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë realizimin e objektivave të institucionit.
- NJAKPA-të funksionojnë në bazë të rregulloreve të **Funksionimit dhe administrimit**, miratuar me VKM-në Nr. 396, datë 31.3.2005¹²⁸, të ndryshuar dhe jo të rishikuar sipas legjislacionit përkatës në vite.
- Strukturat e NJAKPA-ve kanë numër të vogël punonjësish dhe jo në përputhje me nevojat për aftësi profesionale specifike, gjykuar mbi natyrën specifike dhe kushtet në të cilat ndodhen sitet. Kjo ka sjellë mbivendosje të detyrave funksionale, pozicione të dubluara në staf, si edhe mos realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkeseve ligjore të funksionimit.
- NJAKPA-të kanë hartuar rregulloret e organizimit dhe funksionimit të brendshëm, por janë të pamiratuara, pasi janë në proces rishikimi në Ministrinë e Kulturës. Ky miratim kryhet në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi, pasi miratimi i rregulloreve është kompetencë e bordit dhe jo e ministrisë.
- Reformat strukturore kanë sjellë ndryshimin e titullarëve të NJAKPA-ve dhe DRTK-ve dhe në disa raste funksionon komandimi ose emërimi i përkohshëm i tyre. Komandimi ose emërimi i përkohshëm i titullarëve, jo sipas procedurave të përcaktuara në VKM Nr. 173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të KM, Kryeministrit ose të Ministrit”, të ndryshuar, ndikon në efektivitetin e institucionit.
- DRTK Vlorë gjatë periudhës objekt auditimi ka funksionuar me statutin dhe rregulloren bazuar në Ligjin Nr. 9048/2003, të ndryshuar. Bazuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 27/2018 Ministria e Kulturës nuk ka miratuar statutin e hartuar nga titullari i DRTK-së Vlorë. Ky statut është në proces rishikimi pranë ministrisë.
- Grupi konstatoi se, bashkëpunimi ndërinstitucional midis institucioneve qendrore, NJVQV-ve dhe institucioneve të tjera shtetërore, ka qenë i dobët, për shkak të paqartësive të Ligjit Nr. 9048/2003, të ndryshuar, mosrishikimit të akteve nënligjore në zbatim të tij, moskoherencës së tij me ligjet e tjera, si edhe mungesës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri. Kjo ka sjellë mosrespektim të hierarkisë së institucioneve qendrore që merren me sitet arkeologjike.

¹²⁷ VKM Nr. 903, datë 24.12.2019¹²⁷ “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”.

¹²⁸ VKM Nr. 396, datë 31.3.2005 “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të shkodrës, lezhës, apolonisë, bylisit, amantias, orikumit, antigonesë, finiqit dhe butrintit” *i azhornuar me: vkm nr.163, datë 27.02.2013, vkm nr.249, datë 30.04.2014.*

¹²⁸ VKM Nr. 249/2014¹²⁸ “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.

- Në kundërshtim të pikës dh) të nenit 267, të Ligjit Nr. 27/2018, nuk është miratuar VKM-ja në lidhje me përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin. (përjashtuar Butrintin si pasuri botërore dhe zonën mbrojtëse të tij).
- Në kundërshtim të pikës ll) të nenit 268, të Ligjit Nr. 27/2018, nuk është miratuar udhëzimi për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve.
- Në kundërshtim të pikës ç) të nenit 264 MK nuk ka nxjerrë “Udhëzim për rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore”.
- Ekziston konflikti aktual mes rregulloreve të zonave të mbrojtura arkeologjike dhe disiplinës urbane, ku kjo e fundit është kompetencë e NJVQV. Kjo vjen nga paqartësitë e ligjit të vjetër dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pushtetit vendor lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së territorit të tyre si edhe mos harmonia me ligjet e tjera. Ky problem nuk ka patur një trajtim në themel të problematikës ligjore, por vetëm institucional, korrespondence zyrtare ndërmjet MK-së, IKTK-së dhe institucioneve të tjera që lidhen me menaxhimin e siteve.¹²⁹

Konkluzione:

- Miratimi i një dokumenti strategjik jo të plotë për TK, mosfunkcionimi i bordit, në kundërshtim me VKM-në Nr. 396/2005, të ndryshuar, funksionimi i njëkohshëm i dy ligjeve, mungesa e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 kanë sjellë vonesa në vendimmarje, mbivendosje kompetencash midis organeve kolegiale dhe një menaxhim joefektiv.
- Si rezultat i, ***moskoherencës së Ligjit Nr. 9048/2003, të ndryshuar***, me një sërë ligjesh kombëtare të tjera në fuqi si me atë të, Buxhetit, Planifikimit të Territorit, Turizmit, NJVQV, ***mungesës së planeve të menaxhimit, politikat e ndjekura nga NJAKPA-të*** me, institucionet shtetërore, NJVQV-të dhe operatorët privatë të cilët ushtrojnë aktivitete brenda siteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe problemeve që ndeshen në sitet arkeologjike, ***kanë rezultuar joefektive***.
- Si rezultat i mungesës së bordit dhe akteve nënligjore në zbatim të ligjit, NJAKPA-të nuk kanë vendosur dhe realizuar një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim përdorimin e fondeve publike me efektivitet, eficiencë dhe ekonomi¹³⁰, nuk kanë hartuar plane strategjike për minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përbushjen e objektivave të institucionit.
- ***Mungesa e statutit dhe rregulloreve të brendshme të NJAKPA-ve dhe DRTK-ve***, mosmiratimi në kohë i tyre nga MK-ja, strukturat jo të plota, numri i vogël i punonjësve, mbivendosja e detyrave funksionale, pozicionet e dubluara në staf, etj, kanë bërë që NJAKPA-të të ***mos mbulojnë të gjitha funksionet e parashikuara*** në përbushje të realizimit të objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkësave ligjore të funksionimit.
- ***Buxheti dhe fondet e pamjaftueshme përfunksionimin normal të siteve***, rregullimi i

¹²⁹ https://translate.google.com//kultura.gov.al/epcontent/uploads/2017/12/Raport_ne_komis_parlm.doc

¹³⁰ Raportet e MK.

fondeve sipas PBA-së ose gjatë vitit, në mungesë të prioriteteve të MK-së për to, mosfunkcionimi i sistemit të kontrollit në NJAKPA-të, kanë ndikuar në mosefektivitetin e tyre. Pikërisht, mungesa e planeve të veprimit, analizave sipas nevojave, kostove financiare, burimeve njerëzore, pa lënë mënjanë edhe riskun që mbartin sitet në vetvete, ka sjellë dhe mungesën e një programimi dhe buxhetimi të plotë, dy shtylla të forta për një menaxhim efektiv të siteve. Mungesa e planeve strategjikë afatmesëm dhe vjetor, mungesa e strategjive të menaxhimit të riskut, kanë sjellë mungesë vëmendje në realizimin e shpenzimeve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave, gjë e cila ka bërë që performanca e këtyre institucioneve të jetë e ulët¹³¹. Aktualisht sot dhe ai pak buxhet i parashikuar për NJAKPA rialokohet në vite, duke i lënë vend rastësisë së shfaqjes së problemeve në sitet. Vërtet që risku që sitet mbartin për shkak të veçorive të tyre duhet mbajtur parasysh, por dhe fonde e miratuara për to duhen planifikuar mbi analiza konkrete.

Për këtë rekomandojmë:

- Ministria e Kulturës dhe NJAKPA-të të rishikojnë ekzistencën e bordeve dhe të bëjnë analizën e eficiencës së tyre në menaxhimin e siteve arkeologjike, për minimizimin e risqeve dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, të rishikojë legjislacionin aktual, për të saktësuar dhe rregulluar hierarkinë e institucioneve qendrore dhe të këshillave kombëtare që ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe procedurat e vendimmarrjes së tyre për sitet arkeologjike, për të shmangur mbivendosjen e kompetencave.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, BKPKB dhe NJAKPK Butrint të përshpejtojnë procedurat për zbatimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Butrintit (PMI).

Të fillojë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- NJAKPA-të, bazuar në nenin 142 të Ligjit Nr. 27/2018 dhe strukturat përkatëse në Ministrinë e Kulturës të bashkëpunojnë për hartimin dhe miratimin e planeve të menaxhimit të parqeve brenda territorit gjeografik të tyre, si një domosdoshmëri për administrimin, koordinimin dhe hartimin e planeve të zhvillimit, projekteve, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e tyre.

Të fillojë brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Kulturës dhe NJAKPA-të të bashkëpunojnë për hartimin e planit të veprimeve të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, me qëllim hartimin e planeve strategjike afatmesëm dhe vjetore të NJAKPA-ve bazuar në të, për minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë realizimin e tyre.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Emërimi i titullarit të DRTK-së Vlorë të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në VKM-në nr. 173, datë 07.03.2003 të KM “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të KM, Kryeministrit ose të Ministrit”, të ndryshuar.

¹³¹ Raportet e mësipërme.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 171, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartoje dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave VKM-në “Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore”.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës në bashkëpunim me NJAKPA-të dhe DRTK-të, bazuar në strategjinë e miratuar dhe me hartimin e menjëhershëm të planit të veprimit për realizimin e saj, të mundësojë hartimin e strategjive të koordinimit dhe monitorimit të projekteve me donatorët në sitet arkeologjike.

Brenda vitit 2021

- Ministria e Kulturës dhe NJAKPA-të deri në miratimin e strukturave të reja bazuar në Ligjin Nr. 27/2018, të bashkëpunojnë që strukturat ekzistuese të funksionojnë në përputhje me nevojat përfshirë profesionale, gjykuar mbi natyrën specifike dhe kushtet në të cilat ndodhen parqet, duke rivlerësuar numrin e nevojshëm të administratës përfshirë prioritet stafit teknik e mirëmbajtës, i cili aktualisht është i pamjaftueshëm dhe nuk arrin të përmblidhet, realizimin e objektivave sipas qëllimeve të institucionit dhe sipas kërkjesave ligjore të funksionimit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Bazuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 27/2018, Ministria e Kulturës të miratojë statutin e hartuar nga titullari i DRTK-së Vlorë.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- NJAKPA-të me miratimin e rregulloreve të tyre nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Kulturës të rishikojnë dosjet e personelit, bazuar në aktet e reja nënligjore në fuqi.

Brenda vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës 1, të nenit 142, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartoje dhe të dërgojë për miratim në KM vendimin përfshirë kufijtë e territorit gjeografik brenda të cilit ushtrojnë veprimtarinë e tyre NJAKPA-të.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës në bashkëpunim me NJAKPA-të dhe në zbatim të pikës 9, të nenit 142, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojnë dhe të dërgojnë për miratim në KM vendimin përfshirë strukturën dhe organikën e NJAKPA-ve.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në zbatim të pikës 1, të nenit 96, të Ligjit Nr. 27/2018, të hartoje dhe të dërgojë për miratim në KM vendimin në lidhje me përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës në zbatim të pikave 1 dhe 4, të nenit 102, të Ligjit Nr. 27/2018, të miratojë udhëzimin përfshirë kushtet dhe kriteret përfshirë ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Në zbatim të pikës 3 të nenit 12 të ligjit Ministria e Kulturës të nxjerrë udhëzimin përfshirë rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet e tjera të përshtatshme nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, për të shmangur konfliktin midis rregullores së zonave të mbrojtura arkeologjike dhe disiplinës urbane. Trajtimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre të realizohet me akte nënligjore konkrete dhe jo korrespondence të thjeshtë zyrtare.¹³²

Brenda vitit 2021

- Ministria e Kulturës, bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, të hartoë planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara, për kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut.

Brenda vitit 2021

- Ministria e Kulturës, NJAKPA-të në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, lidhur me bizneset e ngritura brenda parqeve arkeologjike dhe me marrëdhëniet që ato kanë me operatorët privatë që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre, të rishikojnë aktet nën ligjore bazuar mbi parimet, ligjet dhe konventat kombëtare dhe ndërkombëtare, për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore që sitet mbartin dhe kthimin e tyre në identitet.

Brenda vitit 2021

3.2 A janë zbatuar në mënyrë të përshtatshme politikat për ruajtjen dhe mbrojtjen e parqeve/siteve arkeologjike

3.2.1 A janë ndërmarrë masa efektive për mbrojtjen e parqeve/siteve arkeologjike?

Parqet arkeologjike në vetvete janë vende që dëshmojnë historinë e lashtësisë e cila kërcenohet vazhdimi i shkatërrimit të ardhura nga kombinimi i një sërë faktorësh natyrorë apo njerëzor si rritja e numrit të projekteve ndërtimore, faktorët mjedisorë si rrëshqitjet, përblytjet, lagështia, gërmimet e paligjshme dhe joshkencore, ndërgjegjësimi publik jo i mjaftueshëm etj. Nevoja për ti mbrojtur e ruajtur parqet arkeologjike dhe vlerën kulturore që përfaqësojnë duhet reflektuar në planifikimin urban dhe rural, si edhe në politikat e zhvillimit të kulturës me plane konkrete veprimi, duke patur si qëllim zvogëlimin e rrezikut të shkatërrimeve dhe rritjen e nivelit të konservimit dhe zbulimeve te reja. Ruajtja dhe studimi i rrënojave të parqeve arkeologjike ndihmon në rigjurmimin e historisë së njerëzimit dhe lidhjet e saj me mjedisin natyror. Mbrojtja dhe ruajtja e parqeve arkeologjike dhe trashëgimisë kulturore përfshijnë veprimtaritë që lidhen me administrimin e siteve, analizën e rrezikut dhe zhvillimin e kapaciteteve për gatishmërinë dhe planet e emergjencës, sigurinë, konservimin parandalues e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve, për të siguruar integritetin e tyre. Në vetvete ato përblyedhin një sërë masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit duke përfshirë të gjitha proceset e hulumtimit, studimit, kërkimit, dokumentimit, regjistrimit, parandalimit, mirëmbajtjes, konservimit, restaurimit përshtatjes dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore.

Komponenti i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore për periudhën objekt auditimi 2016-2019 vlerësohet i ndarë në dy periudha për shkak të ndryshimit të ligjit të trashëgimisë kulturore në vitin 2018 i cili u shoqërua dhe me ndryshime të legjislacionit, administrimit dhe kompetencave

¹³² https://translate.google.com//kultura.gov.al/epcontent/uploads/2017/12/Raport_ne_komis_parlm.doc

të strukturave në institucionet e specializuara përgjegjëse për këtë komponent dhe detyrat konkrete të tyre.

Ministria e Kulturës është institucioni kryesor përgjegjës për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin, konservimin, inventarizimin, katalogimin informatikë të vlerave të luajtshme dhe të paluajtshme të Trashëgiminë Kulturore. Nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetit Kulturor (DPPSTDK) dhe institucioneve në varësi ka qenë administratori shtetëror më i rëndësishëm, bazuar në ligjin për Trashëgiminë Kulturore. Pjesë e strukturës së kësaj drejtorie në Ministri, përpara vitit 2018, ka qenë edhe Drejtoria e Trashëgiminë, Kulturore, Materiale dhe Muzeve (DTKMM), përgjegjëse për ndjekjen e politikave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgiminë kulturore dhe monitorimin e punës dhe aktiviteteve të institucioneve si Institut i Monumenteve të Kulturës (IMK), Agjencisë se Shërbimeve Arkeologjike (ASHA) dhe Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK).

Funksioni parësor i Institutit të Monumenteve të Kulturës IMK, kishte të bënte me evidentimin, gjurmimin, studimin, konservimin, dhe restaurimin e veprave të artit dhe monumenteve të tjera të trashëgiminë kulturore. Funksion i institutit nuk udhëhiqej nga një parashikim rezultatesh që pritej të arrinte ky institut. Mungesa e një baze të dhënash të plota e të përditësuara për vendndodhjet dhe gjendjen e monumenteve të kulturës, si dhe zvarritja e procesit të pasaportizimit të tyre, bënte që ndërhyrjet në monumente të mos realizoheshin sipas nevojës.

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) ka qenë institucion qendor i krijuar për të ushtruar veprimitari në fushën e gërmimeve dhe të studimeve të trashëgiminë kulturore, që preket nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit. Ka qenë institucion i specializuar në gërmime arkeologjike të shpëtimit, sondazhe, vëzhgime sipërsaqësore arkeologjike dhe mbikëqyrje. ASHA kishte misionin e mbrojtjes së vlerave të trashëgiminë kulturore arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë. ASHA gjatë funksionimit të sajë nuk dispononte një strategji afatmesme apo afatgjatë. Mospasja e një strategjie të qartë dhe një plani veprimi ka bërë që ASHA të mos zhvillonte një politikë të strukturuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgiminë kulturore. Në periudhën përpara ristrukturimit me ligjin e ri, ASHA nuk ka marre masa të nevojshme për mbrojtjen e TA në procesin e planifikimit. Për sa më sipër ASHA nuk i ka arritur objektivat për të cilat ishte ngritur si institucion në drejtim të mbikëqyrjes arkeologjike për projektet e mëdha të infrastrukturës me qëllim mbrojtjen e trashëgiminë kulturore.

Bazuar në ligjin e vjetër njësitë e qeverisjes vendore duhet të bashkëpunojnë me Inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e trashëgiminë kulturore për ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgiminë kulturore, që ndodhen në territoret në juridikcionin e tyre. Ministria duhet të përcaktonte mënyrat e bashkëpunimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektoriatit me Vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 8/1 të ligjit Nr.9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore .Ky akt nënligjor nuk është përbushur asnjëherë dhe Inspektorati nuk ka funksionuar.

Për sa më sipër ligji Nr.9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” ka pësuar disa ndryshime dhe sipas specialisteve të MK duhej riformular tërësisht, pasi ishin evidentuar probleme dhe vakume ligjore, të cilat u rilanë, pasi nuk gjenin zgjidhje në ligjin e vjetër dhe as në dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Ligji i ri Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” doli në vitin 2018 dhe u shoqërua me reformën strukturore në Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e varësisë.

Për periudhën 2018-2019 përsëri Ministria është administratori shtetëror më i rëndësishëm për ruajtjen, mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, dhe institucioneve në varësi Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore i cili përftohet nga mbyllja e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës, me dy drejtoritë “Drejtorinë e Monumenteve të Kulturës” dhe “Drejtorinë e Shërbimeve Arkeologjike” të cilat bashkërendojnë punën me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRKT) dhe Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve (NJAKPA).

Në mbështetje të VKM Nr. 364, datë 29.05.2019 për “*Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore*” u krijuar Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) nga bashkimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

Funkcionet dhe kompetencat e tyre i kanë kaluar Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore në zbatim të shkresës së Ministrisë së Kulturës me Nr. 6407 Prot., datë 29.10.2019 “Për njohje dhe zbatim” të Urdhrit të Kryeministrat Nr.137 datë 21.10.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore*”.

Instituti i Monumenteve të Kulturës ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale. IKTK-ja ndër të tjera referuar ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” neni 30 pika 6 dhe neni 29 pika 4 ka për detyrë të hartoje kriteret e hulumtimeve arkeologjike dhe standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale.

Bazuar në nenin 82 mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore përcaktohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me institucionet, entet e tjera publike, universitetet dhe institutet e kërkimit të specializuara, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Edhe pse MK sqaron se janë në proces hartimi draft Vendimet për këto çështje, ende nuk ka asnjë evidence që këto kritere e standarde të janë hartuar apo të janë përcaktuar procedura për hulumtimet arkeologjike, të cilat duhet të ishin të miratuara e në përdorim që në Maj të vitit 2019 në zbatim të nenit 267 pika e të dispozitave përfundimtare të ligjit.

DRKT dhe NJAKPA janë përgjegjëse direkt për administrimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e parqeve arkeologjike, për monitorimin e rregullt të zonave të mbrojtura arkeologjike të parqeve, dhe marrjen e masave në rastin e ndërhyrjeve të paligjshme apo dëmitimeve të pasurisë arkeologjike sipas procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”. Gjithashtu ato kontrollojnë, bashkëpunojnë dhe adresojnë problematikat mbi çdo aktivitet që kryhet në territorin e parqeve arkeologjike. Kanë për detyrë të realizojnë mbikëqyrjen arkeologjike të projekteve zhvillimore apo aktivitetet e tjera të miratuara nga K.K.T.K.M, në territorin që administrojnë. Për realizimin e mbikëqyrjes arkeologjike bashkëpunojnë me institucionet e specializuara si I.K.T.K dhe I.K.M.T.K. Në bashkëpunim me I.K.T.K, gjithashtu kryejnë gërmime arkeologjike shpëtimi të miratuara nga K.K.T.K.M në territorin që administrojnë.

Legislacioni i ri parashikon hartimin e planeve të menaxhimit për parqet arkeologjikë dhe planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore të cilat hartohen bazuar në

këtë legislacion. Legjislacioni i mëparshëm për trashëgiminë kulturore nuk kishte parashikime për hartimin e planeve të menaxhimit për pasuritë kulturore, ato thjeshtë e shkurtimisht përfshiheshin në rregulloren e institucionit. Në bazë të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, planet e menaxhimit hartohen bazuar në Ligjin 27/2018 dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 169, datë 20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.

Planet e menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore të trashëgimisë duhet të përbajnjë regjimet dhe rregullat e veçanta në lidhje me karakteristikat e përgjithshme të territorit të mbrojtur, për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, objektivat dhe organizimin e menaxhimit, një program afatshkurtër dhe afatgjatë, programet për ruajtjen e vlerës së paluajtshme kulturore dhe zbatimin e planit, financimin e aktiviteteve për zbatimin e planit, përfshirjen e partnerëve në zbatimin e planit, kushtet dhe rekomandimet për aktivitetet zbatuese, sistemin e monitorimit në territorin e mbrojtur dhe sigurimin e masave të shpëtimit në rastet e emergjencave; sistemin e kontrollit të zbatimit. Planet e menaxhimit, sipas nenit 45 dhe 46, të këtij ligji, ndër të tjera hartohen për vlerat e paluajtshme kulturore, të përfshira në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë, pra zonat dhe parqet arkeologjike.

Planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme i nënshtronen diskutimit publik, në përputhje me procedurën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave. Shtrirja, struktura, përbajtja dhe metodologja e përgatitjes së planeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në lidhje me këtë detyrim aktualisht është miratuar me Vendim të KTKM vetëm plani i Menaxhimit të Integruar (2020-2030) i Parkut Kombëtar të Butrintit. Ndërkohë që **parqet e tjera nën subjekt auditimi nuk kanë Plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore**. Realizimi i kësaj pike kërkon studim gjithëpërfshirës dhe angazhim të të gjithë institucioneve përgjegjës por deri me sot nuk ka asnje arritje në këtë drejtim për këto parqe.

Në parqe kryhen aktivitete rutinë të ruajtjes e mbrojtjes si ndërhyrje mirëmbajtjeje, pastrim nga vegjetacion, vendosje e tabelave shpjeguese dhe orientuese por pa një një program afatshkurtër dhe afatgjatë apo programe sistematike për ruajtjen e vlerës së paluajtshme kulturore dhe masa konkrete për zbatimin e planit. Gjithashtu në parqet arkeologjike objekt auditimi për periudhën 2016-2019 janë kryer kërkime shkencore, gërmime arkeologjike, restaurime e rehabilitime, konservime e mirëmbajtje në kuadër të projekteve te ndryshme te miratuar nga KKA e KKR. Gjithashtu DRTK, NJAKPA kanë kontribuar në mbarëvajtjen e gërmimeve arkeologjike, duke vendosur në dispozicion ambientet e parqeve dhe specialistët për zhvillimin e gërmimeve, duke asistuar gjatë gjithë procesit.

Tabela 4 Numri i projekteve të miratuar nga KKR dhe KKA në periudhën objekt auditimi

Nr. i vendimeve të miratuar nga KKA e KKR				
Parqet Arkeologjike	2016	2017	2018	2019
Butrint	11	5	3	2
Apolloni	14	3	7	4
Bylis	1	1	2	1
Amantia	3	1	2	4
Orikum	2	1	2	1

Burimi Ministria e Kulturës

Gjatë auditimit të këtyre vendimeve vihet re se numri i projekteve të miratuara për mbrojtjen, ruajtjen madje edhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore në parqet arkeologjike është gjithnjë e më i vogël nga viti në vit.

Gjithashtu gjatë inspektimit në terren të siteve arkeologjike dhe takimeve me drejtoret përkatës sidomos për parqet arkeologjike të Amantias, Orikumit Bylisit jo vetëm u konstatua por dhe konfirmua nga titullarët se këto site kanë një potencial të madh objektesh të trashëgimisë kulturore ende të pazbuluar e të pa gërmuar. Kriteret teknike mbi vlerësimin e potencialit pasuror që fsheh një zonë arkeologjike, i refrohen gërmimeve pjesore të realizuara së fundmi të cilat konfirmojnë ekzistencen e shumë reperteve akoma të pazbuluara. Në parqet arkeologjike intensiteti dhe numri i këtyre aktiviteteve është i ulët nga pikëpamja sasiore. Ka pak punime e ndërhyrje edhe ato që kryhen janë të izoluara dhe të shpërndara. Pjesa më e madhe e zonave arkeologjike ka nevojë për aktivitete sistematike të gërmimeve shkencore, rehabilitimeve e aktiviteteve konservuese.

Bazuar në nenin 71 të ligjit Nr. 27/2018, institucionet e specializuara kanë të drejtë të kontrollojnë gjendjen teknike dhe kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore, si dhe të zonave që u nënshtronen dispozitave të mbrojtjes indirekte dhe ato ushtrojnë kontrollin teknik mbi kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore të paluajtshme. Procedura për kryerjen e kontrollit teknik referuar ligjit rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. **Deri me sot nuk ka një procedurë të miratuar të kontrollit teknik dhe nuk ka asnjë kontroll teknik të dokumentuar me raporte përkatës për periudhën objekt auditimit në sitet e përzgjedhura edhe pse detyrimi ligjor përeakton se këto procedura duhet të ishin të miratuara e në përdorim që Maj të vitit 2019.**

Inspektoratit Kombëtar për Mbrotjen e Trashëgimisë Kulturore IKMTK-ja është një tjetër institucioni që kryen kontrollin për të verifikuar ekzistencën ose shkallën e ruajtjes e të mbrojtjes së pasurive kulturore të paluajtshme dhe zbatimin e detyrimeve. Ai ka një sërë kompetencash në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen si: të inspekoje ecurinë e gërmimeve arkeologjike, të zbatojë masat mbrojtëse mbi pasuritë kulturore të paluajtshme në të gjithë territorin kombëtar, të zbatojë masat ruajtëse të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, të zbatojë masa të ruajtjes, mbrojtjes dhe cilësisë së punimeve të restaurimit të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme etj. Referuar nenit 28 pika 2 dhe 3 e ligjit mënyra e organizimit dhe funksionimit të IKMTK-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe u nënshtronet dispozitave të Kodit të Punës dhe ligjt mbi Inspektimin në Republikën e Shqipërisë. Kryeinspektori emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe struktura dhe organika e tij miratohet me urdhër të Kryeministratit. **Mënyra e funksionimit të IKMTK nuk është e qartë, inspektorati nuk ka kryer kontolle dhe nuk ka gjeneruar asnjë procesverbal inspektimi për parqet arkeologjike. Gjithashtu është konstatuar se nuk ka një Vendim të miratuar për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrotjen e Trashëgimisë Kulturore**

Në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nevojiten gërmime të vazhdueshme. Ndërhyrjet e lejuara në lidhje me gërmimet arkeologjike, sipas legjislativit në fuqi miratohen nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale. Këto gërmime kategorizohen në dy llojesh:

1. Gërmime arkeologjike sistematike në kuadër të projekteve kërkimore – shkencore nga Instituti i Arkeologjisë dhe Universiteti i Tiranë, Fakulteti i Historisë;
2. Gërmime arkeologjike shpëtimi ose sondazhe arkeologjike në kuadër të projekteve zhvillimore ose gjetjeve rastësore në territor

Projekte restaurimi hartohen nga IKTK/DRTK/ e të tjerë të licencuar në restaurim/arkeologji dhe miratohen në KTKM.

Gjatë auditimit u konkludua se deri ne vitin 2019 procedura mbi ndërhyrjet e gërmimit, restaurimit dhe përdorimit është ndjekur nga KKA dhe KKR sipas ligjit te vjetër dhe nuk janë evidentuar vendime të KTKM.

Gjithashtu gjatë periudhës objekt auditimit nga institucionet përgjegjëse nuk është marrë asnjë mase për ruajtjen fizike të parqeve arkeologjike apo për ndriçimin e tyre. Përveç Parkut arkeologjik të Butrintit dhe të Apolonisë asnjë nga parqet e tjera nuk ka ruajtje fizike apo ndriçim me qëllim parandalimin e dëmtimeve, gërmimeve të paligjshme zjarreve etj.

Gjetje:

- IKTK dhe MK aktualisht nuk kanë hartuar e miratuar kriteret e hulumtimeve arkeologjike dhe standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale as mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore referuar nenit 29 pika 4, nenit 30 pika 6 dhe nenit 82 të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
- Për parqet Arkeologjike nën subjekt auditimi Apolloni, Bylis, Amantia Orikum nuk janë hartuar ende plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore referuar nenit 45 dhe 46 të legjislacionit te ri, Ligjit Nr. 27/2018. Realizimi i këtyre planeve kërkon studim gjithëpërfshirës dhe angazhim të të gjithë institucioneve përgjegjës por deri me sot nuk ka asnjë arritje në këtë drejtim për parqet e sipër përmendura.
- Në parqet arkeologjike intensiteti dhe numri i projekteve të gërmimeve shkencore apo restaurimeve dhe rehabilitimeve është i ulët. Ka pak punime e ndërhyrje edhe ato që kryhen janë të izoluara dhe të shpërndara. Referuar vlerësimëve gjatë inspektimeve dhe pohimeve gjatë intervistimeve të titullarëve pjesa me e madhe e zonave arkeologjike ka nevojë për aktivitete sistematike të gërmimeve shkencore, rehabilitimeve e aktivitetit konservues sepse ato kanë një potencial të madh objektesh të trashëgimisë kulturore ende të pagërmuar.
- Aktualisht nuk ka një procedurë të miratuar të kontrollit teknik dhe nuk ka asnjë kontroll teknik të dokumentuar me raporte përkatës për periudhën objekt auditimit në sitet e përcaktuara referuar nenit 71 të ligjit Nr. 27/2018.
- Bazuar në nenin 27 dhe 28 pikat 2, 3 e ligjit Nr. 27/2018 IKMTK nuk ka të dokumentuar asnjë veprimtari si institucion i specializuar në lidhje me securinë e gërmimeve arkeologjike në tokë dhe ato nenujore, masat mbrojtëse mbi pasuritë kulturore të paluajtshme në të gjithë territorin kombëtar, masat ruajtëse të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, masa të ruajtjes, mbrojtjes dhe cilësisë së punimeve të restaurimit të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme etj. Vendimi për mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore nuk është miratuar dhe struktura dhe as organika e tij. Ai duhet të ishte i miratuar që në Maj të 2019 dhe struktura dhe organika e tij e miratuar brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi e vendimit.
- Parqet arkeologjike Bylis, Amantia dhe Orikum nuk kanë ndriçim dhe nuk janë të mbuluara me ruajtje fizike.

Konkluzione:

- Institucionet e specializuara në fushën e arkeologjisë punojnë pa kriteret e hulumtimeve arkeologjike, pa standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe pa mënyra të trajtimit, norma teknike, kritere dhe modele te ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore të përditësuara, e pa procese të miratuar kontrolli teknik sipas legjisacionit të ri në fuqi.
- Edhe pse nga strukturat përgjegjëse merren disa masa për ruajtjen e mbrojtjen e parqeve arkeologjike, MK dhe institucionet e specializuara bashkë me zyrat e koordinimit ë parqeve për Parqet Arkeologjike nën subjekt auditimi Apolloni, Bylis, Amantia Orlikum nuk kanë marrë masa për të hartuar planet për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore referuar ligjt i cili parashikon hartimin e planeve të menaxhimit për parqet arkeologjikë dhe planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore.
- Studimet e kërkimet arkeologjike, punimet e gërmimeve, restaurimeve e rehabilitimeve në të gjithë parqet, janë të pamjaftueshëm. Shtimi i numrit të projekteve, si dhe menaxhimi i pasurisë arkeologjike në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtarisht, duhet të jenë prioritetet themelor i të gjitha institucioneve shtetërore të përfshira në këtë fushë. Shumë pak përparim është bërë në fushën e gërmimeve sistematike e atyre të shpëtimit. Duhen bërë përpjekje të mëtejshme dhe investime në këtë drejtim.
- Jo të gjitha institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore funksionojnë. Inspektoriat Kombëtar për Mbrotjtjen e Trashëgimisë Kulturore nuk ka kryer asnë veprimitari në lidhje me ecurinë e gërmimeve arkeologjike në tokë dhe ato nënurore, masat mbrojtëse mbi pasuritë kulturore të paluajtshme në të gjithë territorin kombëtar, masat ruajtëse të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, masa të ruajtjes, mbrojtjes dhe cilësisë së punimeve të restaurimit të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme etj.
- Nga ana e institucioneve vendimmarrëse nuk është marre asnë masë për të siguruar ndriçimin dhe ruajtjen fizike të të gjitha siteve arkeologjike.

Për këtë rekomandojmë:

- Institucionet e specializuara përgjegjëse dhe Ministria e Kulturës të marrin masa të përfundojnë hartimin dhe miratimin e kritereve të hulumtimeve arkeologjike dhe standarde kriteret për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale si dhe mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.

Brenda gjashtë majorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës, në koordinim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Njësinë e Administrimit e Koordinimit të Parqeve Kombëtare Apolloni Bylis dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë të marrin masa për hartimin e Planeve për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore për parqet arkeologjike. Nëpërmjet një plani afatgjatë të synohet ndërtimi i një sistemi menaxhimi modern i këtyre parqeve arkeologjike duke përfshirë restaurimin dhe konservimin e monumenteve, rehabilitimin tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, duke pasur si qëllim shndërrimin e tyre në qendra me aktraktive.

Deri në fund të vitit 2022

- Me qëllim ruajtjen e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në parqet arkeologjike nga institucionet përgjegjëse dhe MK të merren masa ti kushtohet më shumë vëmendje këtij sektori e të planifikohet një aktivitet sistematik për ndërhyrjet e lejuara. Gjithashtu të merren masa për hartimin edhe të projekteve apo ideve për promovimin e parqeve, krahas projekteve për ndërhyrjet në monumente, në mënyrë që të rritet vizitueshmëria e tyre, duke gjeneruar kështu më tepër të ardhura nga to te cilat mund ti akordohen komponentëve të mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve në monumente.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

- MK të marrë masa për hartimin e udhëzimit për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik në mënyrë që Institucionet e specializuara, të ushtrojnë kontrollin teknik mbi kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore të paluajtshme.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

- MK të marre masa e të filloje hartimin e draft vendimit për mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrotjen e Trashëgimisë Kulturore në vazhdim, sipas afateve të parashikuara të miratohet struktura dhe organika e tij.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2021

3.2.2 A janë efektive strukturat përgjegjëse për kryerjen e proceseve sistematike në ruajtjen e parqeve/siteve arkeologjike?

Gjatë periudhës objekt auditimi 2016–2019, strukturat përgjegjëse për mbrotjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në parqet arkeologjike kanë pësuar ristrukturime në kuadër të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore, dhe Muzetë”.

Deri në vitin 2019 për parqet nën objekt auditimit (Parqet arkeologjike Apolloni, Bylis, Orikum, Amantia, Butrint) strukturat përgjegjëse për kryerjen e proceseve sistematike rutinë për ruajtjen ishin, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Bylis, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë për Parkun e Orikumit dhe Amantias, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Butrint.

Për shkak të numrit të vogël të punonjësve të ZAKPA Bylis, i cili pretendohet se ka sjellë pengesa të vazhdueshme administrative, financiare si dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore, sepse funksionet financiare të ZAKPA Bylis mbuloheshin nga ZAKPA Apoloni, ka qënë e nevojshme kalimi i këtij institucioni në nivel sektori pranë strukturës ZAKPA Apoloni, duke krijuar një strukturë të vetme, Njësinë e Administrimit dhe Kordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni dhe Bylis me një strukturë organizative të miratuar nr. 141 datë 21.10.2019 me 14 punonjës e përbërë nga 4 sektorë e cila është përgjegjëse për drejtimin e veprimtarisë administruese të parqeve arkeologjike dhe zbatimin e të gjitha masave për mbrotjen e trashëgimise kulturore. Deri në Maj te vitit 2019 ZKPA Bylis funksiononte në bazë të Urdhrit nr.185 datë 23.06.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Bylis me 5 punonjës, ndërsa ZKPA Apoloni në bazë të Urdhrit nr.184 datë 23.06.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikes së Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni me 11 punonjës me tre sektorë.

Struktura përgjegjëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e siteve arkeologjike në D.R.T.K-Vlorë, është Sektori i Menaxhimit të Parqeve Arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq me 10 punonjës një përgjegjës sektori, tre specialist arkeolog dhe gjashtë punonjës mirëmbajtje. Bazuar në Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i

Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhrin e strukturës së institucionit nr.139, datë 21.10.2019, Sektori i Menaxhimit të Parqeve Arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq, ngarkohet ndër të tjera me përgjegjësitë dhe detyrat e mëposhtme:

Administrimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e parqeve arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq; Monitorim të rregullt të zonave të mbrojtura arkeologjike të parqeve Amantia-Orikum-Finiq, dhe marrjen e masave në rastin e ndërhyrjeve të paligjshme apo dëmtimeve të pasurisë arkeologjike sipas procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”.

Kjo strukture propozon zonat e mbrojtura të parqeve arkeologjike ose monumenteve dhe siteve të tjera arkeologjike në territorin që administron D.R.T.K-Vlorë, në bashkëpunim me I.K.T.K ose institucione të tjera të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore; gjithashtu kontrollon, bashkëpunon dhe adreson problematikat mbi çdo aktivitet që kryhet në territorin e parqeve arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq;

Në bashkëpunim me Sektorin e Artit dhe Arkitekturës ose I.K.T.K harton projekte për restaurimin dhe konservimin e monumenteve në parqet arkeologjike dhe realizon mbikëqyrjen arkeologjike të projekteve zhvillimore apo aktiviteteve të tjera të miratuara nga K.K.T.K.M, në territorin që administron D.R.T.K-Vlorë, në territorin e Parqeve Arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq. Për realizimin e mbikëqyrjes arkeologjike bashkëpunon me sektorët e tjerë të D.R.T.K-Vlorë, I.K.T.K dhe I.K.M.T.K; Në bashkëpunim me I.K.T.K, kryen gërmime arkeologjike shpëtimi të miratuara nga K.K.T.K.M në territorin që administron D.R.T.K-Vlorë, në territorin e Parqeve Arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq, si dhe Zonat e Mbrotura Arkeologjike të qytetit të Vlorës dhe qytetit të Sarandës. Në përputhje me planin e zhvillimit dhe të zgjerimit të veprimtarisë turistike në parqe arkeologjike Amantia-Orikum-Finiq, mund të propozojë projekte për zbulimin e vlerave arkeologjike në territorin e tyre, të cilat do të shqyrtohen e miratohen nga K.K.T.K.M-ja, siç parashikohet në Ligjin nr. 27/2.

Struktura dhe organika e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint është miratuar me urdhër nr. 188 datë 04.07.2014 me një strukturë me 14 vetë me 3 sektorë, sektori i arkeologjisë dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore, sektori i muzeut dhe sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse. Sektori i arkeologjisë dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore përbëhet nga 8 punonjës, një përgjegjës sektori, dy specialist dhe 5 punëtor mirëmbajtje.

Punonjësit e sektorëve të menaxhimit të parqeve përfshirë përgjegjësit dhe punëtoret e mirëmbajtjes për Parkun Arkeologjik të Apollonisë përfshirë parkun dhe muzeun , Parkun Arkeologjik të Bylisit dhe parqet arkeologjike Orikum e Amantia, kryejnë detyrat rutine në funksion të misionit të njësisë së tyre për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave kulturore që nga aktivitetet e mirëmbajtjes, inspektimet, raportimet etj. por pa një strategji dhe plan veprimi me masa konkrete mirëmbajtje dhe inspektimi. Pra në parqe kryhen aktivitetet rutine të ruajtjes e mbrojtjes si ndërhyrje mirëmbajtjeje, pastrim nga vegjetacioni, vendosje e tabelave shpjeguese dhe orientues, evidentime e gjetje të reja, mbikëqyrje punimesh, raporte sporadike për çështje të ndryshme por pa një plan zhvillimi afatshkurtër dhe afatgjatë apo programe sistematike për ruajtjen e vlerës së paluajtshme kulturore dhe masa konkrete për zbatimin e tyre.

DRKT Vlorë ka nën juridikcionin e vetë 3 parqe arkeologjike të cilat janë të shpërndara në largësi fizike të konsiderueshme nga njëra tjetra dhe nga zyrat e DRKT. Po ashtu edhe parku arkeologjik i Bylisit nga është në distance fizike të konsiderueshme nga ZAKPA Fier

Punonjësit nuk kanë mjete logistike të nevojshme për të kryer me eficiencë funksionet e tyre.

Tabela 5 Numri i punonjësve të angazhuar me mirëmbajtjen dhe pastrimin e sítave për periudhën objekt auditimi

Institucioni	2016	2017	2018	2019
ZAKPA-Apoloni	5	5 +1 sezonal	5+1 sezonal	8+1 sezonal
ZAKPA-Bylis	3+1 sezonal	3+1 sezonal	3+1 sezonal	
ZAKPA-Butrint	6+3 sezonal	6+3 sezonal	6+2 sezonal	6+3 sezonal
DRTK-Vlorë (sektori i Parqeve Amantia- Otikum-Finiq	6	6	6+1 sezonal	6+1 sezonal

Burimi Ministria e Kulturës

Pastrimi dhe mirëmbajta e Parqeve Arkeologjik Apoloni e Bylis realizohet nga punonjësit e Parkut dhe gjatë kohës së fluksi turistik plotësohet edhe me shërbime nga palë të tjera si subjekt privat i zgjedhur përmes prokurimit publik për këtë lloj shërbimi.

Punimet e mirëmbajtjes dhe pastrimi i Parqeve Arkeologjik Amantia dhe Orikum kryhen nga punonjësit e parqeve dhe jo nga palë të tjera të kontraktuara për këtë qëllim.

Pastrimi dhe mirëmbajta e Parku Kombëtar Butrint realizohet nga punonjësit e Parkut dhe gjatë kohës së fluksi turistik plotësohet edhe me shërbime nga palë të tjera si subjekt privat i zgjedhur përmes prokurimit publik për këtë lloj shërbimi.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është dhe ruajta fizike e parqeve me qëllim parandalim e dëmtimeve, gërmimeve të paligjshme etj. Sitet nën objekt auditimit ruhen si më poshtë:

Parku arkeologjik i Apollonisë i administruar nga ZAKPA Fier, ka rrëthim dhe ndriçim të pjesshëm në zonat kryesore. Zonat e ndriçuara në park janë zona e manastirit dhe Muzeu Arkeologjik kurse pjesa tjetër e tij është e pandriçuar. Rrethimi gjithashtu është i pjesshëm në pjesën e zonës së Agoras dhe në disa monumente periferike me mozaik kurse parku në tërësi nuk është i rrëthuar sepse ka në sipërfaqe relativisht të madhe rrëth 700 ha. Ruajtja e parkut bëhet me roje të sigurisë private me dy vend roje ku njëri qëndron pranë Manastirit ndërsa i dyti bën patrullim qarkullues në park. **Nisur nga disa ngjarje të muajve të fundit ku kanë ndodhur dëmtime në monument brenda parkut dhe evidentimit here pas here nga punonjësit e parkut të gërmimeve ilegale konkludohet që ruajtja fizike nuk është e mjaftueshme për të parandaluar.**

Parku arkeologjik Bylis i administruar nga ZAKPA Fier është pjesërisht i rrëthuar në zonën A por në park nuk ka fare ndriçim dhe as roje. Parku së fundmi është rrezikuar nga zjarri. Ruajtja fizike në parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikumit gjatë orarit zyrtar të punës realizohet nëpërmjet punonjësve të mirëmbajtjes së D.R.T.K-Vlorë, ndërsa për oraret e pas punës dhe në orët e natës nuk ka roje të parashikuar në organikën e institucionit apo subjekt të kontraktuar, pasi një gjë e tillë është e papërballueshme nga buxheti i D.R.T.K-Vlorë dhe mungojnë gjithashtu fondet shtesë për këtë qëllim. Nga ana e D.R.T.K-Vlorë kjo

problematike është shoqëruar me kërkesën për ruajtjen fizike të parqeve dhe i është drejtuar Ministrisë së Kulturës me anë të shkresës Nr. 198 prot., datë 05.04.2018. Për shkak të sipërfaqes së madhe dhe terrenit jo të përshtatshëm si dhe specifikave të ndryshme, një rrithim tërësor i siteve nuk është i mundur. Për parkun arkeologji të Orikumit, i cili është brenda rrithimit të bazës ushtarake të Pashalimanit, një gjë e tillë është e panevojshme. **Nuk ka sistem ndriçimi në të dy Parqet Arkeologjike Amantia dhe Orikum.**

Parku arkeologjik i Butrintit ruhet me shërbim privat të ruajtjes fizike ku me 3 turne janë muzeu arkeologjik dhe hyrja në qytetin antik të Butrintit. Rrethimi i qytetit antik është ndërtuar rreth viteve '70 me mur guri dhe shtylla betoni. Ndriçimi është në hyrje të sitit dhe në zonën e kalasë së Akropolit (Muzeu).

Gjetje:

- Në Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit te Parqeve Arkeologjike Apolloni e Bylis dhe Amantia e Orikum përgjegjësit e sektorëve të parqeve dhe punonjësit e mirëmbajtjes kryejnë detyrat rutinë por pa një plan me masa konkrete apo një plan zhvillimi afat shkurtër dhe afatgjatë dhe programe sistematike për ruajtjen e vlerës së paluajtshme kulturore dhe masa konkrete për zbatimin e planit në përputhje me një strategji.
- Struktura përgjegjëse për parqet Amantia dhe Orikum në DRKT Vlorë po ashtu edhe ZAKPA për parqet Apolloni dhe Bylis janë të shpërndara në distanca të largëta dhe punonjësit nuk kanë mjete për ndjekjen e aktivitetit të të gjitha parqeve, rrjedhimisht për kryerjen eficiente të funksioneve te tyre.
- Strukturat e sipërpërmendura nuk janë të mjaftueshme për të kryer funksionin e ruajtjes fizike të siteve. Përveç Parkut Arkeologjik të Butrintit e Apollonisë të cilët ruhen me roje private, Parqet Bylis, Amantia dhe Orikum nuk kane asnjë punonjës për ruajtjen e tyre.

Konkluzione:

- Strukturat e DRTK Vlorë dhe ZAKPA Fier përgjegjëse për kryerjen e proceseve sistematike në ruajtjen e parqeve/siteve arkeologjike funksionojnë mbi bazën e një veprimtaria rutinë pa programe sistematike afat shkurtër afatgjatë dhe pa plane me masa konkrete.
- Punonjësit e DRTK Vlorë dhe ZAKPA Fier përgjegjës për kryerjen e proceseve sistematike në ruajtjen e parqeve/siteve arkeologjike nuk janë të mjaftueshëm për sitet që administrojnë sepse janë në largësi fizike të madhe dhe ata nuk kanë logistikë të mjaftueshme.
- Strukturat e DRTK Vlorë dhe ZAKPA Fier nuk kanë punonjës të mjaftueshëm për të kryer funksionet e mbrojtjes fizike të Parqeve Arkeologjike Bylis, Amantia dhe Orikum.

Për këtë rekomandojmë:

- DRKT Vlorë dhe ZAKPA Fier të marrin masa e të hartojnë programe e plane sistematike afatshkurtra e afatgjata për ndërrhyrjet të nevojshme për të zhvilluar dhe ruajtur territorin arkeologjik të parkut.
- Me qëllim rritjen e eficiencës së punës DRKT Vlorë dhe ZAKPA Fier të marrë masa për të analizuar nevojat specifike për forcimin e kapaciteteve dhe për administrimin ruajtjen dhe mbrojtjen e parqeve e të propozojë për miratim, Ministrisë së Kulturës strukturë të plotë sipas nevojave.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vazhdimësi

-
- Rruga "Abdi Toptani", Nr.1, www.klsh.org.al, email: klsh@klsh.org.al 72

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- DRKT Vlorë dhe ZAKPA Fier në bashkëpunim me Ministrinë të analizoje nevojat logistike për ambiente shërbimi në parqe, vegla pune dhe mjete lëvizëse për kryerjen eficiente të funksioneve për ruajtjen dhe mbrojtjen dhe të merren masat e nevojshme për plotësimin e nevojave.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Nga DRKT dhe NJKPA të analizohet mënyra me eficiente për të kryer ruajtjen fizike të çdo siti. Për shkak të shtrirjes së parqeve arkeologjike dhe morfologjisë se tyre të analizohet mundësia për sistemet elektronike të kontrollit me kamera të shpërndara në pikat me te përshtatshme e strategjike të parqeve, të cilat mund të lidhen me një salle të vetme monitorimi ku një roje i vetëm ka mundësi të kontrollojë gjithë veprimtarinë e situatën si gjatë ditës dhe gjatë natës si për dëmtime, zjarre apo ndërhyrje të paligjshme të çdo lloji.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

3.3 A janë ndërmarrë masa efektive për valorizimin e parqeve/siteve arkeologjike?

3.3.1 A janë ndërmarrë masa efektive për të sigruuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin publik të parqeve/siteve arkeologjike?

Duke pasur parasysh se: “*Pasuritë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në pronësi shtetërore janë të destinuara për shfrytëzim nga ana e publikut, në përputhje me nevojat e përdorimit, me përjashtim të rasteve kur nevojat e mbrojtjes e ndalojnë atë*”¹³³, si dhe duke qenë i qartë parashikimi normativ se: “*Vlerësimi i trashëgimisë kulturore është ushtrimi i atyre funksioneve e aktiviteteve që kanë si qëllim njojen dhe promovimin e pasurisë kulturore dhe që sigurojnë kushtet më të mira të shfrytëzimit publik të pasurive e vlerave kulturore për një zhvillim të qëndrueshëm.*”¹³⁴, nga ana e grupit të auditimit u konsiderua e një rëndësie të posaçme trajtimi i aspekteve që kanë të bëjnë me krijimin e lehtësive dhe mundësive, që të interesuarit për sitet arkeologjike, të jene te motivuar për t'i vizituar ato.

Ajo që rezulton evidente nga konsultimi i të dhënave mbi numrin total të vizitorëve (të huaj dhe vendas, me dhe pa biletë), të pranishëm gjate periudhës 2016-2019, në pesë sitet subjekt auditimi, është trend rritës i interesimit të turistëve për këto pasuri historiko – kulturore.

Tabela 6: Numri i vizitorëve në parqet arkeologjike, 2016-2019

Parku	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Parku Kombëtar Butrint	158,812	167,759	211,495	236,723
Parku arkeologjik Apoloni	22,148	29,141	49,237	60,250
Parku arkeologjik Bylis	2,949	3,966	5,587	4,595

¹³³ Ligji 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 6, Paragrafi 1

¹³⁴ Ligji 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 8, Paragrafi 1

Parku arkeologjik Orikum	2,297	1,832	2,640	3,451
Parku arkeologjik Amantia	971	1,182	926	1,399

Burimi: Të dhëna të ofruara nga Ministria e Kulturës

Sigurisht kjo e dhënë është një konstatim i cili dëshmon për potencialin që përfaqëson histori dhe kultura, si një atraksion turistik, por nga ana tjetër duhet të na shtyjë që të përmirësojmë ofertën për vizitoret dhe kulturëdashësit të interesuar për këto site.

Gjatë punës se tij, Grupi i Auditimit u ndesh në arritje dhe përpjekje të lavdërueshme, sikur dhe me mangësi në realizimin e objektivave nga ana e njësive administruese të siteve arkeologjike.

Sitet arkeologjike duke qenë konfigurime urbane shumëshekullore, i përkasin një realiteti të hershëm, i cili për nga kriteret e jetës së komuniteteve që i kane banuar, gjenden në vende te cilat nuk përkojnë më me qendrat urbane të sotme. Si të tilla, *një pjese e tyre, janë edhe shumë larg gendrave kryesore urbane, gjë që e bën si kohën e udhëtimit, ashtu edhe infrastrukturën orientuese dhe rrugore, një mundësi, apo një pengesë më shumë për vizitat e tyre.*

Kështu p.sh. **parku arkeologjik Apoloni**, ndodhet 12 kilometra larg qytetit të Fierit dhe 3 km nga bypassi Fier-Levan. Drejt sitit ka sinjalistikë orientuese rrugore të mjaftueshme dhe të dukshme, sikurse dhe konstatohet se gjendja e rrugëve në drejtim të P. A. Apoloni është shumë e mirë, si nga qyteti i Fierit, ashtu dhe nga bypassi.

Ndërsa **parku arkeologjik Bylis**, është 39 km nga Fieri (nëse kalohet nëpër territorin e njësisë Hekal) dhe 7 km nga autostrada Fier-Tepelenë, nëse ndiqet rruga ndërqytetëse e lartpërmendur.

Nga inspektimi i grupit të auditimit u vu re se segmenti prej 7 km është krejtësisht i paudhëtueshëm me makina të ulëta dhe autobusë, ndërkohë që po ashtu mbetet i vështirë me makina tip fuoristradë.

Sikurse na është referuar: "Institucioni i ZAKPA Bylis ka realizuar kërkesa për përmirësimin e situatës së rrugës pranë Këshillit Bashkiak Mallakastër, ku Drejtori i atëhershëm i Parkut Bylis ishte edhe anëtar i këtij këshilli. Gjithashtu kërkesa dhe ankesa për gjendjen e rrugës janë bërë edhe pranë përfaqësuesve të ARRSH-së dhe FSHZH-së, të cilët kanë ardhur në Bylis për të parë gjendjen e rrugës.¹³⁵"

Ky informacion nuk na është mbështetur me dokumentacionin përkatës, as kur na u përcollën përgjigjet e pyetësorit më datë 7 tetor 2020.

Në përgjigjet e pyetësorit të lartpërmendur referohej: "*Gjendja e rrugës për në Bylis është e papërshtatshme* nga Fieri në P. A. Bylis dhe nga autostrada në P. A. Bylis. Nuk ka pasur kërkesa të depozitura nga ana e NJAKPA -së për rrugën për periudhën e auditimit. Në lidhje me këtë park, është në proces diskutimi, me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, mundësia për investim në aksesimin e rrugës lidhëse me parkun (ndr. 7 km).¹³⁶". Përkeqësimi i kalueshmërisë së rrugëve për në Bylis, është reflektuar edhe në rënien e numrit të vizitorëve, në vitin 2019, sikurse vërtetohet nga të dhënat e vëna në dispozicion nga MK.

Tabela 7: Numri i vizitorëve në parkun arkeologjik të Bylisit, 2016-2019

Parku	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019

¹³⁵ Info me mail nga Drejtorja e ZAKPA Apolloni Bylis, datë 22 tetor 2020

¹³⁶ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Parku arkeologjik Bylis	2,949	3,966	5,587	4,595
-------------------------	-------	-------	-------	-------

Burimi: Të dhëna të ofruara nga Ministria e Kulturës

Ky sit arkeologjik territorialisht është nën juridikcionin e Bashkisë Mallakastër.

Lidhur me **parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikumit**, segmentet rrugore lidhëse të të cilëve me rrugët kryesore janë përkatësish 200 m dhe 150 m, konstatohet se: “Gjendja fizike e rrugës që siguron kalimin në parkun arkeologjik të Amantias, për shkak të investimeve të fundit në rehabilitimin e rrugës së Lumin të Vlorës (loti i parë Babicë-Gjorm, viti 2018) rruga është në gjendje fizike shumë të mirë dhe ka krijuar mundësinë e vizitës në një kohë mjaft të shkurtër dhe komode të parkut arkeologjik.”¹³⁷.

Gjendja fizike e rrugës që siguron kalimin në parkun arkeologjik të Orikumit është shumë e mirë, për shkak të investimit të Bashkisë Vlorë në rrugën e plazhit të qytezës së Orikumit, në vitin 2018. Rikualifikimi i rrugës u mundësua edhe falë një angazhimi energjik të DRTK Vlorë, e cila ka ngritur shpesh problemin e paraqitur nga segmenti i dëmtuar, duke kërkuar bashkëpunim, si me Bashkinë Vlorë, ashtu edhe me Autoritetin Rrugor Shqiptar, sikurse vihet re edhe nga “Kërkesë për bashkëpunim”, Nr. Prot. 195, datë 03.04.2018, të firmosur nga z. Orges Feimi.

Por aksesimi për në Parkun Arkeologjik të Orikumit përshtafaqet problematik për një tjeter aspekt, atë të hyrjes së detyrueshme për në park, nëpërmjet territorit të Bazës Ushtarake të Pashalimanit, si e tillë zonë e ndaluar nga rregulla strikte.

Sikurse rezulton nga evidenca e auditimit, lidhur me problemin e lartpërmendur, DRKK Vlorë i komunikon MK-së se: “.... në muajin janar (ndr. 2016) në Bazën Ushtarake të Pashalimanit, u zhvillua një takim me komandantin e kësaj baze, z. Ferdinand Kreshpani. Qëllimi i këtij takimi ishte rinnovimi i marrëveshjes për bashkëpunim, lidhur me lehtësimin e hyrjes së vizitorëve të huaj dhe vendas nëpërmjet postbllokut të Bazës Ushtarake, për në Parkun Arkeologjik të Orikut, sipas praktikave që kemi ndjekur dy vitet e fundit për këtë problem.”¹³⁸.

Me anë të shkresës Nr. Prot. 65, datë 12.01.2016, lidhur me këtë çështje, komandanti i kësaj baze i bën me dije DRKK-së Vlorë, se: “Përsa i përket miratimit të akt - marrëveshjes, nuk mund të nënshkruhet nga ana jonë (ndr. Baza Ushtarake e Pashalimanit), por nga instanca më e lartë, Komanda Eprore dhe në mënyrë institucionale midis Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, me kushte respektive, pa cënuar sigurinë e repartit.”.

Po ashtu, komunikohet se: “Gjithashtu Baza Ushtarake ka lëshuar për personelin e postbllokut një Urdhër të Brendshëm Nr. 7, më datë 15 janar 2016, ku thuhet shprehimisht, se nuk lejohet hyrja e vizitorëve në parkun arkeologjik, shtetas shqiptar dhe të huaj.”¹³⁹,

Një muaj më vonë është nënshkruar Akt – Marrëveshja, me objekt: “Bashkëpunimi për menaxhimin e hyrjes së vizitorëve vendas dhe të huaj nëpërmjet postbllokut të Flotiljes Detare të Pashalimanit për në Parkun Arkeologjik të Orikut”¹⁴⁰.

Kjo marrëveshje përcakton rregulla të veçanta për hyrjen e vizitorëve në sitin arkeologjik, duke parashikuar se hyrja do të bëhet çdo ditë nga 08.00 – 19.00, vetëm me dokument identifikimi, pasi gjeneralitetet dhe targat e makinave shkruhen në një regjistër të posaçëm që mbahet nga postblloku. Hyrja e shtetasve te huaj, sipas marrëveshjes në fjalë, do të bëhej me listë të

¹³⁷ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹³⁸ Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 73, datë 21.01.2016

¹³⁹ Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 73, datë 21.01.2016

¹⁴⁰ Akt – Marrevjeshja Nr. Prot. 702, datë 25.02.2016

përgatitur dhe të firmosur nga punonjësi i parkut arkeologjik. Akt – marrëveshja kishte gjashtë nene.

Në tetor 2016, Komanda e Forcave Detare, i njofton DRKK – në Vlorë, se “Akt – marrëveshja (ndr. e lartpërmendur).... është revokuar që prej datës 15.10.2016. Duke filluar nga data 15.10.2016 deri në rishikimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje të re me procedurë standarde veprimi të detajuara, vizitorët vendas dhe të huaj të parkut arkeologjik të Orikut, nuk do të lejohen të hyjnë nga postblloku i Flotiljes Detare të Pashalimanit.¹⁴¹”

Në janar 2017 Komanda njofton se: “Ministria e Mbrojtjes në kuadër të forcimit të masave të sigurisë për parandalimin e veprimeve terroriste apo aktiviteteve të paligjshme në vendbazimet detare, objektet dhe infrastrukturën ushtarake, ka miratuar më 22 dhjetor 2016 Procedurën Standarde të Veprimit “Per pajisjen me lejekalimi transit të personave të huaj dhe vendas që vizitojnë Parkun Arkeologjik të Orikumit, si dhe..... (SOP209/1).”¹⁴²

SOP209/1 parashikonte detyrime strikte dhe të tilla që vinin në vështirësi konkrete stafin e parkut arkeologjik për të përbushur detyrimet procedurale të parashikuara për hyrjen e vizitorëve. Detyrimi i shoqërimit konstant të të gjithë turistëve, përgjatë gjithë vizitës, përkthehej në një vështirësi ekstreme, për të mos thënë edhe në pamundësi reale për personelin e pakët dhe të pamjaftueshëm në numër, të këtij siti.

Pikërisht për vështirësitë që krijuan procedurat e lartpërmendura, në shkurt 2018 MK njoftonte DRKK - në Vlorë, se: “Ministria e Kulturës“ do të kërkojë një takim pune me përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes për të diskutuar variante të aksesit të lehtësuar për turistët e huaj në parkun arkeologjik të Orikut, gjatë sezonit turistik veror.”¹⁴³

Vështirësitë e krijuara nga respektimi i procedurave të hyrjes të miratuara, në akt – marrëveshjet e nënshkruara në vijimësi janë bërë pjesë e komunikimeve dhe shqetësimit të ndarë në mes të titullarëve të MK - së dhe MM – së.

Në shkresën Nr. Prot. 154/2, e datës 03.02.2017, Ministria e Kulturës i bënte me dije Ministres së Mbrojtjes se: “Sipas DRKK - së Vlorë kjo procedure e re e cila ngarkon për zbatim DRKK – në Vlorë pengon shfrytëzimin për qëllime turistike të parkut. Dokumentacioni dhe procedura e tejzgjatur vështirëson dhe pengon hyrjen e turistëve ditore, që përbëjnë kontingjentin kryesor vizitues të parkut, të vizitorëve të huaj, si dhe të studentëve që aksesojnë parkun për qëllime mësimore/studimore.”.

Në përgjigjen e saj dërguar Ministres së Kulturës, Ministria e Mbrojtjes nën vizonte: “Për të pasur akses në parkun e Orikumit, pa kaluar nga objektet ushtarake, Ministria e Mbrojtjes vlerëson, se për zgjidhje afatgjata ekzistonjë mundësi bashkëpunimi me pushtetin lokal, ndërsa me pak përmirësimë infrastrukturore, rrugëkalimi në pjesën juglindore të parkut arkeologjik të Orikumit (skema bashkëlidhur), është një zgjidhje alternative.

Ministria shprehet e gatshme të japë kontributin e saj me mjete xheniere për hapjen dhe zgjerimin e një pjesë rruge prej rrith 1 km. Ndërkohë që nevojitet bashkëpunimi Juaj me pushtetin lokal për ndërtimin e një ure druri rrith 250 metra, që do t'i shërbente zgjidhjes përfundimtare të kalimit të vizitorëve në parkun e Orikumit.”¹⁴⁴.

Sikurse informohemi nga DRKK Vlorë: “Gjatë vitit 2018 u dakortësua sa vijon:

¹⁴¹ Shkresa e Komandës së Forcave Detare, Nr. Prot. 4129, datë 21.10.2016

¹⁴² Shkresa e Repartit Ushtarak 2004, Nr. Prot. 1795/2, datë 20.07.2018

¹⁴³ Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të MK, Nr. Prot. 635/1, datë 09.02.2018, drejtuar DRKK Vlorë

¹⁴⁴ Shkresa e Ministres së Mbrojtjes, Nr. Prot. 2114, datë 03.04.2017, drejtuar Ministres së Kulturës

Vizitorët të pajisen me biletë në portën hyrëse në Pashaliman nga personeli i DRKK - së Vlorë. Personeli i Bazës Ushtarake në rrugën kryesore, të orientojë turistët në drejtim të Parkut, ku priteshin nga personeli i Parkut;

Polici Ushtarak në Postbllokun e Pashalimanit, është autoriteti i vetëm që mund të autorizojë të drejtën e kalimit për në P. A. Orik të vizitorëve vendas dhe të huaj. Lejimi të bëhej përkundrejt regjistrimit të një dokumenti identifikimi për personat dhe targa për automjetet;

Për vizitorët e huaj të regjistrouar nuk aplikohet mbajtja e ID ose pasaportave;

Për vizitorët me kombësi shqiptare të regjistrohet personi përgjegjës, i cili mund të ishte guida, kryefamiljari, mësuesi, etj. si dhe numri i tyre;

Për automjetet të regjistrohet targa;

Vizitorët e pajisur me biletë dhe të regjistrouar të qarkullojnë në këmbë deri në hyrje të Parkut;

Nuk u aplikua detyrimi për P. A. Orik për të hartuar dhe dorëzuar një listë të vizitorëve, kjo pasi vizitorët nuk janë të gjithë të programuar dhe shpesh herë paraqiten spontanisht në postbllok;

Zgjatja e periudhës së zbatimit të masave të dakortësuara për periudhën 1 maj – 15 tetor, nga e hëna në të dielë, në oraret 09:00– 18:00.

Duke vlerësuar rëndësinë e zbatimit të procedurës SOP 209/3 në bazën e Pashalimanit, në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik veror, deri në arritjen e një zgjidhje përfundimtare të çështjes së hyrje/daljeve të turistëve vendas e të huaj nëpërmjet postbllokut Nr. 1 të Flotiljes Detare Pashaliman, Ministria e Kulturës ka kërkuar pranë Ministrisë së Mbrojtjes vijimin e zbatimit të masave lehtësuese për hyrjen e vizitorëve në park të dakortësuar në vitin 2018.

Gjithashtu DRTK Vlorë ka bërë të gjitha përpjekjet ndaj institucioneve përkatëse për liberalizimin e hyrjes së vizitorëve vendas dhe të huaj nëpërmjet Postbllokut Ushtarak të Pashalimanit për në parkun arkeologjik të Orikumit.¹⁴⁵

Gjatë inspektimeve të zhvilluara në terren edhe nga Grupi i Auditimit, ***u konstatua procedura e vështirë dhe e tejzgatur për hyrjen në parkun arkeologjik të Orikumit***

Foto 1: Hyrja për në bazën ushtarake të Pashalimanit dhe në P. A. të Orikumit



Burimi: Fotografuar nga Grupi i Auditimit në shtator 2020

Lidhur me **Parkun e Butrintit**, i cili ndodhet përgjatë rrugës nationale Sarandë - Qafë Botë vlerësohet se, gjendja e rrugës është e mirë, meqë ajo është rikonstruktuar gjatë viteve 2009-2010.

Sa i përket një tjetër lehtësimi për një shfrytëzim publik të sítave arkeologjike në mënyrë sa më të përshtatshme, është edhe sinjalistika rrugore, e cila orienton vizitorët drejt tyre.

¹⁴⁵ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Në parkun **P.A.K Butrint** gjendja e sinjalistikës rrugore dhe tabelave informuese është kryesisht i mirë, duke marrë në konsideratë dhe faktin që siti është pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO - s.

Në përgjithësi, ajo rezulton e mjaftueshme dhe e dukshme, duke siguruar orientim të zhdërvjelltë.

Mangësitë që ekzistojnë në sinjalistikën rrugore janë vënë në dukje nga NJAKPA – të që administrojnë sitet përkatëse.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit të përgatitur nga grupi i auditimit: “**Sinjalistika rrugore në drejtim të P. A. Apoloni nuk është e mjaftueshme. Për këtë arsyen NJAKPA Apoloni dhe Bylis ka bërë kërkesa të vazhdueshme ARRSH-së.**

Sinjalistika rrugore që orienton drejt **parkut arkeologjik Orikut** është ekzistuese.


Në rastin e **P. A. Amantia** ajo është pasuruar me sinjalistikë shtesë nga ana e DRTK – së Vlorë dhe pritet të vihet sinjalistikë e re në kuadër të projektit “Reabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”.

Gjithashtu në **P. A. Amantia** është vendosur sinjalistikë në kuadër të zbatimit të programit kombëtar “100 Fshatrat”¹⁴⁶.

Tabela e cila ra në sy gjatë inspektimeve në terren, meqë jo e standardeve të miratuara dhe të vendosura nga ARRSH - ja, ishte tabela “rrugore” që orientonte vizitorët e P. A. të Amantias, për të lënë rrugën e Lumit të Vlorës dhe për t'u ngjitur në drejtim të kodrës ku ndodhet siti arkeologjik.

Në fakt sikurse na u komunikua nga Drejtori i DRKK - së Vlorë edhe gjatë bashkëbisedimit me grupin e auditimit, në mungesë të tabelës dhe për shkak të vonesave të ARRSH - së, për të mos lënë vizitoret pa orientim, ai kishte porositur dhe vendosur një tabelë vetë privatisht, duke marrë po ashtu përsipër privatisht kostot e prodhimit dhe vendosjes. Është për t'u vlerësuar nisma e Drejtorit të DRKK - së Vlorë dhe po ashtu kriteri estetik me të cilin kishte realizuar tabelën, pavarësisht se zgjidhja duhet të vijë nga ARRSH – ja.

Foto 2: Tabela e cila orienton drejt parkut të Amantias



Burimi: Fotografuar nga Grupi i Auditimit në shtator 2020

Gjate procesit të auditimit është konstatuar se disa nga sitet mund të arrihen nga vizitorët edhe me mjete publike, të cilat mbulojnë këtë shërbim përfshiktë të transportit të udhëtarëve që lëvizin ndërmjet qendrave të banuara.

Realisht asnjëri nga sitet nuk mbulohet nga mjete të transportit publik, që kanë si destinacion të mirëfilltë këto site. Gjithsesi janë të mbuluara tërthorazi me transport, nga mjete publike, Butrinti, Apolonia dhe deri afér sitit arkeologjik, edhe Orikut.

¹⁴⁶ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Nga ana e MK – së thuhet se: “*Asnjë nga sitet nuk disponon mjete për transportin e vizitorëve nga qendrat e banuara në drejtim të parqeve arkeologjike. Vlerësohet se prania e këtij shërbimi do të ndihmonte në përmirësimin e ofertës turistike tek vizitorëve.*”¹⁴⁷.

Parqet arkeologjike shqiptare janë vërtetë të një bukurie të veçantë. Disa prej tyre pozicionohen në koordinata dominuese, duke ofruar një panoramë mbresëlënëse. Brenda tyre *gjen histori* dhe *grenari*, të cilën jo radhëherë e zbehin situata të tjera.

Në parkun arkeologjik të Amantias, i cili ndodhet në afërsi të fshatit Plloçë, ka një problematikë të përhershme dhe të njohur nga të gjithë. Brenda parkut të Amantias, i cili mirëmbahet goxha mirë nga punonjësit e DRKK Vlorë, ka disa shtëpi të banuara, dhe po ashtu, veç këtyre shtëpive, *ka edhe disa stane dhënshe*.

Foto 3: Parku arkeologjik i Amantias



Burimi: Fotografi nga Grupi i Auditimit në shtator 2020

Pikërisht kjo zgjidhje ekonomike që u garanton banorëve mundësinë për të mbijetuar, reflektohet edhe me përdorimin pa kriter të hapësirave të cilat janë pjesë e sitit. Janë të shumta dhe të dukshme parcelat të zaptuara brenda Zonës Arkeologjike të Kategorisë A, të cilat këta banore i përdorin si stane.

DRKK Vlorë ka vënë në dispozicion një mori dokumentesh shkresorë, të cilat provojnë të gjithë aktivitetin denoncues dhe sensibilizues, kundër paligjshmërisë së konsumuar nga shtetasi P. A. dhe disa shtetas të tjerë, duke ndërtuar stane.

DRKK Vlorë ka komunikuar dhe marrë përgjigje për denoncimin e problemeve të staneve, me shkresat:

Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 295, datë 25.08.2018 dhe “Procesverbal denoncimi”;

Vendim i Prokurorisë Vlorë, Nr. Prot. 1439, datë 15.11.2016, për “Mosfillim procedimi”;

Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 524, datë 05.12.2016 me “Kërkesë për mbështetje”, dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë;

Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 225, datë 10.05.2016, me “Venie në dijeni”, dërguar MK;

Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 466, datë 25.10.2016, me “Kërkesë për mbështetje”, dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë;

Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 467, datë 25.10.2016, me “Kërkesë për ndërhyrje”, dërguar Kryetarit të Bashkisë Selenicë;

Shkresa e DRKK Vlorë, Nr. Prot. 468, datë 25.10.2016, me “Kërkesë për mbështetje”, dërguar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Tiranë; e shumë, e shumë shkresa të tjera.

¹⁴⁷ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Foto 4: Stane brenda P. A. të Amantias



Burimi: Fotografuar nga Grupi i Auditimit në shtator 2020

Një tjetër lehtësim për një shfrytëzim publik të siteve arkeologjike në mënyrë sa më të përshtatshme nga ana e vizitorëve, për te cilin ka nevojë të menjëherëshme për ndërhyrje në disa parqe, është *edhe pajisja e tyre me hapësira parkingu të mjaftueshëm*.

Sikurse edhe informohemi zyrtarisht, rezulton se: "Parqet arkeologjike Apoloni dhe Bylis kanë infrastrukturë për parkimin e mjeteve, të organizuar në dy mënyra.

P. A. Apoloni ka dy parkime, një në pjesën e sipërme të parkut, i cili është i mjaftueshëm në hapësirë, por jo në cilësi. Parkimi i dytë (i realizuar nga projekti i financuar me fonde të Bashkimit Evropian) ndodhet afér murit rrithues, në zonën perëndimore dhe aktualisht nuk është në funksion pasi pritet lidhja me Bypass - in dhe hapja e një rruge të re.

P. A. Bylis nuk ka parkim jashtë parkut dhe as brenda tij. Parkimi i automjeteve realizohet në zonën hyrëse të tij, ku ka një hapësirë të mjaftueshme momentalisht, për fluksin aktual.

Për momentin parqet Apoloni dhe Bylis nuk kanë nevojë për hapësira të tjera parkimi.

Të dy parqet Amantia dhe Orikut kanë struktura të mjaftueshme parkimi për mjetet e vizitorëve."¹⁴⁸

Ky është vlerësimi i NJAKPA – ve që njohin konkretisht gjendjen dhe e ndjekin atë në përditshmërinë e aktivitetit të pritjes së vizitorëve.

Ndërkohë që për **Parkun Kombëtar të Butrintit** gjendja është ndryshe.

Sikurse komunikuar nga Parku Kombëtar i Butrintit: "*Për Parkun Kombëtar Butrint hapësira aktuale për parkimin është e pamjaftueshme gjatë pikut të sezonit turistik veror*, nevojë e cila është reflektuar edhe në Planin e menaxhimit të integruar të Parkut Kombëtar Butrint (i miratuar së fundmi me VKM) i cili ka parashikuar ndërtimin i një parkimi të ri për vizitorët."¹⁴⁹

"Kjo nevojë për hapësira parkimi bëhet më e mprehtë në ditët e verës kur fluksi ditor arrin edhe në 3.000 vizitorë në ditë, ndërkohë që vende parkimi aktualisht mund të numërohen afro 100 të tilla, përballet hyrjes së Parkut dhe anash rrugës. Do ishte mirë që së paku të shtoheshin edhe 100 vende të tjera parkimi."¹⁵⁰

Sikurse rezulton edhe nga proces – verbali i mbajtur gjatë mbledhjes së Bordit të Parkut Kombëtar të Butrintit vitin e kaluar, problematika e mungesës së vendeve të parkingut është adresuar në mënyrë shumë të qartë. Gjate kësaj mbledhjeje, Drejtori Zhonga i PKB, vinte në

¹⁴⁸ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁴⁹ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁵⁰ Interviste me Drejtorin e PKB, datë 13.10.2020

dukje se: "Vitin e kaluar shtuam një polic që të mos lejonte parkimin aty. Autobusët ndalonin vetëm për të zbritur turistët."¹⁵¹

Sa i përket shërbimit të biletarisë konstatohet se:

Në parkun arkeologjik Apoloni shërbimi i shitjes së biletave ndodhet pranë Manastirit mesjetar dhe në hyrje të zonës monumentale. Biletat janë elektronike dhe manuale.

Në parkun arkeologjik Bylis biletat janë manuale dhe priten në territorin e parkut.

Në parkun arkeologjik Orikum biletat shiten në hyrje të bazës ushtarake së Pashalimanit

Në parkun arkeologjik Amantia biletat shiten në hyrje të parkut.

Në Parkun Kombëtar Butrint biletat shiten në sportelin e biletarisë në hyrje të Parkut.

Nga intervistat, takimet si dhe evidenca e auditimit, konstatohet se në Parkun Kombëtar Butrint problemi i radhëve të gjata në biletari është shumë i mprehtë. Kjo u konstatua edhe gjatë referimit të z. Kamenica, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në mbledhjen e Bordit të Parkut Kombëtar të Butrintit, më datë 05.04.2019.

Krijimi i lehtësive, si: shitja e pijeve freskuese, krijimi i këndeve të shitjes së souvenireve dhe prodhimeve të zonës, gatishmëria e shërbimeve higjenike, janë një tjetër objektiv ku duhet të drejtohet vëmendja e NJAKPA – ve, për t’iu përgjigjur nevojave të vizitorëve të siteve dhe interesit ekonomik të komuniteteve, të cilat jetojnë pranë parqeve arkeologjike.

Në **parkun arkeologjik Apoloni** ndodhen dy restorante:

- Bar restorant Leon Rey në marrëdhënie kontraktuale me PA/MK ;
- Bar restorant Apolonia është në pronësi private dhe në marrëdhënie kontraktuale me Ministrinë e Financave dhe Ekonominë.

Ambientet e shërbimit higjeniko-sanitare në P. A. Apoloni ndodhen në ambjentet e manastirit mesjetar.

Në **parkun arkeologjik Bylis** operon një shërbim privat i cili ofron shërbim restoranti dhe mbulon nevojat higjeniko-sanitare të vizitorëve.

Në **Parkun Kombëtar Butrint** në qytetin antik ka shërbime bar, sanitare dhe në periudhën e sezonit turistik veror, funksionon "këndi SAL – Souvenir, Art & Libra) i njojur ndryshe si Dyqani i Komunitetit.

Ndërkohë në parqet Amantia dhe Orikum nuk është mundësuar ende një shërbim higjeniko - sanitar, për shkak të mungesës së fondeve të buxhetit.

Justifikimi i dhënë lidhur me mungesën e shërbimeve higjeniko – sanitare në këto dy site nga MK, është si në vijim: "E para një investim i tillë kërkon një ndërhyrje komplekse për ngritjen e infrastrukturës, si dhe e dyta, nevojave imediate që kanë pasur mbi 200 Monumente Kulture në përgjegjësi administrimi të DRTK Vlorë, disa prej të cilave në listë risku, e kanë bërë të pamundur një investim të tillë në parqet arkeologjike."¹⁵²

Po ashtu, gjatë inspektimeve në terren është konstatuar, *se edhe në Parkun Kombëtar Butrint gjendja e shërbimeve higjeniko – sanitare në Kala është shumë e degraduar dhe që numri i përgjithshëm i njësive sanitare, është poshtë nevojave efektive.* Edhe në mbledhjen e Bordit të Parkut Kombëtar Butrint, të datës 05.04.2019 u vu theksi tek shqetësimi i mungesës së toualetave.

Nga ana e MK lidhur me krijimin e mundësisë së pranisë të operatorëve tregtarë është komentuar si më poshtë: "Stimulimi i pranisë së operatorëve tregtarë të sektorit hoteleri-restoran nuk është në fushë kompetence të Ministrisë së Kulturës. Sektori hoteleri – turizëm dhe aktivitetet e lidhura

¹⁵¹ Procesverbal i mbledhjes së Bordit të Parkut Kombëtar Butrint, mbajtur më 05.04.2019

¹⁵² Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

me të, janë fushë kompetence e Ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe institucioneve të pushtetit vendor.”¹⁵³.

Pritshmëritë e vizitorëve lidhen më së shumti me marrjen e informacionit lidhur me vlerat historiko – kulturore që sitet bartin.

Një pjesë e tyre vjen relativisht e informuar mbi këto vlera dhe vizita është një rast për t'i parë dhe prekur drejtpërdrejtë këto pasuri.

Një pjesë e vizitorëve vjen e organizuar me programet e tour operators – ve, të cilët kanë edhe guidat e tyre që jasin shpjegimet e rastit.

Por sigurisht nevoja e një pjese jo të vogël vizitorësh, për t'u shoqëruar dhe marrë informacion nga guidat/cicëronët e siteve mbetet e patjetërsueshme. Ndaj në këtë plan sitet kanë një detyrim thelbësor që t'i përgjigjen kësaj nevoje.

Duke iu referuar evidencës audituese konstatahet sa më poshtë:

Numri total i punonjësve për vitin 2016-2019 ka qenë sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tabela 8: Numri i të punësuarve në parqet arkeologjike

Institucioni	2016	2017	2018	2019
ZAKPA-Apoloni	11	11	11	14
ZAKPA-Bylis	5	5	5	0
ZAKPA-Butrint	14	14	14	14
DRTK-Vlorë (Sektori i Parqeve Amantia-Otikum-Finiq)	10	10	10	10

Burimi: Të dhëna të ofruara nga Ministria e Kulturës

Funksionet e parashikuara përkatesisht për këta punonjës janë si më poshtë:

Për Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkelogjik – Apoloni për vitin **2016-2018:**

Drejtor	1
Përgjegjës sektori	2
Specialist	2
Punëtor mirëmbnjatje	4
Biletashitës	1
Punonjës pastrimi	1

Për Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkelogjik – Bylis për vitin **2016-2018:**

Drejtor	1
Specialist	1
Punëtor mirëmbnjatje	3

Për Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkelogjik – Apoloni dhe Bylis për vitin **2019**

¹⁵³ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Drejtor	1
Përgjegjës sektori	3
Specialist	1
Punëtor mirëmbyatje	7
Biletashitës	1
Punonjës pastrimi	1

Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkelogjik – Butrint për vitin 2016-2019

Drejtor	1
Përgjegjës sektori	2
Specialist	4
Punëtor mirëmbyatje	6
Biletashitës	1

DRTK- Vlorë (Sektori i parqeve Amantia-Otikum-Finiq) për vitin 2016-2019

Përgjegjës sektori	1
Specialist (Arkeolog)	3
Punëtor mirëmbyatje	6

Vetë MK shprehet se: “**Në strukturën dhe organikën e PA/SA nuk parashikohen pozicione me detyrë funksionale vetëm shoqërimin e vizitorëve.**”¹⁵⁴.

Rrjedhimisht, gjithnjë sikurse referuar nga MK: “Në parqet arkeologjike **Apoloni e Bylis, përgjegjësit e Sektorëve Arkeologji**, të Bylisit dhe Muzeut kryejnë funksionin e shoqërimit të vizitorëve apo të delegacioneve, si dhe dhënien e informacioneve mbi vlerat historike kulturore të parkut.

Ndërsa në ZAKP-Butrint, këto funksione kryhen nga specialisti, i cili është i përfshirë në strukturën dhe organikën e institucionit.

Këto funksione shtohen me punonjës me kontratë për gjatë sezonit turistik për shkak të fluksit të turistëve.

Në parqet arkeologjike **Amantia dhe Orikum** shoqërimi i vizitorëve bëhet nga **specialistët e parkut.**¹⁵⁵.

Duke vijuar me informacionin e saj, MK vë në dukje se: “**Funksionet e ciceronit dhe guidës në PA/SA janë funksione që mbulohen nga specialistët e siteve sipas strukturës dhe organikës së institucionit. Por në sezonin turistik për shkak të fluksit të vizitorëve, këto funksione nuk arrijnë të mbulohen tërësisht.** Si e tillë, me kërkesë të institucionit përcaktohen dhe *miratohen çdo vit, punonjës sezonal, me kontratë të përkohshme pune, me profil: Ciceron dhe guidë.*”¹⁵⁶.

Këshilli i Ministrave në bazë të kërkesave për punonjës sezonal me kontratë të përkohshme pune, përcakton dhe miraton numrin e punonjësve për çdo njësi të qeverisjes vendore dhe qendrore.

Parqet arkeologjike, kanë punësuar të rinj pranë institucioneve të tyre, në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

Sipas informacionit të ardhur nga MK, kjo organikë është rritur përkatësisht për vitin 2016-2017-2018-2019, në fluksin e vizitorëve, sipas tabelës sa më poshtë:

Tabela 9: Numri i të punësuarve sezonalë në parqet arkeologjike

¹⁵⁴ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁵⁵ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁵⁶ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Institucioni	2016	2017	2018	2019
ZAKPA - Apoloni	+2 vëzhgues	+2 vëzhgues (Cicéron/ guide) +1 punëtor pastrimi	+2 vëzhgues (Cicéron/ guide) + 1 punonjës pastrimi	+ 2 vezhgues (Cicéron/ guide) + 1 punonjës pastrimi
ZAKPA - Bylis	+1 punëtar mirëmbajtje	+1 punëtor mirëmbajtje	+ 1 punëtor mirëmbajtje	+ 1 punëtor mirëmbajtje
ZAKPA - Butrint	+2 vëzhgues (Cicéron/ guide) + 3 punonjës mirëmbajtje + 1 biletashitës	+2 vëzhgues (Cicéron/ guide) + 3 punonjës mirëmbajtje + 1 biletashitës	+ 1 vëzhgues(Cicéron/ guide) + 2 punëtor mirëmbajtje	+ 3 punetor mirembajtje
DRTK - Vlorë (Sektori i Parqeve Amantia-Otikum-Finiq	0	+1 ciceron	+ 1 punëtor mirëmbajtje	+ 1 punëtor mirëmbajtje

Burimi: Të dhëna të ofruara nga Ministria e Kulturës

Nga të dhënat mbi rekrutimet e punonjësve sezonal për shërbimin e guidës vihet re se ka site dhe vite, që nuk shënojnë asnjë punësim, pavarësisht rritjes së fluksit të vizitorëve.

Një standard i rëndësishëm në parqet arkeologjike që kontribuon në mbarëvajtjen e vizitave të historidashësve është edhe pajisja e zonave, reperteve dhe monumenteve të sive me tabela orientuese dhe informuese.

Gjatë inspektimeve në terren u konstatua, se një pjesë e realitetit tonë arkeologjik, ka sinjalistikë të mjaftueshme për shpjegimin e tij.

Kështu, gjatë auditimit u konstatua se, **Parku Kombëtar Butrint** ka tabela informuese të qarta dhe të mjaftueshme, si në hyrje të qytetit antik, ashtu dhe për çdo monument përgjatë intinerarit në Park.

Sinjalistikë orientuese dhe informuese të mjaftueshme për shpjegimin e tij ka edhe **P. A. Apoloni**.

Ndërkohë që, *sikurse u konstatua nga grupi i auditimit gjatë inspektimeve në terren dhe u vu në dukje edhe nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nga MK, parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikut kanë sinjalistikë informuese i cili gjithsesi ka nevojë përmirësim.*

Totalisht ndryshe është situata në *P. A. Bylis. Në këtë sit arkeologjik mungojnë totalisht, që nga viti 2019, të gjitha tabelat e brendshme orientuese dhe shpjeguese të monumenteve dhe reperteve arkeologjike.*

Sikurse informohemi nga ana e ZAKPA Bylis: "Vendosja e tabelave në Bylis do të realizohet brenda këtij viti, pas marrjes përfundimtare të miratimit nga ana e Këshillit Kombëtar të Trashgimisë Kulturore në MK, pas diskutimeve me Institutin e Arkeologjisë, i cili i ka përrishqyrtim."¹⁵⁷

Administrimi i marrëdhënieve me publikun nga një ekspert për këtë sferë marrëdhëniesh, bëhet një komponente e rëndësishme përsuksesin dhe mirëadministrimin e siteve arkeologjike.

Sikurse u vu re gjatë auditimit dhe u saktësua edhe nga vetë subjektet, në strukturën organizative të ZAKPA Apoloni dhe Bylis, Parkun Kombëtar Butrint dhe DRTK Vlorë, nuk ka të parashikuar një pozicion specifik të dedikuar për kryerjen e detyrave që lidhen me marrëdhëniet me publikun. Aktiviteti realizohet nëpërmjet specialistëve dhe titullarit të institucioneve.

Me rritjen e vizitueshmërisë së këtyre siteve administrimi i marrëdhënieve me publikun fiton një status dhe rëndësi të veçantë.

Eksperti për marrëdhëniet me publikun duke patur këtë funksion të dedikuar vetëm kesaj sfere marrëdhëniesh, ka mundësi të receptojë nevojat e vizitorëve, vlerësimet, sugjerimet, pakënaqësitë, duke i bërë pjesë të një inventari informacionesh i cili do ndihmojë sitet, që të programojnë punën dhe qasjen në funksion të të ofruarit të një shërbimi edhe më cilësor. Po ashtu, ai do të ishte figura që do të aktivizohej edhe për nxitjen e vëmendjes së tour operators – ve, duke kërkuar dhe krijuar një mundësi edhe më të suksesshme bashkëpunimi.

Mbulimi i këtij shërbimi, nga specialistët dhe titullarët e institucioneve administrues të parqeve, pa parashikimin e një pozicioni të dedikuar specifik në sitet arkeologjike shqiptare, e zbeh mundësinë e realizimit me efektivitet të këtij aktiviteti.

Në studimin e tij voluminoz, Prof. Sebastiano Tusa, "Menaxhimi Fiskal dhe Struktura Drejtuese e Sistemit të Parqeve Arkeologjike në Shqipëri"¹⁵⁸, e konsideron mosparashikimin në organigramën e NJAKPA - ve të funksionit "Ekspert për marrëdhëniet me publikun", si një mungesë thelbësore, e cila duhet korriguar në të ardhmen.

Sugjerimi i Prof. Tusa – s, duke qenë ai një ekspert i sektorit, origjinohet nga njohuritë që ka, duke iu referuar përvojave dhe praktikave të konsoliduara dhe më të mira botërore.

Proceset e zhvillimit dhe adaptimit me kërkesat dhe standartet e kohës, lidhur me shërbimet e parashikuara në favor të vizitorëve të siteve, duhet *të nxisin NJAKPA – të si institucione varësie dhe Ministrinë e Kulturës që të studiojnë dhe vlerësojnë mundësinë e përdorimit të teknologjisë së audioguidave dhe videoguidave, në mbështetje të vizitorëve.*

Duke patur parasysh se në periudhën e fluksit maksimal, numri i vizitorëve rritet eksponencialisht (edhe rreth 3000 veta në ditë në Butrint), ndërkohë që mbështetja dhe shoqërimi i tyre bëhet i pamundur që të mbulohet nga stafet e NJAKPA – ve, ndaj është më se i domosdoshëm vlerësimi i nevojave të turistëve në këtë plan dhe rrjedhimisht, parashikimi i përfshirjes së kësaj teknologjië në ndihmë të tyre. Deri më tani, lidhur me futjen e teknologjisë në mbështetje të vizitave të turistëve Ministria e Kulturës ka mbështetur projektin Albania Virtual Tour - "*Turi Virtual i Monumenteve të Shqipërisë*". "Ky projekt ka si synim promovimin e monumenteve të kulturës shqiptare, si dhe thjeshtësimin e aksosit të tyre për

¹⁵⁷ Informacion i ardhur me e-mail, më datë 7 tetor 2020

¹⁵⁸ <http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/FIELD/Venice/pdf/news/unesco%20shqip.pdf>

turistët dhe qytetarët, duke krijuar mundësinë e prekjes virtuale nëpërmjet fotove, materialeve audio, video 360° dhe VR – Virtual Reality.

Turi përmban një historik i shkurtër për çdo monument, i cili lexohet dhe regjistrohet në studio nga narratorë profesionistë në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Përshkrimet historike të secilit monument kthehen kështu në spote audio në dy gjuhë, të cilat shërbejnë si “audiobook.”¹⁵⁹. Gjithsesi *ky projekt, nga parqet arkeologjike të audituara, përfshin vetëm P. A. Apoloni*, ndërkohë që edhe kjo nismë nuk u ofron asnje asistencë vizitorëve të parqeve në terren.

Gjetje:

- Gjendja e degraduar e rrugës i bën shumë të vështira vizitat e turistëve në parkun arkeologjik të Bylisit.
- Procedurat dhe kriteret që duhet të përbushen për të pasur akses në parkun arkeologjik të Orikumit, janë një pengesë e madhe për turistët dhe një mundësi më pak, për t'u siguruar vizitorëve një qasje atraktive me këtë aset historiko – kulturor.
- Ka pamjaftueshmëri tabelash orientuese për në parkun arkeologjik Apoloni, si dhe mungon tabela rrugore standarde, që orienton vizitorët për te lënë rrugën e Lumit të Vlorës dhe për t'u ngjitur në drejtim të kodrës, ku ndodhet siti arkeologjik i Amantias.
- Lëvizja e vizitorëve për në sitet e largëta të Bylisit dhe të Amantias nuk është e mbuluar aspak nga linjat e transportit publik. Ndërkohë Ligji 27/2018¹⁶⁰ shprehet qartë se si bashkëpunohet në nivele të ndryshme lidhur edhe me sitet arkeologjike: “Autoritetet shtetërore qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkërendojnë punën, koordinojnë, harmonizojnë dhe integrojnë aktivitetet, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe krijojnë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.”¹⁶¹
- Ajo që konstatohet nga materiali i studiuar dhe nga inspektimet në terren, pranë P. A. Amantia është moskoordinimi ndërinstitucional për të zgjidhur në themel çështjen e staneve të ngitura në këtë sit, pavarësisht zellit dhe përkushtimit të DRKK –së Vlorë. Prania e staneve është duke degraduar mjedisin dhe duke krijuar vështirësi të papranueshme për vizitorët, të cilët duhet të kalojnë në parcela të kufizuara nga gardhet e tyre dhe që kutérbojnë erë të keqe.
- Në Parkun Kombëtar të Butrintit ka mungesë të ndjeshme vendesh parkimi për makinat dhe autobusët, me të cilat udhëtojnë vizitorët. Çështja është diskutuar në të gjitha nivelet dhe duhet të marrë një zgjidhje përfundimtare, duke qenë e përfshirë edhe në Planin e Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar Butrint 2020 - 2030
- Në Parkun Kombëtar Butrint problemi i radhëve të gjata në biletari është shumë i imprehtë dhe krijon shqetësim tek vizitorët.
- Mungojnë krejtësisht shërbimet higjeniko – sanitare në parkun arkeologjik të Orikumit dhe në parkun arkeologjik të Amantias. Ndërkohë që në këto dy parqe mungojnë edhe linjat elektrike. Ndërsa Parku Kombëtar Butrint ka nevojë të restaurojë shërbimet higjeniko – sanitare tek Kalaja dhe të instalojë nyje higjenike të reja, sikurse konstatuar dhe vënë në dukje kjo domosdoshmëri edhe në mbledhjet e Bordit Kombëtar të Parkut të Butrintit.

¹⁵⁹ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁶⁰ Ligji 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”

¹⁶¹ Ligji 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 11, Paragrafi 2

- Përjashtuar Parkun Kombëtar Butrint, në parqet e tjera arkeologjike mungojnë këndet e shitjes së souvenireve, pijeve freskuese dhe prodhimeve të zonës. Nxitja dhe përfshirja në njësitë tregtuese, që mund të bëhen pjesë e këtyre realitetave turistike, e operatorëve që shesin souvenire dhe produkte vendase sezonalisht, do ishte një ndihmë dhe mundësi ekonomike për komunitetet lokale.
- Në strukturën dhe organikën e parqeve arkeologjike, nuk parashikohen pozicione me detyrë funksionale, vetëm shoqërimin e vizitorëve.
- Edhe në raport me rekrutimet e punonjësve sezonalë të cilët ofrojnë shërbimin e guidës vihet re se, ose rritja e numrit tyre ka mbetur e njëjtë, si në rastin e ZAKPA Apoloni, ose nuk ka patur asnjë punësim sezonal për të ofruar këtë shërbim, sikurse në rastet ZAKPA Bylis, ZAKPA Butrint, DRTK Vlorë (Sektori i Parqeve Amantia-Orikum) në vitin 2019, pavarësisht se fluksi i vizitorëve është rritur progresivisht vit pas viti.
- Në parqet arkeologjike të Amantias dhe të Orikumit sinjalistita orientuese dhe shpjeguese ka nevojë për përmirësim. Në brendësi të Parkut të Bylis, duhen vendosur tabelat, të cilat mungojnë krejtësisht që nga viti 2019.
- Në organigramën dhe strukturën e NJAKPA – ve mungon pozicioni me detyrë funksionale dedikuar marrëdhënieve me publikun.
- Në sitet arkeologjike të audituara, vizitat e turistëve zhvillohen pa mbështetjen e teknologjive të audioguidës dhe të videoguidës.

Konkluzione:

- Gjendja e rrugëve të aksesit në P. A. Bylis është shumë e keqe dhe duke pasur parasysh se, “*Politikat shtetërore në fushën e trashëgimisë kulturore udhëhiqen nga Këshilli i Ministrave. Këto politika zbatohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore e vendore, si dhe me shoqërinë civile.¹⁶²*” bëhet i nevojshëm ndërveprimi i një spektri të gjerë faktorësh, qendror, vendor dhe të dedikuar, për të mundësuar zgjidhjen e problematikës me të cilën ndeshet ky realitet historiko - kulturor.
- Duke pasur parasysh, se: “Vlerësimi i trashëgimisë kulturore është ushtrimi i atyre funksioneve e aktivitetave që sigurojnë kushtet më të mira të shfrytëzimit publik të pasurive e vlerave kulturore...” dhe se pengesat e aksesit në sitin e Orikumit e ulin këtë mundësi, bëhet e nevojshme diskutimi në një nivel më të gjerë vlerësimi dhe vendimmarrjeje, ku duhet të përfshihen Këshilli i Ministrave, Ministria e Kulturës, Ministria e Mbrojtjes dhe Bashkia Vlorë, për të gjetur një zgjidhje permanente të problemit të hyrjes së vizitorëve në parkun arkeologjik të Orikumit pa asnë pengesë fizike apo procedurale.
- Meqë është detyrë ekskluzive ARSH – së që të vendosë sinjalistikën rrugore dhe meqë problemet me tabelat shkaktojnë dezorientim për vizitoret që nuk e njohin zonën, atëherë tabela që tregon daljen nga rruga kryesore për në drejtim të parkut arkeologjik të Amantias duhet vendosur. Nevoja e plotësimit me tabela nga ana e ARSH – së është e vlefshme edhe për në parkun e Apolonisë, sikurse vë në dukje edhe kjo NJAKPA.
- Përderisa lëvizja drejt siteve arkeologjike të Bylisit dhe Amantias nuk mbulohet nga mjete që ofrojnë këtë shërbim publik transporti, si dhe përderisa nga MK “vlerësohet se prania e këtij shërbimi do të ndihmonte në përmirësimin e ofertës turistike tek

¹⁶² Ligji 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 9, Paragrafi 1

vizitorëve”, është e nevojshme të kërkohet një zgjidhje për këtë problematikë, minimalisht për periudhën kur sezoni turistik sjell më shumë vizitorë pranë këtyre parqeve arkeologjike.

- Ndotja dhe zaptimi i disa parcelave që përdoren si stane për bagëtitë, mu në zemër të parkut të Amantias, e bëjnë të nevojshme ndërhyrjen energjike të shtetit, i cili duhet të mundësojë bonifikimin e kësaj pjese të parkut. Kështu do të shmangeshin të gjitha efektet e papranueshme që sjell prania e staneve, për rehatinë e vizitorëve dhe për dinjitetin e një pasurie historiko – kulturore, me vlera të veçanta.
- Mungesa e vendeve të parkimit ka krijuar vijimisht probleme të rëndimit të trafikut për udhëtarët dhe mungesë komoditeti për turistët që vizitojnë Parkun Kombëtar te Butrintit.
- Për zgjidhjen e problemit të radhëve të gjata në biletarinë e Parkut Kombëtar Butrint duhet të vihet në funksion një biletari shtesë.
- Mungesa totale e shërbimeve higjeniko – sanitare në parqet e Amantias, Orikumit dhe pamjaftueshmëria e këtyre shërbimeve në P. K. Butrint, krijon një shqetësim të ndjeshëm për vizitorët e siteve.
- Mungesa e tregtimit të pijeve freskuese dhe një game minimale produktesh, në sitin e Amantias dhe deri diku në atë të Orikumit, të eksposuar ndaj diellit dhe larg zonave të banuara ku ka rrjet tregtar, duke pasur parasysh edhe se fluksi më i madh i turistëve i vizitojnë sitet në periudha të nxehta të vitit, krijon një trazim për turistët të cilët e pretendojnë me të drejtë këtë shërbim.
- Shërbimi i guidës që parqet arkeologjike ofrojnë me punonjësit e tyre, është esencial në spektrin e shërbimeve që NJAKPA – të, duhet t'u japid vizitorëve, ndaj si të tillë, punonjësit me këtë funksion duhet të janë të parashikuar në strukturën dhe organikën e ZAKPA – ve.
- Në kushtet e rritjes së fluksit turistik në sitet arkeologjike, në përpjesëtim me rritjen e numrit të vizitorëve, konstatohet e nevojshme edhe rritja e numrit të të punësuarve sezonalë.
- Pamjaftueshmëria e tabelave orientuese dhe shpjeguese në parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikumit, si dhe mungesa totale e tyre në parkun arkeologjik të Bylisit krijojnë vështirësi për vizitorët që të marrin lehtësisht informacion rrëth historisë dhe vlerave të pasurive që gjenden në këto site.
- Mosparashikimi në organigramën e NJAKPA – ve e punonjësit me detyrë funksionale “Ekspert për marrëdhëni me publikun”, ul mundësinë e realizimit me efektivitet të këtij misioni.
- Mungesa e përdorimit të teknologjive të audioguidës dhe të videoguidës në mbështetje të vizitorëve në sitet arkeologjike me frekuentim të lartë, është një problem i cili duhet vlerësuar dhe zgjidhur nga ana e NJAKPA – ve, në bashkërendim me MK - në, meqë ky shërbim do të zëvendësonë mbështetjen e paofruar nga stafii i siteve, duke u dhënë turistëve mundësinë e marrjes së informacionit për të cilin kanë interes, lidhur me pasuritë historiko – kulturore që parqet disponojnë.

Për këtë rekomandojmë:

- Ministria e Kulturës të formulojë një plan veprimi, me qëllim rikualifikimin e rrugës që çon në parkun arkeologjik të Bylisit dhe ta materializojë me veprime konkrete, të cilat synojnë sensibilizimin e gjithë faktorëve që mundësojnë zgjidhjen.

Brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës të vlerësojë propozimet e bëra nga Ministria e Mbrojtjes, lidhur me mundësinë e ndërtimit të rrugës alternative dhe të marrë masa në bashkëpunim me pushtetin lokal, për dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare për problematikën e hyrjes pa pengesa të vizitorëve në parkun arkeologjik të Orikumit.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- ARRSH - ja të plotësojë tabelat që mungojnë drejt parkut arkeologjik Apoloni, sikurse kërkuar nga NJAKPA Apoloni – Bylis, si dhe të vendosë tabelën që orienton drejt sitit arkeologjik të Amantias, në pikën e lënies të rrugës së Lumit të Vlorës.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- NJAKPA e Bylisit dhe Amantias të kërkojnë zgjidhjen e problemit të transportit publik me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore nën juridikcion territorial të të cilave janë, duke siguruar transportin publik për këto dy site, të paktën gjatë sezonit turistik.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- DRKK Vlorë në koordinim të ngushtë dhe me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, si dhe duke përfshirë të gjitha institucionet që kanë kompetencat përkatëse ligjore, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për heqjen e staneve dhe rehabilitimin e Zonës A të parkut arkeologjik të Amantias.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Bordi i Parkut Kombëtar të Butrintit dhe Ministri i Kulturës, në cilësinë e Kryetarit të këtij Bordi, në përgjigje të nevojës së rritjes së sipërfaqes së parkimit, të kërkojë pranë Këshillit të Ministrave, vënien në dispozicion të një mjeti të përshtatshëm për këtë qëllim.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Bordi i Parkut Kombëtar Butrint dhe AADF, të cilit i është dhënë me koncesion shërbimi i biletarisë së Parkut, të vlerësojnë dhe të marrin masa për rritjen e numrit të sporteve të biletarisë.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës dhe DRKK Vlorë të përgatisin projektet përkatëse për garantimin e kushteve higjeniko – sanitare, si dhe shtrirjen e linjave elektrike në P. A. të Orikumit dhe në P. A. të Amantias. Ministria e Kulturës të sigurojë mbështetjen buxhetore për realizimin e këtyre nismave. Për Parkun Kombëtar të Butrintit të miratohet restaurimi i shërbimeve higjenike dhe të parashikohet shtimi i nyjeve të tjera higjenike.

Brenda vitit 2021

- DRKK Vlorë të marrë kontakt me Dhomën e Tregtisë Vlorë, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore dhe operatorë tregtarë vendas, me synimin për të sugjeruar dhe mundësuar çeljen e pikave, që ofrojnë një gamë minimale produkte shifruar tipike të zonës, gjatë sezonit turistik.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

- NJAKPA – të në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të vlerësojnë dhe të ndjekin procedurat e nevojshme për të propozuar miratimin e strukturave dhe organikave të reja, për NJAKPA – të, në të cilat të parashikohen pozicione me detyrë funksionale vetëm shoqërimin e vizitorëve, si dhe ai me detyrë funksionale dedikuar administrimit të marrëdhënieve me publikun.

Brenda vitit 2021

- NJAKPA – të të parashikojnë nevojat për punonjës sezonalë, në kushtet e rritjes së fluksit të vizitorëve në sitet arkeologjike gjatë sezonit turistik dhe të ndjekin gjithë procedurën e parashikuar për punësimin e tyre.

Brenda dymbëdhjetë muajsh

- ZAKPA Bylis të marrë të gjitha masat për vendosjen e tabelave orientuese dhe shpjeguese në parkun arkeologjik të Bylisit, sikurse dhe DRTK Vlorë, të marrë të gjitha masat për plotësimin dhe përmirësimin e tabelave orientuese dhe shpjeguese në parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikumit.

Brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2021

- Ministria e Kulturës dhe NJAKPA – të të ngrenë një grup të përbashkët pune, për të diskutuar, vlerësuar dhe vendosur, mbi nevojat dhe mundësitë efektive për futjen e përdorimit të teknologjive të audioguidave dhe videoguidave.

Brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2021

3.3.2 Sa efektive rezultojnë masat e ndërmarra për njojjen dhe promovimin e parqeve/siteve arkeologjike?

Ligjvënesi është treguar shumë i qartë, kur në Ligjin “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” ka parashikuar se: “Vlerësimi i trashëgimisë kulturore është ushtrimi i atyre funksioneve e aktiviteteve që kanë si qëllim njojjen dhe promovimin e pasurisë kulturore....”¹⁶³.

Aktivitetet dhe nismat e mundshme për t'u ndërmarrë me synim njojjen dhe promovimin e pasurisë kulturore në përgjithësi dhe të siteve arkeologjike në veçanti, janë të shumta.

Niveli i angazhimit në këtë plan, përcakton dhe mat nivelin e përkushtimit që shteti shqiptar i rezervon vlerave të përfaqësuara nga këto pasuri historiko – kulturore.

Promovimi dhe njojja e vlerave tona arkeologjike është një nevojë specifike e realitetit shqiptar, meqë informacioni rrëth një pjese të kësaj pasurie akoma vuan nga paragjykimet rrëth originës së saj dhe përkatesisë kulturore.

Jo shumë kohë më parë, një publikim i një fotoje të parkut të Bylisit nga kritiku i artit italian, Vittorio Sgarbi, shoqëruar me një koment, vuri në dukje se sa pak njihen edhe qendra të qytetërimit të lashtë ilir dhe si paragjykohet përfekt të mosnjohjes historia jonë materiale.

Në një nga portalet e shumta që përcollën lajmin u referua: “Teksa ka postuar një foto me Bylisin në sfond, Sgarbi shkruan se pamja pas është gjithë çfarë ka mbetur nga qytetërimi grek.

“Në Bylis, në Shqipëri, midis mbetjeve arkeologjike të qytetit grek të panjohur,”-shkruan ai.

“Kush do ia ketë thënë Sgarbit që Bylis është grek? Nuk mjaftoi që bënë grek Butrintin, tanë edhe Bylisi na doli qytet grek. nuk i thanë se ishte në mes të mallakastriotëve dhe po i falej lebërve. Këta pasardhës të grekëve janë? I nderuar Zgarbi, falju edhe një herë zotit të Bylisit të na shpëtojë nga injoranca e Ministrisë së Kulturës. Amen!”- shkruan Neritan Ceka.”¹⁶⁴.

Dhe kur nga të tilla paragjykime vuan një studiues i thelluar dhe i kultivuar, si Sgarbi, i cili për më tepër është edhe shumë dashamirës ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve, gjykojeni vetë se sa pak njojje ka rrëth kulturës tonë historike materiale, sikurse ajo e përfaqësuar nga sitet arkeologjike. Shqipëria është në fazë hapjeje karshi perspektivës së turizmit masiv, ku në interesin tonë do ishte edhe promovimi i interesit turistik, përfasur historiko – kulturore.

Gjatë auditimit u **konstatua se MK, ITK, NJAKPA – të nuk kanë ndonjë marrëdhënie të formalizuar me Agjencinë Kombëtare të Turizmit.**

¹⁶³ Ligji 27/2018, Neni 6, Paragrafi 1

¹⁶⁴ <https://dosja.al/vittorio-sgarbi-dhe-bylisi/>

Si institucion varësie e MTM – së, “Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje të ligjit nr.93/ 2015, “Për turizmin” dhe ka këto funksione dhe kompetenca:

1. Zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit, duke promovuar turizmin shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.
2. Oftron informacion për vizitorët, udhëtarët dhe turistët, për shërbimet turistike që ofrohen, për produktet dhe destinacionet turistike, për veprimitari e të dhëna të tjera të dobishme.
3. Promovon produktin dhe destinacionet turistike brenda e jashtë vendit, duke bashkëpunuar me zyrat rajonale të turizmit, pushtetin vendor dhe organizma të tjerë që operojnë në fushën e turizmit.
4. Propozon dhe harton materialet me karakter promocional, në përputhje me tendencat e tregut turistik, dhe realizon prodhimin e tyre.
5. Monitoron, përmirëson dhe përditëson faqen zyrtare të promocionit të turizmit shqiptar...”¹⁶⁵.

E pyetur nëse ka nënshkruar një marrëveshje me AKT – në, MK – ja përgjigjet: “*Ministria e Kulturës nuk ka lidhur marrëveshje formale me Agjencinë Kombëtare të Turizmit*. Në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga AKT apo institucionë të tjera shtetërore, Ministria e Kulturës ka ofruar materiale promocionale (broshura, fletëpalosje, video) të realizuara nga MK dhe institucionet e varësisë, ose ka qenë e pranishme me një stendë të dedikuar.”¹⁶⁶.

MK ka përfshirë në listën e bashkëpunimeve të saj me AKT pesë aktivitete madhore, prej të cilave vetëm ndonjëra e realizuar në katër vitet periudhë auditimi.

Shumë pak për një bashkëpunim të mundshëm me AKT – në, konsideruar ky, një institucion qendror në promovimin e informacionit turistik, ku dhe pasuritë historiko - kulturore duhet të kenë hapësirën e vet të dedikuar.

Pastaj shtrohet pyetja, se a mund të ndalet bashkëpunimi vetëm në dakortësimin e MK – së me AKT – lidhur me përbajtjen e materialeve promocionale, meqë MK – ja pohon se: “*Ministria e Kulturës dhe IKTK kanë kontribuar në iniciativën e MTM dhe AKT në përgatitjen e materialeve promocionale të turizmit kulturore, turet historiko – kulturore dhe paketat e itinerareve kombëtare. Gjithashtu sitet në administrim të Ministrisë së Kulturës.*”¹⁶⁷?

Sigurisht shumë pak si bashkëpunim, për një interes madhor, mes institucionesh të dedikuara të promovojnë imazhin turistik dhe atë historik e kulturore të vendit tonë.

Pa një marrëveshje dhe strategji bashkëpunimi midis MK – së me AKT – së, promovimi i parqeve arkeologjike shqiptare do mbetet larg njohjes dhe interesit të vizitorëve të huaj.

Ndaj pa këtë marrëveshje nuk mund të marrin përgjigje pyetjet: Si AKT –ja i promovon sitet arkeologjike shqiptare? Cilat strategji ndjek për promovimin e tyre? Ku i promovon ato?etj.

Nga ana tjetër, për garantimin e një fluksi të sigurtë dhe konstant vizitorësh për në sitet arkeologjike shqiptare, do ishte i nevojshëm sensibilizimi i agjencive turistike shqiptare, në mënyrë që këto të fundit të nxisin interesin e turistëve ndaj pasurive tona historiko – kulturore dhe sitet t’i bënин pjesë të stacioneve të “detyrueshme” të itinerareve turistike.

Pyetjes drejtuar MK –së dhe NJAKPA –ve, nga grupi i auditimit, se: “A keni lidhur me agjencitë turistike marrëveshje formale për të garantuar fluks të programuar dhe konstant të vizitorëve?”, subjektet e lartpërmendura iu përgjigjen: “*Nuk është nënshkruar marrëveshje formale me*

¹⁶⁵ <http://akt.gov.al/misioni/>

¹⁶⁶ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁶⁷ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

agjencitë turistike. Gjatë viteve 2016 – 2019 Ministria e Kulturës ka bërë të mundur realizimin e platformës online <http://cultureticketsalbania.al> e cila mundëson prenotimin e biletave online. Shoqata e operatorëve turistikë dhe agjenci të veçanta kanë qenë vazhdimesht pjesë e takimeve dhe konsultimeve të ndërmarrja nga Ministria e Kulturës. Gjithashtu institucionet e varësisë kanë komunikim të vazhdueshëm me agjenci turistike.”¹⁶⁸.

Një ndër format e njohjes dhe promovimit të pasurive historiko – kulturore të përfaqësuara nga parqet arkeologjike, janë edhe prania e siteve si subjekte virtuale në realitetin e pashmangshëm të internetit, në trajtën e faqeve zyrtare.

Pak më lart MK referonte se: “Gjatë viteve 2016 – 2019 Ministria e Kulturës ka bërë të mundur realizimin e platformës online <http://cultureticketsalbania.al> e cila mundëson prenotimin e biletave online.”

Kjo platformë e sipërcituar, nga pese sitet e audituara, referon pak informacion lidhur me dy parqe arkeologjike, atë të Butrintit dhe atë të Apollonisë.

Po ta aksesosh link – un, vihet re se ai është:” *Platforma digitale e siteve më të vizituara të trashëgimisë kulturore në Shqipëri.* Këto site ofrojnë shërbimin e biletarisë elektronike për vizitorët, të cilët së shpejti do të kenë mundësi të blejnë biletën e tyre online.”¹⁶⁹.

Informacioni që përmban nënfaqja dedikuar parkut të Apollonisë, ofron të dhëna si:

Informacion mbi vendndodhjen e parkut;

Informacion mbi profilin historik dhe kulturor të këtyre parqeve;

Info të tjera;

Çfarë mund të vizitohet;

Kategoritë dhe çmimet e biletave online;

Kohëzgjatja e vizitës.

Informacioni i platformës shpaloset në gjashtë gjuhë.

Veç parkut të Apollonisë dhe Butrintit, ka dhe shumë pak informacion mbi Bylisin.

Kriteri mbi të cilin u krijua kjo platforme, lidhet me vizitueshmërinë më të lartë të siteve të lartpërmendur dhe faktin, se parqet e përfshira (Apollonia dhe Butrinti) ofrojnë shërbim biletarie elektronike.

Ndërkojë, *për parqet e tjera arkeologjike nuk ka asnjë informacion. Platforma diskriminon dhe përjashton nga promovimi pikërisht site e tjera, të cilat më së shumti kanë nevojë për promovim.*

Sikurse konstatuar gjatë punës audituese dhe përgjigjeve të dhëna nga MK, vihet re se: “Në faqen web të Ministrisë së Kulturës janë paraqitur institucionet e varësisë dhe të dhënat përkatëse përfshirë edhe adresat e rrjeteve sociale, link: <https://kultura.gov.al/insitucionet-ne-varesi/>

Parku Kombëtar **Butrint**

- <https://butrint.al/>
- <https://www.facebook.com/ParkuKombetarButrint/>

Parku Arkeologjik **Apoloni Bylis**

P. A. Apoloni dhe Bylis kanë faqe zyrtare në facebook dhe instagram.

- Parkuarkeologjikapolonibylis në instagram
- <https://www.facebook.com/parkuarkeologjikapolonia.apolonia>
- <https://www.facebook.com/ByllisArchaeology/>

¹⁶⁸ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁶⁹ <http://cultureticketsalbania.al>

Sitet arkeologjike të **Amantias dhe Orikumit**, duke qenë se janë pjesë e një numri sitesh dhe monumentesh që administrohen nga D.R.T.K-Vlorë, nuk kanë një website të veçantë, janë pjesë e aplikacionit Southern Albania Heritage të administruar nga institucioni jonë dhe gjithashtu promovohen vazhdimiisht në adresën zyrtare te Facebook, DRTK Vlorë.

➤ <https://www.facebook.com/DRTKVlorefaqjazyrtare/>¹⁷¹.

Po t'u referohemi përvojave të vendeve fqinje, si p.sh. Italia, konstatohet lehtësisht se ky vend me pasuri të shumta historiko – kulturore ka faqe web – i të panumërtë të dedikuara posaçërisht parqeve arkeologjike, si për shembull: <https://www.sitiarcheologiciditalia.it/>.

Kjo faqe web – i¹⁷², jep një informacion gjithëpërfshirës mbi realitetin arkeologjik italian. Faqja e cila informon në dy gjuhë, italisht dhe anglisht, përmban gjashtë nënfaqe, tre nga të cilat lidhen me kriterin vendndodhje të siteve (veri, qendër, jug) dhe tre të tjera që përbajnë informacion mbi: “qytetërimin e përkatësisë së parkut”, “propozime” dhe “kontakte”.

Informacioni është shumë i plotë dhe e pajis cilindo të interesuar me të dhëna të detajuara mbi secilin park arkeologjik. Kjo webfaqe ka informacion edhe mbi literaturën e këshilluar për një njohje specifike të vlerave historiko – kulturore të këtyre parqeve.

Komunikimi në rrjetet sociale si facebook dhe instagram, mbetet i vlefshëm për promovimin e parqeve arkeologjike shqiptare. Por informacioni që këto rrjete ofrojnë mbetet i fragmentuar dhe i paplotë. Jo paarsye, Parku Kombëtar i Butrintit e ka një faqe zyrtare web – i.

Një faktor që kontribuon në promovimin dhe njohjen e parqeve, është edhe vënia në dispozicion të vizitorëve të fletëpalosjeve informuese dhe broshurave të ndryshme, si dhe publikimi i materialeve të tjera, mbi të dhënat që e përfaqësojnë secilin sit arkeologjik.

Referuar sa deklaruar nga MK -ja dhe NJAKPA – të rezulton se:

“Në **Parkun Kombëtar Butrint** fletëpalosjet e vëna në dispozicion për turistët gjatë vizitës jepen falas, ekspozohen në hyrje dhe ofrohen në 11 gjuhë të ndryshme. Ato janë hartuar nga Parku dhe furnizimi i tyre bëhet duke prokuruar shërbimin e printimit të fletëpalosjeve sipas nevojave.

Gjithashtu ky park është edhe pjesë e Broshurës të botuar në kuadër të 60 vjetorit të aderimit të Shqipërisë në UNESCO.

Parqet arkeologjike **Amantia dhe Orikum** që administrohen nga DRTK Vlorë janë pjesë e guidave turistike, broshurave dhe fletëpalosjeve të miratuara nga Ministria e Kulturës. Këto materiale ilustruese, ekspozohen në biletaritë e parqeve arkeologjike.

Broshurat dhe fletëpalosjet jepen falas. Ato prodhohen sipas mundësive financiare që ka institucioni ynë dhe buxhetit në dispozicion.

DRTK Vlorë nuk ka pasur mungesë lidhur me materialet e promocionit, pasi institucioni e ka prioritet prodhimin e përvitshëm të tyre. Po kështu edhe për furnizimin me material promovues. Parku arkeologjik **Apoloni** prodhon fletëpalosje në gjuhët shqip, frëngjisht, anglisht dhe Italisht. Broshurat vihen në dispozicion të vizitorëve pranë biletarisë. Këto materiale promocionale sipas rasteve shpërndahen në institucionet vendore.”¹⁷³.

Nga ana tjetër, me nisëm të MK - së, IKTK - së, ASHA - s dhe NJAKPA – ve, nuk mungojnë publikime informuese më voluminozë, mbi parqet arkeologjike, për periudhën objekt auditimi. Kështu duke iu referuar një pjesë të tyre, i listojmë si më poshtë:

Ministria e Kulturës ka publikuar:

¹⁷⁰ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁷¹ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁷² <https://www.sitiarcheologiciditalia.it/>.

¹⁷³ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

- Kultura 2013 - 2017 “Fakte dhe shifra”
- Botimi i Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”. Botimi u shpërnda në të 12 prefekturat, 12 qarqet, 61 bashkitë, institucionet shkencore në vend, institucionet e vartësisë.
- Broshura “Institucionet e trashëgimisë kulturore të vizitueshme”
- Broshura “60 vjetori Shqipëria në UNESCO”

Zyra e Administrimit Koordinimit Butrint ka publikuar:

- “Historia e Arkitekturës (Butrinti)”
- Broshura të ndryshme
- “Trashëgimia e ndërtimeve me teknikën e gurit të thatë në rajonin e Adriatikut”
- “Valorizimi i siteve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura nga UNESCO nëpërmjet projekteve pilot”.

Ndërkohë **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (ish - IMK)** boton periodikisht çdo vit Revistën “Monumente”, në përbajtje të të cilës trajtohen edhe sitet arkeologjike.

Botime të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (aktualisht pjesë e strukturës së IKTK) janë:

- "Botimi i Raportit vjetor të shërbimeve të ASHA 2016.
- "Raporti vjetor i shërbimeve të ASHA 2017.
- "Broshurë “Veprimtaria arkeologjike në zonën e Lezhës – 10 vite ASHA, në kuadër të Vtitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe 10 vjetorit të krijimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- Artikull shkencor në revistën “Iliria” “Të dhëna të reja rreth fortifikimeve paraurbane në Shqipërinë Jugperëndimore”, me autor Marenglen Meshini, P/Sektori.
- Botim shkencor i gjermimit arkeologjik të shpëtimit të varrezës antike në rrugën “Pano Foto”, zona arkeologjike “B” e qytetit të Durrësit.

Ndërsa DRTK Vlorë, e cila ka nën administrim parqet arkeologjike, Amantia dhe Orikum, veç fletëpalosjeve ka publikuar edhe:

- Artikull “Vëzhgime të reja arkeologjike në bregdetin e Jonit”, Revista Candavia, Botim i Institutit Arkeologjik / Qendra e Studimeve Albanologjike.

Gjatë inspektimeve në terren të Grupit të Auditimit, *u konstatua, se si në P. A. Bylis, ashtu dhe në P. A. Orikum, nuk kishte fletëpalosje informuese të ekspozuara në hyrje të tyre.*

Paralelisht me mungesën e konstatuar të materialeve informuese dhe duke pasur parasysh edhe përgjigjen e dhënë nga DRKT Vlorë pyetësorit tonë, ku thuhet: *“Broshurat dhe fletëpalosjet jepen falas. Ato prodhohen sipas mundësive financiare që ka institucioni ynë dhe buxhetit në dispozicion”,* e cila aludon për vështirësi financiare për publikimin e fletëpalosjeve, arrihet në konkluzionin se *sitet arkeologjike jo gjithnjë janë të afta t'u ofrojnë vizitorëve materiale informuese mbi parkun arkeologjik.*

Njohja relativisht e vonë e siteve arkeologjike shqiptare edhe përfekt të izolimit të mëparshëm politik e bën familjarizimin me to një proces që ka nevojë të trajtohet me vëmendje.

Është përf t'u vlerësuar shumë pozitivisht, moria e aktivitetave të organizuara pranë këtyre parqeve, raste të cilat kanë afruar dhe njohur me pasuritë historiko – kulturore të tyre vizitorë dhe breza të ndryshëm.

Njohja dhe familjarizimi me parqet, bëhet jo vetëm brenda tyre, por edhe jashtë tyre, nëpër shkolla, nëpërmjet nismash informuese dhe edukative, sikurse: “Edukimi përmes trashëgimisë kulturore” dhe “Edukim përmes kulturës”.

Në Parkun Kombëtar **Butrint** zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme aktivitete me karakter kulturor, edukues dhe promovues, ndër të cilët përmendim:

- Festivali i përvitshëm i Teatrove në Butrint “Butrint Summer Fest”;
- Koncerte të ndryshme muzikore në Teatrin e Butrintit (soprano Inva Mula, këngëtarja Carla Bruni, etj.);
- Koncerti me rastin e Ditës së Evropës (maj 2018).

Në parqet arkeologjike **Apoloni dhe Bylis** referohet në përgjigjen e pyetësorit se, organizohen aktivitete kulturore me qëllim promovimin e siteve dhe vlerave monumentale dhe kulturore, festivale teatrosh, të muzikës Jazz, muzikë klasike, eksposita fotografike dhe pikture, si dhe aktivitete edukative të organizuar nga stafi i parkut.

Në Parqet Arkeologjikë **Amantia dhe Orikum**, janë kryer një sërë aktivitetesh, duke nisur, nga aktivitetet me nxënësit e shkollave në kuadër të programit “*Edukimi përmes Kulturës*” dhe deri tek koncertet muzikore, apo dhe festat e komuniteteve lokale. Gjithashtu, pjesë e programeve vjetore janë aktivitetet “Arkeologu i Vogël”, “Miku i Monumentit”, etj.. Në pjesën e përvitshme të kalendarit kulturor të aktiviteteve në parkun arkeologjik të Amantias është përfshirë projektin “Amantiada”, që realizohet me komunitetin lokal dhe nxënësit e shkollave të zonës.

Më poshtë në rend kronologjik, po radhisim disa prej aktivitetave të zhvilluara në parqet arkeologjike dhe disa të tjera, që kanë pasur parqet objekt diskutimi dhe njohjeje, sikurse:

Për vitin 2016, Zyra e Administrim Koordinimit **Butrint** ka organizuar në park eventet:

- 29 shkurt 2016 - Eventi prezantues i rezultateve të projektit “Ex.PO AUS - Zgjerimi potencialeve të Siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut” dhe promovimi i dy kalave të Butrintit;
- 9 - 23 Korrik 2016 - Festivali i 14-të Ndërkombëtar i Teatrit BUTRINTI 2000;
- 26-29 Shtator 2016 – Aktivitete në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore.

ZAKPA **Apoloni** ka organizuar në 2016:

- 18 prill 2016 - Me rastin e "Ditës Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike" në bashkëpunim me DAR Fier u zhvillua një orë leksioni me nxënës dhe mësues në parkun arkeologjik;
- 10 qershor 2016 - Prezantimi në publik dhe media i projektit “Reabilitimi i Manastirit dhe i peizazhit në Apolloni”;
- 10 korrik - Festivali i muzikës së vjetër "Vox Baroque";
- 26 shtator - Eventi “Dyer të hapura”;
- 29 shtator - Aktivitet me nxënësit e shkollës “Miti Stroni” Pojan, me rastin e Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore;
- 21 tetor - Në kuadër të kremtimit të 80 vjetorit të hapjes së Muzeut të parë Arkeologjik në Shqipëri nga arkeologu francez Leon Rey, në Vlorë, P. A. Apolloni në bashkëpunim me DRKK Vlorë organizoi një eksposítë fotografike, në ambientet e Muzeut Arkeologjik të Apolonisë;
- 25 tetor - Në mjediset e Muzeut arkeologjik të Apolonisë, u organizua një sesion shkencor, në kuadër të projektit evropian "Adria Wealth";
- 13 dhjetor - Aktivitet përkujtimor në kuadër të 60 vjetorit të senatorit francez Justin Godard, nxitës për ardhjen e L. Rey-t në Shqipëri.

DRKK Vlorë ka organizuar në parqet **Amantia dhe Orikum**, sa më poshtë:

- 18 Maj 2016 - ”Edukimi përmes trashëgimisë kulturore” – aktivitete dhe orë të hapura me shkollat e komunitetet lokale;
- 29 maj - Në P. A. Amantia banorët e fshatit Ploçë, kanë organizuar festën e përvitshme të fshatit;

- 1 qershori - “Dita e Fëmijëve”, në P. A. Orik janë organizuar aktivitete me nxënës nga shkollat 9-vjeçare të zonës së Orikumit dhe qytetit të Vlorës.

Në parkun arkeologjik të Bylisit nuk është raportuar të jenë zhvilluar aktivitete me referim konkret gjatë vitit 2016.

Në vitin 2017 u organizuan:

Nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik

- 27 Mars 2017 - "Tryezë e rrumbullakët me subjektet publike e private të arkeologjisë me temë: "Rezultatet e aplikimit të tarifave të shërbimeve arkeologjike në veprimtarinë ekonomike të ASHA-s dhe bashkëpunimi me subjektet arkeologjike publike e private"

Nga Zyra e Administrimit Koordinimit **Butrint** u organizuan:

- 18 prill - Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi i qëndrueshëm (Dita ndërkontaktore e Monumenteve, 18 Prill). Aktivitet me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Adem Sheme” Sarandë;
- 19 maj - Eksposítë mbi bunkerët, në kuadër të “Muzetë dhe historitë e kontestuara. Të thuash të pathënën në muze”;
- 13 - 20 korrik - Festivali Ndërkontaktor i Teatrove “Butrinti 2000”;
- 28 – 29 shtator - Në kuadër të “Java e Trashëgimisë Kulturore Kombëtare” dhe “Ditët Evropiane të Trashëgimisë”, u organizuan leksione të hapura në shkollën e mesme të Ksamilit mbi arkeologjinë, monumentet, mjedisin dhe turizmin në Park;
- Dhjetor 2017 – “Edukimi në Antikitet”, në kuadër të nismës së Ministrisë së Kulturës “Edukimi përmes Trashëgimisë”, me nxënës të shkollës 9 vjeçare Ksamil.

Nga ZAKPA **Apoloni** gjatë vitit 2017 u organizuan shtatë aktivitete në kuadër të ditëve ndërkontaktore të trashëgimisë, me fokus promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të sitit dhe në zbatim të nismës së Ministrisë së Kulturës “Edukimi përmes Trashëgimisë”, si më poshtë:

- 18 prill - Orë e hapur me nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare të Pojanit, në parkun arkeologjik;
- 24 prill - Inaugurimi i Portikut të Statujave dhe i punimeve të realizuara në Apoloni në kuadër të projektit “Restaurimi dhe rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë dhe peizazhit në parkun arkeologjik”;
- 24-26 prill - “Një ditë gërmimi me arkeologët e vegjël në Apoloni” në bashkëpunim me shkollën franceze në Tiranë;
- 18 maj - Orë leksioni me nxënës dhe mësues për trashëgiminë kulturore të Qarkut Fier, në parkun arkeologjik;
- 29 shtator - Aktivitet me nxënësit e shkollës së mesme të përgjithshme “Janaq Kilica” Fier, në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore;
- 8 nëntor - Mbrëmja poetike ”Një Flad Lirikash”;
- 15 nëntor – “Ditët e Jakovit”, në kuadër të programit “Takohemi për një Libër”, në bashkëpunim me shkollën e mesme “Janaq Kilica” dhe bibliotekën publike; “Dritëro Agolli” të qytetit të Fierit.

Në parkun arkeologjik të Bylisit, Amantias dhe Orikumit nuk është raportuar të jenë zhvilluar aktivitete me referim konkret, gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2018 u organizuan përkatesisht:

Nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit **Butrint** u zhvilluan aktivitetet:

- “Tempujt si banesa të Perëndive”, në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë”. Pjesëmarrës: nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferi”, Xarrë;
- “Në pyll me bimët dhe pemët”, 28 shkurt 2018. Pjesëmarrës: nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferi”, Xarrë;

- “Ju dhe fytyrat nga lashtësia”, 26 mars 2018. Pjesëmarrës: nxënës të shkollës 9-vjeçare Mursi;
- Mozaicisti i vogël, 13 prill 2018. Pjesëmarrës: nxënës të shkollës 9-vjeçare “ Mehmet Xhaferi ”, Xarrë;
- “Art of sharing”, 9 maj 2018, në kuadër të Vtit Evropian të Trashëgimisë Kulturore. Pjesëmarrës: vizitorë të Parkut Kombëtar Butrint;
- “Dita ndërkombe të Muzeve”, 18 Maj 2018;
- “Festivali i Teatrove”, 25 maj 2018. Pjesëmarrës: nxënës të shkollës 9-vjeçare “9 Tetori”, Sarandë;
- Arkeologët e rinj në Butrint, 21 maj 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “9 Tetori”, Sarandë;
- “Butrinti Summer Festival” , edicioni i 16-të në Parkun Kombëtar të Butrintit, organizuar nga Qendra Kombëtare e Teatrit Mesdhetar dhe ZAKB, 8 korrik 2018 - 14 korrik 2018. Pjesëmarrësit: Publik i gjërë nga bashkitë e Sarandës dhe Konispolit, turistë të ndryshëm, kompani teatrore shqiptare dhe të huaja.;
- “Trashëgimia kulturore dhe natyrore e Butrintit”, 26 shtator 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferi”, Xarrë;
- Takim me Lashtësinë e Butrintit, 29 shtator 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferi”, Xarrë;
- Takim me Lashtësinë, 19 nëntor 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare të Xarrës, Mursisë, Vrinës, Shalësit, Konispolit.
- “Butrinti 70 vjet Monument Kulture”, 27 nëntor 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “9 Tetori” Sarandë;
- “Takim për një libër”, 11 dhjetor 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferri” Xarrë;
- “Mozaicisti i vogël”, 21 dhjetor 2018. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferri” Xarrë;

Nga ana e saj **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** ka organizuar në 2018:

- Konferencë dhe Ekspozitë fotografike me postera mbi veprimtarinë arkeologjike në terren dhe jo vetëm, të ASHA – s;
- Orë informative në kuadër të programit ‘‘Edukimi përmes Kulturës’’, periudha Janar-Maj 2018. Pjesëmarrës rrëth 350 nxënës nga 5 Shkollat “Qemal Stafa”, “Niket Dardani”, “Instituti Harry Fultz”, “Petro Nini Luarasi” dhe “Ernest Koliqi”.

Në kuadër të programit “*Edukimi përmes kulturës*”, ASHA ka zhvilluar orët e hapura mësimore, kryesisht me nxënësit e viti të II dhe të III të shkollave të mesme, si dhe ato 9-vjeçare, në qytetin e Tiranës. Tema e trajtuar “*Njohja dhe informimi për trashëgiminë arkeologjike, si sfidë për edukimin, mbrojtjen dhe promovimin nga brezi i ri*”, pati për qëllim informimin dhe njoftjen e nxënësve për ruajtjen dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike në Shqipëri si dhe rolin e institucioneve përgjegjëse.

Ndërkohë ZAKPA **Apoloni** gjatë 2018 organizoi aktivitetet si më poshtë:

- “Site Arkeologjike të Luginës së Drinit”, ekspozitë mars-prill 2018, realizuar pranë ambientit të Trapezarisë. Përfitues: vizitorë e huaj dhe vendas;
- Aplikacioni “Apollo Deus Solis”, me të cilin të rinxjtë e jo vetëm mund të zbulojnë Apolloninë nëpërmjet lojës interaktive dhe kuiceve. Përfitues: vizitorë e huaj dhe vendas;
- Përbyllja e ciklit të trajnimeve “Ciceron apo Pasqyrë” me Qendrën Rinore “Epoka e Re” dhe shkollën e mesme “ Janaq Kilica”;

- *Flashmob* në Apoloni me temë “Ta mbrojmë tokën”, 22 prill 2018, në kuadër të “Dita e Tokës”. Përfitues 30 fëmijë dhe prindërit e tyre, si dhe vizitorët e pranishëm;
- Aktivitet edukativ “Ciceroni i Vogël”, përgjatë gjithë viti shkollor 2017-2018 (9 muaj) me fokus dy grup-mosha, (nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe atyre të mesme) të cilët njihen me trashëgiminë. Aktivitetet u zhvilluan në ambientet e ZAKPA Apolloni. Përfitues gjatë viti akademik 2017-18 janë katër shkolla të mesme dhe dhjetë 9-vjeçare, me një numër total prej 1000 nxënës;
- “Një Ditë në Muze si Përgjegjës”. Aktivitet edukativ gjatë viti shkollor 2017-18 (9 muaj). Në aktivitet u përfshinë rreth 300 nxënës nga 6 shkolla 9-vjeçare;
- “Apolonia Jazz Fest”, 22-27 korrik 2018, një bashkëpunim ndërmjet ZAKPA Apoloni dhe Bashkisë Fier. Përfitues: vizitorë dhe qytetarë;
- Aktivitete me Vajzat Scout të Qendrës Rinore “Epoka e Re”, pjesë e shkollës verore të kësaj qendre, të zhvilluara gjatë muajit gusht 2018. Njohja me monumentin e “Vila me Impluvium” dhe mozaikët e Apollonisë ishin pjesë e aktiviteteve të zhvilluara;
- “Mozaikët e Apolonisë”, 26-29 Shtator 2018, në kuadër të “Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore dhe Ditët Evropiane të Trashëgimisë Kulturore”, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës artistike “Jakov Xoxa”, të cilët zbuluan motivet e mozaikut dhe kopjuan skenat e tij, përmes vizatimeve. Përfitues: 20 nxënës të kursit të pikturës;
- “Mbrëmje Poetike”, 26 tetor 2018, në ambientet e Trapezarisë. Një bashkëpunim ndërmjet ZAKPA Apoloni dhe Bashkisë Fier, me pjesëmarrjen e figurave të letërsisë dhe të artit. 70 pjesëmarrës;
- Koncert i këngëtarit Shpat Deda, 21 tetor 2018, etj.;

Nga ZAKPA Bylis u organizuan në 2018:

- Katër aktivitete në kuadër të ditëve ndërkomëtare të trashëgimisë dhe diversitetit, përkatësisht: 18 prill, 19 maj, 21 maj dhe 29 shtator, me fokus promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të parkut arkeologjik Bylis;
- Festivali i 8-të Ndërkomëtar i Polifonisë, 21 – 22 shtator 2018, bashkëorganizuar nga Shoqata Kult. Art. “*Polifonia Shqiptare*” dhe ZAKPA Bylis, me pjesëmarrjen e 800 spektatorëve dhe rreth 200 artistëve;
- 11 takime nëpër shkolla, në kuadër të programit “Edukimi përmes Kulturës”, periudha janar - maj 2018, me rreth 400 nxënës pjesëmarrës.

Në parkun arkeologjik të Amantias dhe të Orikutit nuk është raportuar të jenë zhvilluar aktivitete me referim konkret, gjatë viti 2018.

Për vitin 2019 vlen të vihen në dukje aktivitetet:

Të organizuara nga ZAK Butrint:

- Takohemi për një libër - 24 janar. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës së bashkuar “5 Dëshmorët”, Ksamil;
- “Veshje dhe maska të teatrove në antikitet” - 25 shkurt. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Sotir Deli” Mursi, në kuadër të nismës “Edukimi përmes Trashëgimisë”;
- “Gjeti thesaresh në Butrint” - 25 mars. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferi”, Xarrë;
- Ekspositë “Peizazh Rural” - 18 prill. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollave të Bashkisë Konispol dhe Njësisë Administrative Mesopotam, Bashkia Finiq, vizitorë të rastit;
- “Festivali i Teatrove” – 18 maj. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollave 9-vjeçare të bashkive Sarandë, Konispol, Finiq;

- Arkeologët e rinj në Butrint - 18 maj. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollave 9-vjeçare të bashkive Sarandë, Konispol, Finiq;
- “Mozaiçisti i vogël në Butrint” - 21 maj. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollave 9-vjeçare të bashkive Sarandë, Konispol, Finiq, në kuadër të programit “Edukimi përmes Kulturës”;
- Tragjedia “Medea” e Euripidit - 5 qershor. Pjesëmarrës: Publik i gjërë;
- “Borgjezi fisnik” 13 qershor. Pjesëmarrës: Publik i gjërë;
- “Prekje franceze”, 21 qershor. Pjesëmarrës: Të ftuar;
- “Butrint summer festival”, 7-13 korrik. Pjesëmarrësit: Publik i gjërë;
- “Një ekspeditë arkeologësh të rinj në “shkretëtirë”, 26 korrik. Pjesëmarrës: Fëmijë të ndryshëm që pushonin me familjet në plazhet e Ksamilit;
- Takim “Traces of the Past”, 25 shtator. Pjesëmarrës: Specialistë të fushës së trashëgimisë kulturore dhe studentë;
- Eksposita “Traces of the Past”, 26-29 shtator. Pjesëmarrës: Vizitorë të rastit;
- “Gjeti thesaresh në Butrint”, 27 shtator. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare të Xarrës, Mursisë, Vrinës;
- “Violinistët e vegjël”, 28 shtator. Pjesëmarrës: Vizitorë të rastit;
- “Takim për një libër”, 31 tetor. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës jo publike “Dea 2001” Sarandë;
- “Mozaiçisti i vogël”, 18 dhjetor. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferri” Xarrë.

ZAKPA Apoloni dhe Bylis organizoi gjatë vitit 2019:

- “Ciceroni Vogël”. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës “Andon Xoxa”, “Naim Frashëri”, “Jakov Xoxa”, “Miti Stroni” Pojan, “Shyqyri Behari” Kraps, “Flatrat e Dipes”, “Numani”, “Dertliu”, “Zhani Ciko”, Patos;
- “Ciceron apo Pasqyrë”. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës së mesme “Janaq Kilica”, Qëndrës Rinore “Epoka e Re” u bënë pjesë e aktiviteteve në kuadër të nismës së Ministrisë së Kulturës “Edukimi përmes Trashëgimisë”;
- “Një ditë në muze si përgjegjës”. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, “Miti Stroni”, “Flatrat e Dipes”, “Jakov Xoxa”, “Zhani Ciko”;
- Filmmaker “Apolonia nga antikiteti në ditët e sotme”, 18-26 prill. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës “Jakov Xoxa” dhe vizitorë të rastit;
- Koncerti i kuartetit të RTSH “Tinguj Historie”, 18maj. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës artistike “Jakov Xoxa” dhe vizitorë të rastit;
- Eksposita fotografike “Ikonat e Muzeut Ikonografik Onufri”, 18 maj. Pjesëmarrës: Nxënës, studentë, vizitorë të rastit dhe qytetarë fierakë;
- “Muzeu në valixhe”, 23 maj. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës “Zhani Ciko” Patos;
- “Muzeu në valixhe”. Pjesëmarrës: Nxënës, mësues;
- “Festa e grurit”, 24 korrik. Pjesëmarrësit: Publik i gjërë;
- Trajnim i të rinjve të SMILE Albania, 11-12 korrik. Pjesëmarrës: Të rinjtë e SMILE Albania. Të cilët u njohën me sitin e Apollonisë dhe historikun i tij;
- “De Fest Apolonia”, 25-26 shtator. Pjesëmarrës: Specialistë të fushës së trashëgimisë kulturore dhe studentë, vizitorë të rastit dhe qytetarë Fierak;
- “Aktiv së bashku”, 26-29 shtator. Pjesëmarrës: Nxënës të 10 shkollave të Fierit;
- Workshop: “Të skicosh monumentet e kulturës si një artist”, në kuadër të Javës Evropiane të Trashëgimisë Kulturore”, 27 shtator. Pjesëmarrës: Nxënës të shkollës Artistike Rajonale “Jakov Xoxa” Fier;

- Ekspozita e akuarelit "Uji i bekuar, dimension kulturash", 15 tetor. Pjesëmarrës: Vizitorë të rastit, studentë dhe nxënës, qytetarë fierakë;
- "Tetori i Librit, Poëtët tanë të traditës", 18 tetor. Pjesëmarrës: Qytetarë fierakë.

Në parkun arkeologjik të Bylisit, Amantias dhe të Orikumit nuk është raportuar të jenë zhvilluar aktivitete me referim konkret gjatë vitit 2019.

Gjithsesi ajo që konstatohet lehtësishet dhe është inkurajuese nga këto të dhëna është fakti, se parqet kanë filluar të bëhen qendra atraksioni ku organizohen aktivitetetë ndryshme. Sigurisht meriton të vlerësohen pozitivisht përpjekjet e disa NJAKPA –ve të cilat kanë zhvilluar një aktivitet të dendur në parqet arkeologjike, duke afruar edhe shumë vizitorë, të cilët ndofta i shohin për herë të parë sitet, në të tilla rrethana.

Sikurse ndeshur edhe në të dhënat mbi aktivitetin e përvitshëm në site dhe mbi aktivitetin e gjeneruar edhe jashtë hapësirave të tyre nga punonjësit e NJAKPA –ve, përmes aktiviteteve nëpër shkolla, vlen për t'u përgëzuar edhe nënshkrimi i "Memorandumit të bashkëpunimit për edukimin mbi dhe përmes artit dhe trashëgimisë", ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, më datë 25 janar 2016, i njojur edhe si programi "Edukim përmes Kulturës".

"Programi i "Edukimit përmes Kulturës" synon që institucionet kulturore dhe arsimore të nxisin interesin e fëmijës për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe artistike, duke garantuar sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta në jetën kulturore, artistike, si dhe krijimin e hapësirave dhe aktiviteteve krijuarë përgjatë kohës së lirë"¹⁷⁴.

Ky qasje pedagogjike karshi brezit të ri do rrisë ndjeshmérinë qytetare, ndaj historisë dhe vlerave të përfaqësuara nga trashëgimia historiko – kulturore, ku padyshim, parqet arkeologjike përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të saj.

Në "Memorandumin e bashkëpunimit për edukimin mbi dhe përmes artit dhe trashëgimisë", thuhet: "Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit dhe e Sportit, përmes institucioneve të tyre të varësisë do të mundësojnë organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të tillë si: vizita në muze, parqe arkeologjike,"¹⁷⁵.

Nga evidenca e aktiviteteve të realizuara në sitet objekt auditimi dhe të aktiviteteve të realizuara nga punonjësit e NJAKPA – të jashtë parqeve (mjedise shkolllore) u **konstatua se parqet kanë konsoliduar marrëdhënien solide me shkollat të cilat ndodhen në afërsi të tyre**. Kjo është e kuptueshme dhe deri diku e justifikueshme.

Gjatë procesit auditues Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të varësisë të dedikuara në administrimin e parqeve arkeologjike, u është kërkuar informacion lidhur me forma të tjera të promovimit të siteve, sikurse ato që lidhen me:

1. ekzistencën e ndonjë programi të MK –së për financimin dhe prodhimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike të vendit tonë;
2. ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje bashkëpunimi të MK – së me Televizionin Publik Shqiptar, lidhur me realizimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike shqiptare;
3. ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje të MK – së me Televizioni Publik Shqiptar, mbi transmetimin periodik të dokumentarëve mbi sitet arkeologjike;
4. hapat e bërë në drejtësia të nxitjes së kanaleve televizive private nga MK, që reportazhet dhe dokumentarët mbi sitet arkeologjike, të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

Lidhur me çështjen e parë, në informacionin e ardhur nga MK thuhet se, "Ministria e Kulturës çdo vit hap thirrje të hapur për mbështetje të projekte kulturore drejtuar organizatave

¹⁷⁴ <https://kultura.gov.al/marreveshje-e-mk-dhe-mas-per-edukimin-permes-kultures/>

¹⁷⁵ Neni 6, "Memorandumi i bashkëpunimit për edukimin mbi dhe përmes artit dhe trashëgimisë"

jofitimprurëse, personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre promovimin dhe edukimin në fushat e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Ndër vite janë përzgjedhur dhe mbështetur financiarisht nga programet buxhetore të Ministrisë së Kulturës “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë” dhe “Art Kulturë” projekte dhe nisma që kanë pasur në fokus zhvillim aktivitetesh në parqe arkeologjikë dhe monumente kulture, ture virtuale në site arkeologjike, objekte kulti dhe monumente kulture, dixhitalizim të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe botime promovuese.”¹⁷⁶.

Sikurse rezulton nga përgjigja e dhënë nga MK, nuk është i parashikuar nga MK një program mbi financimin dhe prodhimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike të vendit tonë.

Lidhur me çështjen e dytë, në informacionin e ardhur nga MK thuhet, se: “Në bazë të legjislacionit në fuqi, shërbimi i fotografimeve dhe filmimeve të pasurive kulturore miratohen me Urdhër të Ministrit të Kulturës sipas tarifave përkatëse.

Referuar kërkesave të gazetarëve të Radio Televizionit Publik Shqiptar, Ministria e Kulturës ka trajtuar këto kërkesa me përparësi të lartë, nuk ka aplikuar tarifat për këtë shërbim, si dhe ka vënë në dispozicion eksperiençen e drejtuesve dhe specialistëve të këtyre siteve, për të ndihmuar procesin e realizimit të dokumentarëve mbi sitet arkeologjike shqiptare.”¹⁷⁷.

Sikurse rezulton nga përgjigja e dhënë nga MK, nuk ekziston ndonjë marrëveshjeje bashkëpunimi të MK – së me Televizionin Publik Shqiptar, lidhur me realizimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike shqiptare.

Lidhur me çështjen e tretë, në informacionin e ardhur nga MK thuhet, se: “Me qëllim prezantimin dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, Ministria e Kulturës ka mbështetur dhe miratuar kërkesat për filmime të paraqitur nga televizioni publik dhe televizonet private, si dhe nga gazetarë të mediave të shkruara të vendit dhe të huaj, në kuadër të programeve dhe emisiomeve televizive, që kanë patur në fokus vlerat e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Gjithashtu sitet/parjet arkeologjike promovohen rregullisht në media dhe rrjetet sociale nga Ministria e Kulturës dhe vetë institucionet përgjegjëse të varësisë.”¹⁷⁸.

Sikurse rezulton nga përgjigja e dhënë nga MK, nuk ekziston ndonjë marrëveshjeje e MK – së me Televizionin Publik Shqiptar, mbi transmetimin periodik të dokumentarëve mbi sitet arkeologjike.

Lidhur me çështjen e katërt, në informacionin e ardhur nga MK thuhet, se: “Ministria e Kulturës, si pjesë të misionit të saj për nxitjen e promovimit të trashëgimisë kulturore, ka mbështetur në mënyrë të vazhduar iniciativat e programeve televizive publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit shqiptar për fotografime dhe filmime, reportazhe, dokumentarë, reklama promovuese.

Në bazë të legjislacionit në fuqi shërbimi i fotografimeve dhe filmimeve të pasurive kulturore miratohen me Urdhër të Ministrit të Kulturës sipas tarifave përkatëse. Për kanalet televizive nuk është apikuar tarifa e këtij shërbimi. Njëkohësisht, në çdo kohë drejtuesit dhe specialistët e Drejtive Rajonale apo të Zyrave të Administrimit dhe Koordinimit të parqeve arkeologjike janë vënë në dispozicion për realizimin e reportazheve dhe dokumentarëve si: intervista, materiale shkencore, etj.”¹⁷⁹.

¹⁷⁶ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁷⁷ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁷⁸ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

¹⁷⁹ Përgjigje e pyetësorit, datë 7 tetor 2020

Sikurse rezulton nga përgjigja e dhënë nga MK, konstatohet se Ministria e Kulturës nuk ka patur një rol proaktiv në drejtim të nxitjes së kanaleve televizive private, që reportazhet dhe dokumentarët mbi sitet arkeologjike, të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

Ministria e Kulturës thjeshtë është kufizuar në mosaplikimin e tarifave të shërbimeve fotografike dhe të filmimeve.

Gjetje:

- Mungon një bashkëpunim formal dhe i thelluar midis MK - së e institucioneve në varësi të saj, të dedikuara me parqet arkeologjike, nga njëra anë dhe AKT – së ana tjetër, e cila ka si mision promovimin e turizmit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.
- Mungon bashkëpunimi i ngushtë dhe rezultativ midis MK – së, NJAKPA –ve nga njëra anë dhe shoqatave të operatorëve turistike shqiptarë nga ana tjetër.
- Mungesa e një webfaqeje zyrtare të administruar nga MK – ja në ndërveprim me NJAKPA – të, ku të përfshihet informacioni i detajuar dhe i certifikuar, mbi të gjitha parqet arkeologjike shqiptare.
- Sitet arkeologjike jo gjithnjë kanë në dispozicion materiale të mjaftueshme informuese për t'ua dhënë vizitorëve.
- Në parqet arkeologjike të Bylisit, Amantias dhe Orikumit aktivitetet kulturore të realizuara kanë qenë të pakta në periudhën objekt auditimi.
- Nuk ka një pjesëmarrje në aktivitetet e parqeve të Butrintit dhe Apolonisë nga nxënësit e shkollave të Tiranës, si dhe të qyteteve të tjera të vendit.
- Ministria e Kulturës nuk ka asnjë program financimi për prodhimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike shqiptare. Ndryshe nga rasti i nënshkrimit të Memorandumit me MAS për “Edukim përmes kulturës”, e vlerësuar si përvojë pozitive, ajo nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje me Televizionin Publik Shqiptar, qoftë për prodhimin e tyre, qoftë dhe për transmetimin e tyre periodik, sikurse nuk ka përpunuar asnjë plan veprimi në drejtim të nxitjes së kanaleve televizive private, që reportazhet dhe dokumentarët mbi sitet arkeologjike, të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

Konkluzione:

- Mungesa e bashkëpunimit të ngushtë midis MK - së dhe AKT – së ka kijuar boshllëqe në promovimin e turizmit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik interesant në tregun ndërkombëtar.
- Mungesa e bashkëpunimit të ngushtë dhe rezultativ midis MK – së, NJAKPA –ve nga njëra anë dhe shoqatave të operatorëve turistikë shqiptarë nga ana tjetër, ul nivelin e vizitueshmërisë të parqeve arkeologjike, për efekt mospromovimi.
- Për një promovim gjithëpërfshirës të parqeve arkeologjike të vendit tonë është e nevojshme të krijuhet një faqe zyrtare që të japë informacion për të gjitha këto asete të trashëgimisë tonë historiko – kulturore.
- Mungesa e materialeve informuese mbi sitet arkeologjike, të eksponuara në hyrje te parqeve arkeologjike, të cilat u jepen falas vizitorëve, përfaqëson një shërbim të munguar i cili synon të sigurojë një njohje më të thelluar të vlerave historiko – kulturore dhe promovimin e tyre.
- Mungesa e zhvillimit të aktivitetave kulturore në parqet arkeologjike të Bylisit, Amantias dhe Orikumit, është një mangësi e theksuar në drejtim të njohjes dhe promovimit të tyre.

- Por Parku Kombëtar i Butrintit, si vlerë e veçantë historiko – kulturore, e mbrojtur dhe njohur nga UNESCO, ashtu si dhe parqet e tjera më pak të afirmuara, duhet të jenë të aksesueshëm edhe nga shkollat dhe nxënësit e viseve të tjera të Shqipërisë, meqë historia dhe kultura shqiptare duhet të bëhen pjesë e njohjes dhe dijes e të gjithë brezit të ri dhe këtë duhet të synojë edhe bashkëpunimi midis MK - së dhe Ministritë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, edhe nën dritën e Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar, më 25 janar 2016.
- Mungesat e një programi nga ana e MK – së, për financimin dhe prodhimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike shqiptare, si dhe mungesa e marrëveshjeve me Televizionin Publik Shqiptar, qoftë për prodhimin e tyre, qoftë dhe për transmetimin e tyre periodik, sikurse dhe mungesa e një plan veprimi në drejtim të nxitjes së kanaleve televizive private, që reportazhet dhe dokumentarët mbi sitet arkeologjike, të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike, krijon vështirësi në promovimin dhe në njohjen e realitetit arkeologjik shqiptar, meqë mediat vizive gjëzojnë një kapacitet informues dhe orientues shumë efikas.

Për këtë rekomandojmë:

- Ministria e Kulturës të përgatisë dhe t'i propozojë Agjencisë Kombëtare të Turizmit nënshkrimin e një “Memorandumi bashkëpunimi”, lidhur me mënyrën dhe kriteret e promovimit të parqeve arkeologjike shqiptare, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Brenda dymbëdhjetë muajsh

- Ministria e Kulturës së bashku me institucionet e varësisë, të ngrejë një grup pune me synim përgatitjen e një plani ndërveprimi me shoqatat e operatorëve turistikë, i cili duhet të ketë si objektiv, nxitjen e përfshirjes së siteve arkeologjike shqiptare në stacionet e itinerareve turistike të të huajve që vizitojnë Shqipërinë.

Brenda dymbëdhjetë muajsh

- Ministria e Kulturës në ndërveprim me IKTK – në dhe NJAKPA – të, të ngrejë një grup pune, i cili duhet të përcaktojë strukturën e një faqeje zyrtare ku të përfshihen të gjitha sitet arkeologjike të vendit tonë dhe më pas të krijojë e administrojë faqen e parqeve arkeologjike shqiptare.

Brenda gjashtëmuajrit të dytë të vitit 2021

- NJAKPA – të Bylis dhe Orikum në bashkërendim me MK – në, të marrin masa që të mos kenë mungesa të fletëpalosjeve informuese mbi vlerat e parqeve përkatëse dhe të sigurojnë ekspozimin e tyre të vazhdueshëm në hyrje të siteve.

Brenda gjashtë muajsh dhe në vijimësi

- NJAKPA – të e Bylisit, Amantias dhe Orikumit, të përgatisin një program në fillim të vitit mbi aktivitete që do zhvillojnë gjatë vitit për njohjen e këtyre siteve.

Brenda gjashtë muajsh dhe në vijimësi

- Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të kërkojnë dhe gjejnë modalitetet me të cilat t'u mundësohen nxënësve të shkollave, vizitat në sitet kryesore arkeologjike të vendit.

Brenda gjashtë muajsh dhe në vijimësi

- Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë të cilat administrojnë sitet arkeologjike, të ngrejnë një grup pune, i cili duhet të përgatisë një plan veprimi që parashikon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si me Televizionin Publik Shqiptar, për realizimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi parqet dhe trasmetimin e tyre periodik, ashtu dhe me

televizionet private, të cilat të angazhohen që reportazhe dhe dokumentarë mbi realitetin arkeologjik shqiptar të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021

4. PËRMBLEDHJE

Shqipëria edhe pse një vend relativisht i vogël gjëzon privilegjin e një pasurie konsistente historiko – kulturore që numëron në inventarin e saj, nëntë parqe arkeologjike të miratuara, të cilat me mirëmenaxhim kanë potencialin e madh që të kthehen në motor të rëndësishëm zhvillimi ekonomik të zonave ku ato ndodhen.

Me qëllim që menaxhimi i tyre të rezultojë efektiv në arritjen e këtyre objektivave, kontrolli në vazhdimesi i zbatueshmërisë së akteve ligjore, përmirësimi i tyre, hartimi dhe zbatimi i masave të duhura për ruajtjen, mbrojtjen, nxitjen dhe mbështetjen e vlerave kulturore duhet të përbëjnë hallkat kryesore të këtij procesi.

Për sa më lart, objektivi kryesor i këtij auditimi ishte efektiviteti i implementimit të politikave shtetërore për mirëmenaxhimin e parqeve arkeologjike dhe zhvillimin e tyre në aspektin ekonomik, kulturor e turistik, si dhe veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për të siguruar mekanizmat e menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të tyre, për periudhën 2016 – 2019.

Parqet arkeologjike janë vende ose peizazhe natyrore ku ka objekte të luajtshme ose të paluajtshme, të gjermuara ose jo, të cilat ndodhen në sipërfaqe, nën tokë ose nën ujë, që studiohen duke përdorur metoda arkeologjike. Ato përmbajnë vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik. Në ditët e sotme siti apo parku arkeologjik është një vend, vlerat të cilit bazohen jo vetëm në gjurmët monumentale, por edhe në kontekstin natyror dhe mjedisor. Sistemi i parqeve arkeologjike në Shqipëri është miratuar me Ligjin nr. 9048, datë 7 prill 2003 “Mbi Trashëgiminë Kulturore”. Konkretnisht me nenin 53, ku përvçe Butrintit, u njoftë edhe 8 parqet e tjera arkeologjike si: Lezha, Shkodra, Apollonia, Byllis, Amantia, Orikumi, Antigonea, dhe Finiqi. Me këtë ligj u evidentuan vlerat e trashëgimisë kulturore dhe u vendosën disa rregulla që kanë të bëjnë me mbrojtjen e territorit të parqeve dhe detyrat e përgjegjësitë e organeve që veprojnë në këtë fushë.

Koncepti i parkut arkeologjik po ndryshon drejt një perspektive të re, e cila nuk inkuadrohet vetëm në aspektet mbrojtëse të këtyre pasurive, por përfton brenda vetes edhe objektiva që synojnë zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë. Pavarësisht se së fundmi në qendër të investimeve me qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion turistik është vendosur trashëgimia kulturore, përfshirë parqet dhe sitet arkeologjike, si burim i pashfrytëzuar për zhvillim të qëndrueshëm social - ekonomik, janë identifikuar probleme dhe sfida që kanë të bëjnë pikërisht me mirëmenaxhimin e këtyre të fundit dhe problemet që kushtëzojnë zhvillimin e frytshëm dhe korrekt të tyre.

Subjekt i këtij auditimi janë institucionet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin me sukses të procesit.

Subjektet nën auditim janë:

1. Ministria e Kulturës;
2. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
3. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë;

4. Njësitë e Administrimit dhe Kordinimit të Parqeve Arkeologjike (Butrint, Orikum, Amantia, Apoloni& Bylis)

Mesazhi për këtë auditim performance është: “Politikat shtetërore të ndjekura nga Ministria e Kulturës, si ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e siteve arkeologjike, për shkak të mungesës së një kuadri rregulator të plotë në menaxhimin e tyre, nuk kanë rezultuar efektive. Mbivendosja e legjisacionit, si pasojë e funksionimit të njëkohshëm të dy ligjeve për trashëgiminë kulturore, mungesa e akteve nënligjore zbatuese, miratimi i dokumentit strategjik pa plane konkrete veprimi, komunikimi ndërisitacional i dobët, kanë bërë që menaxhimi i siteve të mos jenë efektiv. Përzgjedhja e kritereve të menaxhimit nuk është bërë mbi bazën e studimeve të kryera nga Ministria e Kulturës, si dhe modelit më të mirë të integruar në kushtet shqiptare. Ndryshimi i strukturave të organizimit, funksionimit dhe administrimit të NJAKPA-ve është kryer pa analiza financiare, pa analiza burimesh njerëzore dhe nevojash për aftësi profesionale specifike, pa një planifikim mbi nevojat e konstatuara dhe rezultatet e dëshiruara.

Ministria e Kulturës, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore dhe NJAKPA-të kanë shfaqur dobësi në marrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të parqeve arkeologjike. Në mungesë të planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore, menaxhimi i siteve në këtë aspekt, nuk ka pasur efektivitet të plotë. Mangësitë infrastrukturore, logistike dhe njerëzore, në administrimin e parqeve, janë bërë pengesë për krijimit e kushteve sa më të përshtatshme për shfrytëzimin publik të tyre, nga ana e vizitorëve. Mangësi konstatohen edhe në promovimin e tyre nëpërmjet kanaleve të komunikimit masiv. Ministria e Kulturës nuk ka asnjë plan veprimi, sa i takon marrëdhënieve me mediat vizive, lidhur me prodhimin, promovimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike“.

Bazuar në sa më sipër, për të ndihmuar MK - në, IKTK - në, dhe NJAKPA -të të veprojnë brenda një kornize të bazuar në performancë, po paraqesim sa më poshtë: gjetjet dhe rekomandimet kryesore të auditimit:

1. Gjatë periudhës objekt auditimi, Ministria e Kulturës, lidhur me menaxhimin e parqeve arkeologjike i ka jetësuar politikat e veta mbështetur në një kuadër rregulator jo të plotë, gjë e cila ka sjellë mbivendosje kompetencash midis organeve kolegiale vendimarrëse dhe institucioneve të specializuara, koordinim të dobët institucional dhe ndërinstitucional, si dhe menaxhim të dobët të burimeve njerëzore.

Për sa më sipër rekmandojmë:

Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet e varësisë, institucionet e tjera qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrë masa: për të hartuar aktet nënligjore, në zbatim të Ligjit Nr.28/2018, të hartojë planin e veprimit për realizim e objektivave strategjike 2019-2025, si dhe planet e menaxhimit për parqet arkeologjike, si një domosdoshmëri për menaxhimin efektiv të tyre.

2. Gjatë periudhës objekt auditimi, Ministria e Kulturës, ka shfaqur dobësi në marrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të parqeve arkeologjike. Në mungesë të planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore, menaxhimi i siteve në këtë aspekt nuk ka efektivitet të plotë.

Për sa më sipër rekandojmë:

Ministria e Kulturës, në koordinim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe NJAKPA - të të marrin masa për hartimin e planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore për parqet arkeologjike. Nëpërmjet një plani afatgjatë të synohet ndërtimi i një sistemi menaxhimi modern i këtyre parqeve arkeologjike duke përfshirë restaurimin dhe konservimin e monumenteve, rehabilitimin tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, duke pasur si qëllim shndërrimin e tyre në qendra më aktraktive.

3. Gjatë periudhës objekt auditimi mangësitë infrastrukturore, logjistike dhe njerëzore, në administrimin e parqeve, janë bërë pengesë për krijimit e kushteve sa më të përshtatshme për shfrytëzimin publik të tyre, nga ana e vizitorë. Mangësi konstatohen edhe në promovimin e tyre nëpërmjet kanaleve të komunikimit masiv. Ministria e Kulturës nuk ka asnje plan veprimi sa i takon marrëdhënieve me mediat vizive, lidhur me prodhimin, promovimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike.

Për sa më sipër rekmandojmë:

Ministria e Kulturës, institucionet e varësisë dhe institucione të tjera me kompetenca sipas rastit, të angazhohen me masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, garantimin e mbështetjes logjistike dhe shtimin e burimeve njerëzore në administrimin e siteve, me synim krijimin e kushteve sa më të mira për vizitorët e parqeve arkeologjike. Gjithashtu, MK -ja dhe institucionet e varësisë, të ngrenë një grup pune, i cili të përgatisë një plan veprimi që parashikon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si me Televizionin Publik Shqiptar, ashtu dhe me televizionet private, për realizimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi parqet dhe transmetimin e tyre periodik.

5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. Ardian Simoni, Përgjegjës i grupit të auditimit,
2. Marjana Lako, Anëtare,
3. Megi Rusi, Anëtare.



Drejtori i Departamentit

Yllka Pulashi

